



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 157

Tiranë – E premte, 25 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 85/2022, datë 17.11.2022	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 36/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë..... 18857
Vendim i Kuvendit nr. 86/2022, datë 17.11.2022	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)..... 18858
Vendim i Kuvendit nr. 87/2022, datë 17.11.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 18861
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 735, datë 23.11.2022	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë nr. 50/17-N, zona kadastrale 8605, Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 18861
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 23.11.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 783, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i segmentit rrugor, nyja TEG’”..... 18863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 23.11.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Hapje rruge në lagjen ‘Pjetër Budi’, Njësia Administrative Burrel, Bashkia Mat’”..... 18865
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 738, datë 23.11.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 18867
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 23.11.2022	Për miratimin e procedurave të rimbursimit të masave administrative të falura, të paguara, sipas ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar..... 18888

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 740, datë 23.11.2022	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për rimbursimin e masave administrative të falura, të paguara, sipas ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.....	18888
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 23.11.2022	Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit për krijimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik të Pavarur (IALPP).....	18889
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 23.11.2022	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të “Samitit BE-BP”, të datës 6 dhjetor 2022.....	18892
Vendim i Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së Brendshme nr. 2913/2, datë 21.11.2022	Për delegimin e kompetencave.....	18892
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 186, datë, 28.9.2022	Mbi procedurat për sigurimin e asistencës në tranzit, me qëllim kthimin në rrugë ajrore.....	18892
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm, ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit nr. 176, datë 15.9.2022	Mbi procedurën e shpalljes së të huajit person i padëshiruar dhe miratimin e modelit të urdhrit për shpalljen e një të huaji person i padëshiruar.....	18895
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 220, datë 8.11.2022	Mbi procedurën e zgjatjes, afatet e zgjatjes së qëndrimit, rastet e rëndësishme të veçantë, si dhe dokumentin me të cilin pajiset i huaji	18897
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 223, datë 22.11.2022	Për delegim kompetencash.....	18900
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 505, datë 21.11.2022	Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	18900
Urdhër i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 164, datë 21.11.2022	Për delegim kompetencash.....	18902
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 270, datë 2.11.2022	Miratimi i “Projektpropozimit të TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së, për procesin e kapacitetit rritës 2021–tetor 2022”.....	18903
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 122/12, datë 23.11.2022	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i Sheshit të Flamurit”, Bashkia Vlorë.....	18948



VENDIM
Nr. 85/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 36/2020, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE NIVELIT TË PAGAVE
PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” dhe nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Akademisë së Shkencave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 36/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës

dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshon sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Vlerat dhe elementet e pagës për kategoritë pjesë përbërëse të lidhjes nr. 1 të vendimit (përkatësisht I-b, II-b, III-b, III-a/1 dhe IV-a) janë të njëjta me vlerat dhe elementet korresponduese për kategoritë respektive në VKM-në nr. 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 17.11.2022.

Lidhja nr. 1

STRUKTURA, ORGANIKA DHE NIVELI I PAGAVE
I AKADEMISË SË SHKENCAVE

	Numri	Kategoria
KRYESIA	4	
Kryetar	1	C (0.68)
Zëvendëskryetar	1	D (0.6)
Sekretar shkencor	1	D (0.6)
Sekretare e Kryesisë	1	III-b
SEKSIONET SHKENCORE	4	
Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjie (anëtar Kryesie)	1	E (0.55)
Sekretar teknik i SSHSHA-së	1	IV-a
Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike (anëtar Kryesie)	1	E (0.55)
Sekretar teknik i SSHTN-së	1	IV-a
QENDRA E PROJEKTEVE DHE KOORDINIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR	3	
- Drejtor	1	II-b
- Koordinator kërkimor-shkencor	2	III-b

ADMINISTRATA

KANCELARI	1	I-b
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN	3	
- Përgjegjës sektori	1	III-a1
- Specialist për burimet njerëzore	1	III-b
- Specialist për marrëdhëniet me jashtë	1	IV-a
SEKTORI I BOTIMEVE SHKENCORE	6	
- Përgjegjës sektori	1	III-a1
- Redaktor shkencor	1	III-b



- Redaktor shkencor	1	III-b
- Bibliografe	1	IV-a
- Bibliotekare	1	IV-a
- Editor botimesh	1	Kl. VI
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS	4	
- Përgjegjës sektori	1	III-a1
- Specialist finance	1	IV-a
- Specialist për shpërndarjen e librit akademik	1	IV-b
- Magazinier/shofer	1	Kl. VI
SEKTORI NDIHMËS		
- Shofer	1	Kl. IV
- Punëtor mirëmbajtës	1	Kl. IV
- Punonjës pastrimi	1	Kl. I
- Arkivist-protokollist	1	Kl. VII
TOTALI	29	

VENDIM
Nr. 86/2022

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE (AMA)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të neneve 15, pika 2, dhe 19, pika 17, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Struktura e AMA-s është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.

II. Organika e AMA-s është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.

III. Numri i punonjësve është 81.

IV. Vendimi i Kuvendit nr. 19, datë 10.3.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)”, të ndryshuar, shfuqizohet.


V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 17.11.2022.



Lidhja nr. 1



Lidhja nr. 2

ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr.	Funksioni	Nr. i punonjësve	Klasa/Kategoria
1.	Kryetar Sekretar	1 1	Grupi D VKM nr. 187/2017
2.	Kabineti Drejtor Kabineti Këshilltar	2 1 1	II-a II-b
3.	Zëvendëskryetar	1	Grupi F
4.	Sekretari i Përgjithshëm	1	I-b
5.	Këshilli i Ankesave Kryetar Anëtar Anëtar	3 1 1 1	II-b III-a III-a
6.	Drejtoria Ligjore Drejtor Sektor i Kodifikimit dhe Vlerësimit të Aplikimeve Përgjegjës Sektori Specialist Specialist Sektor i Përfaqësimit dhe Analizës Ligjore Përgjegjës Sektori Specialist Specialist	7 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1	II-b III-a III-b III-b III-a III-b III-b
7.	Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes Drejtor Sektor i Inspektimeve Përgjegjës Sektori Specialist Specialist	10 1 1 1 1	II-b III-a III-b III-b



	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Sektori Teknik		
	Përgjegjës Zyre	1	Klasa VIII
	Teknik i mesëm	1	Klasa V
	Teknik i mesëm	1	Klasa V
	Teknik i mesëm	1	Klasa V
8.	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve	13	
	Drejtore	1	II-b
	Sektori i Financës dhe Buxhetit		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Sektori i Shërbimeve		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a/1
	Nëpunës Informacioni	1	Klasa II
	Shofer	1	Klasa III
	Shofer	1	Klasa III
	Magazinier	1	Klasa V
	Punonjës Shërbimi	1	Klasa III
	Punonjës Pastrimi	1	Klasa I
	Punonjës Pastrimi	1	Klasa I
9.	Drejtoria e Monitorimit dhe Analizës	12	
	Drejtore	1	II-b
	Sektori i Monitorimit të Përmbytjes		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Sektori i Analizës		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
10.	Drejtoria e Integrimit dhe Legjislacionit	7	
	Ndërkombëtar		
	Drejtore	1	II-b
	Sektori i Çështjeve të Marrëdhënieve me Jashtë		
	Përgjegjës Sektori		
	Specialist	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Sektori i Legjislacionit Evropian dhe Integrimit në BE	1	III-b
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
11.	Drejtoria e Botimeve dhe Ndërveprimit	7	
	Drejtore	1	II-b
	Sektori i Botimeve		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Sektori i Ndërveprimit		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b



12.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli	7	
	Drejtor	1	II-b
	Sektori i Burimeve Njerëzore		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Sektori i Arkiv-Protokollit		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a/1
	Specialist	1	IV-b
	Specialist	1	IV-b
13.	Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK-u	9	
	Drejtor	1	II-b
	Sektori i Frekuencave		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Sektori TIK		
	Përgjegjës Sektori	1	III-a
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Specialist	1	III-b
	Total	81	

VENDIM
Nr. 87/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe neneve 21 e 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Lefter Gështenja caktohet anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare në vend të deputetit Luan Baçi.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.11.2022.

VENDIM
Nr. 735, datë 23.11.2022

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA TEK AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË NR. 50/17-N, ZONA KADASTRALE 8605, VLORE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë nr. 50/17-N, zona kadastrale 8605, Vlorë, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar.


3. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohej të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë,

të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ia japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



**VENDIM****Nr. 736, datë 23.11.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 783, DATË 15.12.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 783, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 64 499 504 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e

nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekë ...” zëvendësohet me “... 66 420 087 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e njëzet mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë ...”;

b) Në pikën 5, vlera “... 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 100 000 (njëqind mijë) lekë ...”;

c) Të dhënat për nënndarjet me numrat rendorë 3 dhe 4, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në seksionin A, si dhe shtohen nënndarjet për pasuritë me nr. 583/34, nr. 583/21, nr. 484/10, nr. 484/6/1, nr. 484/7 dhe nr. 484/17, me të dhënat në seksionin B, të tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 783, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG’”.

Tabela që pasqyron ndryshimet dhe shtesën e bëra në tabelën bashkëlidhur VKM-në nr. 783, datë 15.12.2021.

Të dhënat sipas VKM-së nr. 783, datë 15.12.2021		Të dhënat e ndryshuara dhe shtesa											
Nr.	Nr. rendor në VKM-në nr. 783, datë 15.12.2021	Numri i pasurisë	Emër/atësi/mbiemër	Sip. totale m²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			TOKË ARË			Vlera totale (lek)	Shënime
						Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera, lek	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera, lek		
Seksioni A që pasqyron pasurinë që ndryshohet në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 783, datë 15.12.2021													
1	3	583/13	Besart Avni Shehu	4635	ARE			0.00	245	523.00	128,135.00	128,135	
2	4	583/24	Theofilos Fuat Alimeta Arben Avni Paja Petrit Avni	4000	ARE + TRUALL			0.00	204	523.00	106,692.00	106,692	
Seksioni B që pasqyron pasurinë që shtohet në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 783, datë 15.12.2021													
3		583/34	Lazam Isak Doda	1000	TRUALL	135	3283.00	443,205.00			0.00	443,205	
4		583/21	Lazam Isak Doda	8000	ARE			0.00	2282	523	1,193,486.00	1,193,486	
5		484/10	Refat Bojken Skender Shehu Kola	6,800.00	ARE			0.00	493.50	523.00	258,100.50	258,101	
6		484/6/1	Arben Hysen Çala	2,000.00	ARE			0.00	136.50	523.00	71,389.50	71,390	Në favor të Arber Luarasi K. Qira
7		484/7	Arben Hysen Çala	2,000.00	TRUALL	84.50	3,283.00	277,413.50			0.00	277,414	Në favor të B.K. Greqisë për shumën 100.000 euro
8		484/17	Shoqëria “Megapharma” sh.p.k.	2,000.00	truall	55.50	3,283.00	182,206.50			0.00	182,207	Vendoset hipotekë ligjore në favor të banka OTP Albania sh.a. për shumën 1,500,000 euro
Vlera totale (lek)												2,660,628.00	

**VENDIM****Nr. 737, datë 23.11.2022****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“HAPJE RRUGE NË LAGJEN ‘PJETËR
BUDI’, NJËSIA ADMINISTRATIVE
BURREL, BASHKIA MAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Hapje rruge në lagjen ‘Pjetër Budi’, Njësia Administrative Burrel, Bashkia Mat”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Mat.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 299 937 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, në masën 1 299 937 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Mat.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Mat.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën kadastrale pranë Bashkisë Mat.

8. Bashkia Mat kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Mat.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Mat.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mat.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Mat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore e Kadastrës Mat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



**Lista emërore përfundimtare e pronarëve, pasuritë e paluajtshme, pronë private të të cilëve shpronësohen për interes publik, nga realizimi i projektit
“Për hapje rruge në lagjen ‘Pjetër Budi’, Njësia Administrative Burrel, Bashkia Mat”**

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE																SHËNIME	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m2)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	TRUALL			NDËRTESE				VLERA TOTALE (lekë)
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	O	P	Q	R	S	T	Y	Z
1	Muharrem	Mehmet	KOLAVERI	Burrel	1326	3/113	Truall+ ndërtesë	26.9		26.9	26.9	13	195	26.9	1306	35131	26.9	44300	1191670	1226801	Konfirmuar nga ASHK-ja, okupim Ramazan Kolaveri, ka ndërtim pa leje
2	Mikel Skënder Elvira Melita Vera Maryse Aleksandër	Mirgin Xhelal Xhelal Xhelal Xhelal Mirgin	ZOGU ZOGU ZOGU ZOGU FERNANDO ZOGU	Burrel	1326	3/112	Truall	112		112		13	194	56	1306	73136				73136	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA PARAPRAKE																108267			1191670	1299937	

**VENDIM****Nr. 738, datë 23.11.2022**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN, PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 7, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/1907 ...” shtohen “... (CFSP) 2022/1986...”;

b) Në pikën 19, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/596 ...” shtohen “... (CFSP) 2022/1956 ...”.

2. Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2022/1986 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në aneksin 19, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2022/1956, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



20.10.2022

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 272 I/5

VENDIMET

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/1986 i datës 20 tetor 2022 që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Ndërkaq:

- (1) Më 17 mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) Bashkimi mbetet i palëkundur në mbështetjen e tij për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.
- (3) Regjimi iranian ofron mbështetje ushtarake për luftën e paprovokuar dhe të pajustificuar të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Duke pasur parasysh peshën e situatës, Këshilli konsideron se tre individë dhe një subjekt i përfshirë në zhvillimin dhe dërgimin e mjeteve ajrore pa pilot në Rusi duhet t'i shtohen listës së personave, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Aneks i Vendimit 2014/145/CFSP.
- (4) Veprime të mëtejshme nga Unioni nevojiten për të zbatuar disa masa.
- (5) Vendimi 2014/145/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit 2014/145/CFSP është ndryshuar në përputhje me Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

E kryer në Bruksel, 20 tetor 2022.

Për Këshillin

Presidenti

M. BEK

(1) Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i 17 marsit 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJ L 78, 17.3.2014, f. 16).



Shtojca

Personat dhe subjektet e mëposhtme i shtrihen listës së personave, enteve dhe organeve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP:

Personat

Emri	Informacion identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
*1263. Mohammad Hossein BAGHERI	Vendi i lindjes: Teheran, Iran Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Gjeneral-Major Pozicioni: Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Iranit	Gjeneral-major Mohammad Hossein Bagheri është Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Iranit. Ai mbikëqyr programin ushtarak të Mjeteve Ajrore Pa pilot (UAV) dhe luan një rol themelor në bashkëpunimin mbrojtës të Iranit me Federatën Ruse. Ai është gjithashtu i përfshirë në zgjerimin e UAV-ve të prodhuara nga Irani jashtë vendit. Në këtë çështje, ai inauguroi një linjë montimi në Takhikistan të destinuar për eksportin e dronëve Ababil-2. Ai gjithashtu mori pjesë në zhvillimin e dronëve Mohajer-6 dhe furnizimin e tyre në Federatën Ruse për përdorimin e tyre në luftën e agresionit kundër Ukrainës. Prandaj, gjeneralmajori Mohammad Hossein Bagheri është përgjegjës për mbështetjen e veprimeve që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	20.10.2022
1264. Sayed Hojatollah QUREISHI a.k.a. Sayyed Hojatollah GHOREISHI	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Gjeneral Pozicioni: Shefi i Divizionit të Furnizimit, Kërkimit dhe Çështjeve Industriale në Ministrinë iraniane të Mbrojtjes dhe Logjistikës së Forcave të Armatosura (MODAFI)	Gjenerali Sayed Hojatollah Qureishi është Shef i Divizionit të Furnizimit, Kërkimit dhe Çështjeve Industriale në Ministrinë e Mbrojtjes së Iranit dhe Logjistikës së Forcave të Armatosura (MODAFI) dhe përgjegjës për negociimin e marrëveshjes me Federatën Ruse në lidhje me furnizimin e mjeteve ajrore pa pilot (UAV) të prodhimit iranien për përdorimin e tyre në luftën e agresionit kundër Ukrainës. Prandaj, gjenerali Sayed Hojatollah Qureishi është përgjegjës për mbështetjen e veprimeve që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	20.10.2022
1265. Saeed AGHAJANI/ Saeed Ara Jani / Said Ara Jani / Said Agha Jani	Data e lindjes: 3.4.1969 Gjinia mashkull Pasaporta: Pasaporta V47528711 (Iran) Kombësia: Iraniane Grada: Gjeneral Brigade Pozicioni: Komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike - Komanda e UAV-ve të Forcave Ajrore (IRGC ASF)	Gjeneral Brigade Saeed Aghajani është komandant i Trupave të Gardës Revolucionare Islamike - Komanda e UAV-ve të Forcave Ajrore (IRGC ASF), shlylla kurizore e programit të autonjeteve ajrore pa pilot (UAV) të Iranit. Gjeneral brigade Saeed Aghajani mbikëqyr dhe drejton planifikimin, pajisjet dhe trajnimin për operacionet e UAV-ve të Iranit, të cilat përfshijnë gjithashtu furnizimin me dronë për aleatët ndërkombëtarë të Iranit, përfshirë Federatën Ruse. Prandaj, gjeneral brigade Saeed Aghajani është përgjegjës për mbështetjen e veprimeve që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	20.10.2022



20.10.2022 I EN I

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 272 I/7

Subjektet

	Emri	Informacion identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
‘119.	Shahed Aviation Industries a.k. a. Qendra Kërkimore e Industrive të Aviacionit Shahed		Shahed Aviation Industries është një kompani e lidhur me Forcat Hapësinore Ajrore të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike në Iran, përgjegjëse për projektimin dhe zhvillimin e serisë Shahed të Mjeteve Ajrore Pa pilot rramane (UAV). Dronët e serisë Shahed u furnizuan në Federatën Ruse dhe përdoren në luftën e agresionit kundër Ukrainës. Prandaj, Shahed Aviation Industries është përgjegjëse për mbështetjen materiale të veprimeve që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	20.10.2022



DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/1986

of 20 October 2022

amending Decision 2014/145/CFSP concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 17 March 2014, the Council adopted Decision 2014/145/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) The Union remains unwavering in its support for Ukraine's sovereignty and territorial integrity.
- (3) The Iranian regime provides military support for Russia's unprovoked and unjustified war of aggression against Ukraine. In view of the gravity of the situation, the Council considers that three individuals and one entity involved in the development and delivery of Unmanned Aerial Vehicles to Russia should be added to the list of persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP.
- (4) Further action by the Union is needed in order to implement certain measures.
- (5) Decision 2014/145/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision 2014/145/CFSP is amended in accordance with the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 20 October 2022.

For the Council
The President
M. BEK

⁽¹⁾ Council Decision 2014/145/CFSP of 17 March 2014 concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine (OJ L 78, 17.3.2014, p. 16).



ANNEX

The following persons and entity are added to the list of persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP:

Persons

	Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
1263.	Mohammad Hossein BAGHERI محمد حسین باقری a.k.a. Sayyed Hojatollah GHOREISHI	POB: Tehran, Iran Nationality: Iranian Gender: Male Rank: Major-General Position: Chief of Staff of Iran's Armed Forces	Major-General Mohammad Hossein Bagheri is the Chief of Staff of Iran's Armed Forces. He supervises the military Unmanned Aerial Vehicle (UAV) programme and plays a fundamental role in Iran's defence cooperation with the Russian Federation. He is also involved in the expansion of Iranian-made UAVs abroad: in this capacity, he inaugurated an assembly line in Tajikistan destined for the export of Ababil-2 drones. He also participated in the development of Mohajer-6 drones and their supply to the Russian Federation for their use in the war of aggression against Ukraine. Therefore, Major-General Mohammad Hossein Bagheri is responsible for supporting actions which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	20.10.2022
1264.	Sayed Hojatollah QUREISHI سيد حجت الله قریشی a.k.a. Sayyed Hojatollah GHOREISHI	Nationality: Iranian Gender: Male Rank: General Position: Head of the Supply, Research, and Industrial Affairs Division at the Iranian Ministry of Defense and Armed Forces Logistics (MODAFI)	General Sayed Hojatollah Qureishi is Head of the Supply, Research, and Industrial Affairs Division at the Iranian Ministry of Defense and Armed Forces Logistics (MODAFI) and responsible for negotiating the agreement with the Russian Federation in relation to the supply of Iranian-made Unmanned Aerial Vehicles (UAVs) for their use in the war of aggression against Ukraine. Therefore, General Sayed Hojatollah Qureishi is responsible for supporting actions which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	20.10.2022
1265.	Saeed AGHAJANI/ Saeed Ara Jani / Said Ara Jani / Said Agha Jani سعيد آقاجانی	DOB: 3.4.1969 Gender: Male Passport: Passport V47528711 (Iran) Nationality: Iranian Rank: Brigadier-General Position: Commander of the Islamic Revolutionary Guard Corps - Aerospace Force (IRGC ASF) UAV Command	Brigadier-General Saeed Aghajani is Commander of the Islamic Revolutionary Guard Corps - Aerospace Force (IRGC ASF) UAV Command, the backbone of Iran's Unmanned Aerial Vehicles (UAVs) programme. Brigadier-General Saeed Aghajani oversees and directs the planning, equipment and training for Iran's UAV operations, which include also the supply of drones to international allies of Iran, including the Russian Federation. Therefore, Brigadier-General Saeed Aghajani is responsible for supporting actions which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	20.10.2022



Entities

	Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
'119.	Shahed Aviation Industries a.k. a. Shahed Aviation Industries Research Center صنایع هوایی شاهد مرکز تحقیقات صنایع هوایی شاهد		Shahed Aviation Industries is an Islamic Revolutionary Guard Corps Aerospace Force-linked company in Iran responsible for the design and development of the Shahed series of Iranian Unmanned Aerial Vehicles (UAVs). Shahed series drones were supplied to the Russian Federation and are used in the war of aggression against Ukraine. Therefore, Shahed Aviation Industries is responsible for supporting materially actions which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	20.10.2022*



17.10.2022

□NJ

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 269 I/9

VENDIM PËR ZBATIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/1956

e datës 17 Tetor, 2022

për zbatimin e Vendimit 2011/235/CFSP lidhur me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 31(2) të tij,

Duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit 2011/235/CFSP të datës 12 prill 2011 në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran (1), dhe në veçanti nenin 3(1) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Ndërkaq

- (1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/CFSP.
- (2) Më 25 shtator 2022, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë lëshoi një deklaratë në emër të Bashkimit duke dëshpëruar përdorimin e përhapur dhe joproporcional të forcës nga forcat iraniane të sigurisë kundër protestuesve jo të dhunshëm, gjë që çoi në numër të lartë të vdekjeve dhe lëndimeve. Deklarata gjithashtu theksoi se përgjegjësit për vrasjen e Mahsa Amini duhet të mbahen përgjegjës dhe u bëri thirrje autoriteteve iraniane të sigurojnë hetime transparente dhe të besueshme për të sqaruar numrin e vdekjeve dhe të arrestuarve, të lirojnë të gjithë protestuesit jo të dhunshëm dhe të sigurojnë një proces të rregullt për të gjithë të paraburgosurit. Për më tepër, deklarata theksoi se vendimi i Iranit për të kufizuar ashpër aksesin në internet dhe për të bllokuar platformat e mesazheve të çastit shkel në mënyrë të hapur lirinë e shprehjes. Së fundi, deklarata thoshte se Unioni do të shqyrtojë të gjitha opsionet në dispozicion për të trajtuar vrasjen e Mahsa Amini dhe mënyrën se si forcat iraniane të sigurisë janë përgjigjur ndaj demonstratave që pasuan.
- (3) Në këtë kontekst, dhe në përputhje me angazhimin e Bashkimit për të adresuar të gjitha çështjet shqetësuese me Iranin, duke përfshirë situatën e të drejtave të njeriut, njëmbëdhjetë persona dhe katër entitete duhet të përfshihen në listën e personave dhe subjekteve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2011/235/CFSP.
- (4) Vendimi 2011/235/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2011/235/CFSP është ndryshuar siç përcaktohet në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

(1) OJL 100, 14.4.2011, p. 51.



E kryer në Luksemburg, 17 Tetor 2022.

Për Këshillin

Presidenti

J. BORRELL

FONTELLES



SHTOJCA

Personat dhe subjektet e mëposhtme i shihen listës së personave dhe enteteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2011/235/CFSP:

Personat

Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
96. ROSTAMI CHESHMEH GACHI Mohammed (a.k.a. ROSTAMI Mohammad)	Vendi i lindjes: Kermanshah (Iran) Data e lindjes: 1976 ose 1977 Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Nr. i identifikimit kombëtar: 111936 Nr. identifikimi: 13821 (Iran) Pozicioni: Shef i Policisë së Moralit të Iranit	Mohammad Rostami Cheshmeh Gachi është kreu i Policisë së Moralit të Iranit. Ai ishte kreu i Policisë së Sigurisë Publike të Kermanshahut nga fillimi i vitit 2014 deri në fillim të vitit 2019 dhe mbajti poste të larta në policinë e inteligjencës iraniane. Policia e Moralit është pjesë e Forceve të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) dhe është një njësi e posaçme e policisë e cila zbaton rregullat strikte të veshjes për gratë, duke përfshirë mbajtjen e detruarshme të shamisë. Policia e Moralit ka përdorur forcë të paligjshme kundër grave për mosrespektim të ligjeve iraniane të hijshimit, dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, arrestimeve dhe ndalimeve arbitrare, dhunës dhe torturës së tepruar. Më 13 shtator 2022, Policia e Moralit arrestoi në mënyrë arbitrare 22-vjeçaren Mahsa Amini në Teheran, dyshohet se kishte veshur hijshim në mënyrë të paligjshme. Më pas ajo u dërgua në selinë e Policisë së Moralit për një 'orë edukative dhe orientuese'. Sipas raporteve dhe dëshmitarëve të besueshëm, ajo u rrall brutalisht dhe u keqtrajtoi në paraburgim, gjë që çoi në shtririmin e saj në spital dhe në vdekjen e saj më 16 shtator 2022. Sijllja abuzive e Policisë së Moralit nuk kufizohet në atë incident dhe është dokumentuar gjerësisht. Si kreu i Policisë së Moralit të Iranit, Rostami është përgjegjës për veprimet e Policisë së Moralit. Prandaj ai mban përgjegjësi për shkelje të rënda të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
97. RAHIMI Hossein	Vendi i lindjes: Fshati Dodhak, Mahalat, Provinca Qendrore (Iran) Data e lindjes: 1964 Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Gjeneral Brigade Pozicioni: Drejtues i Ligjit të Iranit Forcat Zbatuese (LEF) në Teheran	Gjeneral brigade Hossein Rahimi ka qenë kreu i Forceve të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Teheran që nga 7 gushti 2017. Përgjigjia e LEF ndaj protestave të shtatorit 2022 në Teheran ishte veçanërisht i ashpër. Përdorimi i tepruar i dhunës nga LEF për të shlyhur ato protesta rezultoi në vdekjen e shumë njerëzve. Si kreu i LEF në Teheran, Rahimi është përgjegjës për shkelje të rënda të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022



	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
98.	ABDI Abbas	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Kolonel Pozicioni: Shef i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Divandarreh	Koloneli Abbas Abdi është kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në rrethin e Divandarreh. Përgjigja e LEF ndaj protestave të shtatorit 2022 në Divandarreh ishte veçanërisht i ashpër. Përdorimi i tepruar i dhunës nga LEF për të shtypur ato protesta rezultoi në vdekjen e shumë njerëzve. Si kreu i LEF në Divandarreh, Abdi është përgjegjës për shkeljet e rënda të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
99.	MIRZAEI Haj Ahmad (a.k.a. MIRZAEI Hajahmad, MIRZAYI Haj Ahmad)	Vendi i lindjes: Teheran (Iran) Data e lindjes: 9 shkurt 1957 Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Nr. Identifikimi: 4268935215 (Iran) Grada: Kolonel Pozicioni: Shef i Policisë së Moralit të Iranit në Teheran	Koloneli Haj Ahmed Mirzaei ka qenë kreu i degës së Teheranit të Policisë së Moralit të Iranit që nga viti 2018. Policia e Moralit është pjesë e Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) dhe është një njësi e posaçme e policisë e cila zbaton rregullat strikte të veshjes për gratë, duke përfshirë mbajtjen e detyrueshme të shamisë. Policia e Moralit ka përdorur forcë të paligjshme kundër grave për mosrespektim të ligjeve iraniane të hijshimit, dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, arrestimeve dhe ndalimeve arbitrare, dhunës dhe torturës së tepruar. Më 13 shtator 2022, Policia e Moralit arrestoi në mënyrë arbitrare 22-vjeçarën Mahsa Amini në Teheran, dyshohet se kishte veshur hijshimin në mënyrë të paligjshme. Më pas ajo u dërgua në selinë e Policisë së Moralit për një 'ore edukative dhe orientuese'. Sipas raporteve dhe dëshmitarëve të besueshëm, ajo u rrah brutalisht dhe u keqtrajtua në paraburgim, gjë që çoi në shtimin e saj në spital dhe në vdekjen e saj më 16 shtator 2022. Shtjellja abuzive e Policisë së Moralit nuk kufizohet në atë incident dhe është dokumentuar gjerësisht. Si kreu i Policisë së Moralit në Teheran, Mirzaei është përgjegjës për veprimet e Policisë së Moralit në Teheran, duke përfshirë selinë e saj ku Amini u rrah dhe keqtrajtua. Prandaj ai mban përgjegjësi për shkelje të rënda të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
100.	ZAREPOUR Issa	Vendi i lindjes: Eslamabad-e Gharb, Provinca Kermanshah (Iran) Data e lindjes: 1980 Kombësia: Iraniane	Issa Zarepour ka qenë Ministër iranian i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit që nga 25 gushti 2021. Në pozicionin e tij, ai luajti një rol kyç në vendimin e qeverisë iraniane për të shkelur sistematikisht lirinë e opinionit dhe të shprehjes së popullit iranian duke vendosur kufizime në aksesin në internet gjatë protestave që pasuan vdekjen e 22-vjeçarës Mahsa Amini më 16 shtator 2022.	17.10.2022



Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
	Gjinia mashkull Pozicioni: Ministër i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	Ky veprim zvogëloi më tej hapësirën tashmë shumë të kufizuar për aktorët e shoqërisë civile në Iran, duke përfshirë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, për të mbledhur informacion objektiv dhe për të komunikuar, si mes tyre ashtu edhe me botën e jashtme. Ndërprerja e internetit pati pasoja negative për gëzimin e të drejtave të njeriut në Iran, si drejtpërdrejt (përkatesit ndikimi në lirinë e mendimit dhe shprehjes dhe disponueshmëria e informacionit objektiv) ashtu edhe indirekt (domethënë mundësia e shtuar që shkellet e të drejtave të njeriut të mos dokumentohen duke ndikuar negativisht në këtë mënyrë, përgjegësia për shkeljet e të drejtave të njeriut). Si Ministër i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Zarepour është përgjegjës për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	
101. SEPEHR Mohammad-Hosseini	Kombësia: Iraniane Gjinia: Mashkull Pozicioni: Komandant i Bazës Qendrore të Stërvitjes iraniane të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	Mohammad-Hosseini Sepehr është komandanti i bazës qendrore stërvitore të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në Teheran. Ai është anëtar i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) dhe i Forcës së Rezistencës Basij (një organizatë paraushtarake vullnetare që vepron nën IRGC me degë në të gjithë Iranin). Sepehr mbikëqyr trajnimin kundër protestave për forcat iraniane të sigurisë dhe mbështet një linjë represive ndaj protestuesve. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
102. SAFARI Sayd Ali	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Kolonel Pozicioni: Drejtues i Ligjit të Iranit Forcat përmbartimore (LEF) në Saqqez	Koloneli Sayd Ali Safari është kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Saqqez. Përgjigja e LEF ndaj protestave të shtatorit 2022 në Saqqez ishte veçanërisht e ashpër. Përdorimi i tepruar i dhunës nga LEF për të shtypur protestat rezultoi në vdekjen e shumë njerëzve. Si kreu i LEF në Saqqez, Safari është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
103. ADYANI Seyed Alireza (a.k.a. ADIANI Hojjat al-Islam Seyyed Alireza)	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Pozicioni: Shef i zyrës ideologjiko-politike të Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF)	Seyed Alireza Adyani është kreu i zyrës ideologjiko-politike të Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF). Adyani është përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e rregullave të angazhimit për forcat policore. Ai deklaroi se LEF duhet të jetë 'praktike' dhe 'efektive' kur ka të bëjë me kundërshtarët dhe brohoriti Policinë e Moralit që e bëri detyrën e saj 'intensivisht'. LEF ka përdorur brutalitet masiv kundër protestuesve, përfshirë ata që protestuan pas vdekjes së Malisa Anini. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022



	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
104.	AZADI Ali	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Gjeneral brigade i dytë Funksioni: Shef i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Kurdistan	Gjenerali i dytë i brigadës Ali Azadi ka qenë kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Kurdistan që nga viti 2019. Gjatë shtypjes së protestave të shtatorit 2022, forcat nën komandën e tij në Kurdistan qëlluan protestuesit dhe vranë dhe plagosën shumë njerëz. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
105.	SHALIKAR Mohammed Zaman	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Kolonel Funksioni: Shef i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Babol, Mazandaran	Koloneli Mohammed Zaman Shalika ka qenë kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Babol, Mazandaran që nga viti 2021. Gjatë demonstratave pas vdekjes së Mahsa Amini në shtator 2022, forcat nën komandën e tij qëlluan, plagosën dhe vranë protestuesit në Babol, Mazandaran. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
106.	HEIDARI Salman	Kombësia: Iraniane Gjinia mashkull Grada: Kolonel Funksioni: Drejtues i Ligjit të Iranit Forcat përmbartimore (LEF) në Bukan	Koloneli Salman Heidari është kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në Bukan. Përgjigja e LEF ndaj protestave të shtatorit 2022 në Bukan ishte veçanërisht e ashpër. Përdorimi i tepruar i dhunës nga LEF për të shfrytëzuar protestat rezultoi në vdekjen e të paktën një fëmije dhe në lëndime të shumë njerëzve. Si kryetar i LEF në Bukan, Heidari është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022

Entities

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
45.	Policia e Moralit të Iranit (a.k.a. Gashi-e-Ershad; Patrulla e Udhëzimit Islam; Patrullat udhëzuese)	Adresa: Rruga Vozara, këndi i Rrugës 25, Rrethi 6, Teheran (Iran)	Policia e Moralit është pjesë e Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) dhe është një njësi e posaçme e policisë e cila zbaton rregullat strikte të veshjes për gratë, duke përfshirë mbajtjen e detrueshme të shamisë. Policia e Moralit ka përdorur forcë të paligjshme kundër grave për mosrespektim të ligjeve iraniane të luxhabit, dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, arrestimeve dhe ndalimeve arbitrare, dhunës dhe torturës së tepruar.	17.10.2022



Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
		Më 13 shtator 2022, Policia e Moralit arrestoi në mënyrë arbitrare 22-vjeçarën Mahsa Amini në Teheran, dyshohet se kishte veshur hijshabën në mënyrë të paligjshme. Më pas ajo u dërgua në selinë e Policisë së Moralit për një 'kursë edukative dhe orientuese'. Sipas raporteve dhe dëshmitarëve të besueshëm, ajo u rrah brutalisht dhe u keqtrajtua në paraburgim, gjë që çoi në shtrimin e saj në spital dhe në vdekjen e saj më 16 shtator 2022. Sjellja abuzive e Policisë së Moralit nuk kufizohet në atë incident dhe është dokumentuar gjerësisht. Prandaj, Policia e Moralit është përgjegjëse për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	
6.	Forca e Rezistencës Basij (a.k.a. Basij-e Mostazafan) قواي مقاومت بسیج مستازفان	Forca e Rezistencës Basij është një organizatë paraushtarake vullnetare që vepron nën Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) me degë në të gjithë Iranin. Përgjigja e forcave të sigurisë ndaj protestave të shtatorit 2022 në Iran ishte veçanërisht e ashpër, duke rezultuar në vdekjen e shumë njerëzve. Forca e Rezistencës Basij ishte një nga forcat e urdhënuara nga qeveria për të shuar ato protesta. Ai plagosi dhe vrau disa protestues. Forca e Rezistencës Basij është drejtpërdrejt përgjegjëse për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
7.	Komanda e Mbrojtjes Kibernetike e Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (CDC) Adresa: Teheran (Iran) Telefoni: +98 26 3448 9826	Komanda e Mbrojtjes Kibernetike e Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (CDC) monitoron faqet e internetit, emaillet dhe aktivitetet në internet të individëve që konsiderohen si kundërshtarë politikë. Gjatë protestave të shtatorit 2022 në Iran, CDC mori një rol aktiv në politikën represive të qeverisë iraniane, duke përfshirë identifikimin dhe arrestimin e protestuesve. CDC është drejtpërdrejt përgjegjëse për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022
8.	Forcat e Zbatimit të Ligjit të Republikës Islamike të Iranit (LEF) (a.k.a. NAJA; FARAIA) Adresa: Teheran (Iran)	Forcat e Zbatimit të Ligjit të Republikës Islamike të Iranit (LEF) janë një forcë policore e uniformuar. Shkeljet flagrante dhe të rënda të të drejtave të njeriut nga LEF, të tilla si të shtënat pa dalim me municion të vërtetë ndaj protestuesve paqësorë, duke përfshirë fëmijë, janë dokumentuar gjerësisht që nga fillimi i protestave rreth vdekjes së Mahsa Amini në mes të shtatorit 2022. Mbi 70 protestues kanë vdekur dhe qindra u plagosën rëndë, mes tyre edhe fëmijë. Që nga fillimi i demonstratave, forcat policore kanë arrestuar në mënyrë arbitrare edhe shumë mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe gazetarë. Prandaj, LEF është përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	17.10.2022



17.10.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 269 1/9

DECISIONS

COUNCIL IMPLEMENTING DECISION (CFSP) 2022/1956

of 17 October 2022

implementing Decision 2011/235/CFSP concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Iran

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 31(2) thereof,

Having regard to Council Decision 2011/235/CFSP of 12 April 2011 concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Iran ⁽¹⁾, and in particular Article 3(1) thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 12 April 2011, the Council adopted Decision 2011/235/CFSP.
- (2) On 25 September 2022, the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy issued a declaration on behalf of the Union deploring the widespread and disproportionate use of force by the Iranian security forces against nonviolent protestors, which led to high numbers of deaths and injuries. The declaration also stated that those responsible for the killing of Mahsa Amini must be held accountable, and called on the Iranian authorities to ensure transparent and credible investigations to clarify the number of deaths and arrested, release all non-violent protestors and provide due process to all detainees. Furthermore, the declaration stressed that Iran's decision to severely restrict internet access and block instant messaging platforms blatantly violates freedom of expression. Finally, the declaration stated that the Union will consider all the options at its disposal to address the killing of Mahsa Amini and the way Iranian security forces have responded to the ensuing demonstrations.
- (3) In this context, and in line with the Union's commitment to address all issues of concern with Iran, including the human rights situation, eleven persons and four entities should be included in the list of persons and entities subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2011/235/CFSP.
- (4) Decision 2011/235/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision 2011/235/CFSP is amended as set out in the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

⁽¹⁾ OJ L 100, 14.4.2011, p. 51.



Done at Luxembourg, 17 October 2022.

For the Council

The President

J. BORRELL FONTELLES



17.10.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 269 I/11

ANNEX

The following persons and entities are added to the list of persons and entities set out in the Annex to Decision 2011/235/CFSP:

Persons

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
96.	ROSTAMI CHESHMEH GACHI Mohammed (a.k.a. ROSTAMI Mohammad) محمد گچی چشمه رستمی (a.k.a. رستمی)	POB: Kermanshah (Iran) DOB: 1976 or 1977 Nationality: Iranian Gender: male National ID No.: 111936 (Iran) Identification No.: 13821 (Iran) Position: Head of Iran's Morality Police	Mohammad Rostami Cheshmeh Gachi is the head of Iran's Morality Police. He was head of the Kermanshah Public Security Police from early 2014 until early 2019 and held senior positions in the Iranian intelligence police. The Morality Police is part of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) and is a special police unit which enforces the strict dress rules for women, including compulsory wearing of a headscarf. The Morality Police has used unlawful force against women for not complying with Iranian hijab laws, sexual and gender-based violence, arbitrary arrests and detentions, excessive violence and torture. On 13 September 2022, the Morality Police arbitrarily arrested 22-year old Mahsa Amini in Tehran, allegedly for wearing a hijab improperly. She was subsequently taken to the Morality Police's headquarters for an 'educational and orientation class'. According to reliable reports and witnesses, she was brutally beaten and mistreated in custody, which led to her hospitalisation and to her death on 16 September 2022. The Morality Police's abusive behaviour is not confined to that incident and has been widely documented. As head of Iran's Morality Police, Rostami is responsible for the Morality Police's actions. He therefore bears responsibility for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
97.	RAHIMI Hossein حسین رحیمی	POB: Dodhak village, Mahalat, Central province (Iran) DOB: 1964 Nationality: Iranian Gender: male Rank: Brigadier General Position: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Tehran	Brigadier General Hossein Rahimi has been the head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Tehran since 7 August 2017. The LEF's response to the September 2022 protests in Tehran was particularly harsh. The LEF's excessive use of violence to repress those protests resulted in the deaths of multiple people. As head of the LEF in Tehran, Rahimi is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022



	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
98.	ABDI Abbas عبدی عباس	Nationality: Iranian Gender: male Rank: Colonel Position: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Divandarreh	Colonel Abbas Abdi is the head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in the district of Divandarreh. The LEF's response to the September 2022 protests in Divandarreh was particularly harsh. The LEF's excessive use of violence to repress those protests resulted in the deaths of multiple people. As head of the LEF in Divandarreh, Abdi is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
99.	MIRZAEI Haj Ahmad (a.k.a. MIRZAEI Hajahmad; MIRZAYI Haj Ahmad) حاج احمد میرزایی	POB: Tehran (Iran) DOB: 9 February 1957 Nationality: Iranian Gender: male Identification No.: 4268935215 (Iran) Rank: Colonel Position: Head of Iran's Morality Police in Tehran	Colonel Haj Ahmed Mirzaei has been the head of the Tehran branch of Iran's Morality Police since 2018. The Morality Police is part of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) and is a special police unit which enforces the strict dress rules for women, including compulsory wearing of a headscarf. The Morality Police has used unlawful force against women for not complying with Iranian hijab laws, sexual and gender-based violence, arbitrary arrests and detentions, excessive violence and torture. On 13 September 2022, the Morality Police arbitrarily arrested 22-year old Mahsa Amini in Tehran, allegedly for wearing a hijab improperly. She was subsequently taken to the Morality Police's headquarters for an 'educational and orientation class'. According to reliable reports and witnesses, she was brutally beaten and mistreated in custody, which led to her hospitalisation and to her death on 16 September 2022. The Morality Police's abusive behaviour is not confined to that incident and has been widely documented. As head of the Morality Police in Tehran, Mirzaei is responsible for the Morality Police's actions in Tehran, including in its headquarters where Amini was beaten and mistreated. He therefore bears responsibility for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
100.	ZAREPOUR Issa عیسی زارع پور	POB: Esfahan-e Gharb, Kermanshah Province (Iran) DOB: 1980 Nationality: Iranian	Issa Zarepour has been the Iranian Minister of Information and Communications Technology since 25 August 2021. In his position, he played a key role in the Iranian government's decision to systematically violate the Iranian people's freedom of opinion and expression by imposing restrictions on internet access during the protests that followed the death of 22-year old Mahsa Amini on 16 September 2022.	17.10.2022



17.10.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 269 I/13

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
		Gender: male Position: Minister of Information and Communications Technology	That action further diminished the already very limited space for civil society actors in Iran, including human rights defenders, to gather objective information and communicate, both amongst themselves and with the outside world. The internet blackout had negative consequences for the enjoyment of human rights in Iran, both directly (namely the impact on freedom of opinion and expression and availability of objective information) and indirectly (namely the increased chance of human rights violations not being documented thereby negatively impacting accountability for human rights violations). As Minister of Information and Communications Technology, Zarepour is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	
101.	SEPEHR Mohammad-Hossein محمد حسین سپهر	Nationality: Iranian Gender: male Position: Commander of the Iranian Central Training Base of the General Staff of the Armed Forces	Mohammad-Hossein Sepehr is the Commander of the Central Training Base of the General Staff of the Armed Forces in Tehran. He is a member of the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) and the Basij Resistance Force (a volunteer paramilitary organisation operating under the IRGC with branches throughout Iran). Sepehr oversees anti-protest training for Iranian security forces and supports a repressive line towards protesters. He is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
102.	SAFARI Sayd Ali صفری سید علی	Nationality: Iranian Gender: male Rank: Colonel Position: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Saqqez	Colonel Sayd Ali Safari is the head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Saqqez. The LEF's response to the September 2022 protests in Saqqez was particularly harsh. The LEF's excessive use of violence to repress the protests resulted in the deaths of multiple people. As head of the LEF in Saqqez, Safari is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
103.	ADYANI Seyed Alireza (a.k.a. ADJANI Hojjat al-Islam Seyed Alireza) ادیانی سید علی رضا	Nationality: Iranian Gender: male Position: Head of the ideological-political office of Iran's Law Enforcement Forces (LEF)	Seyed Alireza Adyani is the head of the ideological-political office of Iran's Law Enforcement Forces (LEF). Adyani is responsible for defining and implementing rules of engagement for police forces. He stated that the LEF needs to be 'practical' and 'effective' when dealing with adversaries and cheered the Morality Police for doing its job 'intensely'. The LEF has used massive brutality against protesters, including those protesting after Mahsa Amini's death. He is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022



	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
104.	AZADI Ali آزادی علی	Nationality: Iranian Gender: male Rank: Second Brigadier General Function: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Kurdistan	Second Brigadier General Ali Azadi has been the head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Kurdistan since 2019. During the repression of the September 2022 protests, forces under his command in Kurdistan shot protesters and killed and injured multiple people. He is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
105.	SHALIKAR Mohammed Zaman شالیکار محمد زمان	Nationality: Iranian Gender: male Rank: Colonel Function: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Babol, Mazandaran	Colonel Mohammed Zaman Shalikar has been the head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Babol, Mazandaran since 2021. During demonstrations following the death of Mahsa Amini in September 2022, forces under his command shot, injured and killed protesters in Babol, Mazandaran. He is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
106.	HEIDARI Salman حیدری سلمان	Nationality: Iranian Gender: male Rank: Colonel Function: Head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Bukan	Colonel Salman Heidari is the head of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) in Bukan. The LEF's response to the September 2022 protests in Bukan was particularly harsh. The LEF's excessive use of violence to repress the protests resulted in the death of at least one child and in injuries to multiple people. As head of the LEF in Bukan, Heidari is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022

Entities

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
'5.	Iran's Morality Police (a.k.a. Gasht-e-Ershad; Islamic Guidance Patrol; Guidance Patrols) گشتی ارشاد	Address: Vozara Street, corner of 25th Street, District 6, Tehran (Iran)	The Morality Police is part of Iran's Law Enforcement Forces (LEF) and is a special police unit which enforces the strict dress rules for women, including compulsory wearing of a headscarf. The Morality Police has used unlawful force against women for not complying with Iranian hijab laws, sexual and gender-based violence, arbitrary arrests and detentions, excessive violence and torture.	17.10.2022



17.10.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 269 1/15

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
			On 13 September 2022, the Morality Police arbitrarily arrested 22-year old Mahsa Amini in Tehran, allegedly for wearing a hijab improperly. She was subsequently taken to the Morality Police's headquarters for an 'educational and orientation class'. According to reliable reports and witnesses, she was brutally beaten and mistreated in custody, which led to her hospitalisation and to her death on 16 September 2022. The Morality Police's abusive behaviour is not confined to that incident and has been widely documented. The Morality Police is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	
6.	Basij Resistance Force (a.k.a. Basij-e Mostazafan) بسیج مستضعفین		The Basij Resistance Force is a volunteer paramilitary organisation operating under the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC) with branches throughout Iran. The security forces' response to the September 2022 protests in Iran was particularly harsh, resulting in the deaths of multiple people. The Basij Resistance Force was one of the forces ordered by the government to quell those protests. It injured and killed several protesters. The Basij Resistance Force is directly responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
7.	Cyber Defence Command of the Islamic Revolutionary Guard Corps (CDC) فرمانده دفاع سایبری	Address: Tehran (Iran) Telephone: +98 26 3448 9826	The Cyber Defence Command of the Islamic Revolutionary Guard Corps (CDC) monitors websites, e-mails and online activities of individuals deemed to be political opponents. During the September 2022 protests in Iran, the CDC took an active role in the Iranian government's repressive policies, including by identifying and arresting protesters. The CDC is directly responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022
8.	Law Enforcement Forces of the Islamic Republic of Iran (LEF) (a.k.a. NAJA; FARAJA) فرماندهای انتظامی جمهوری اسلامی ایران	Address: Tehran (Iran)	The Law Enforcement Forces of the Islamic Republic of Iran (LEF) is a uniformed police force. The LEF's blatant and severe human rights violations, such as the indiscriminate shooting with live ammunition at peaceful protesters, including children, have been widely documented since protests surrounding the death of Mahsa Amini started in mid-September 2022. Over 70 protesters have died and hundreds were seriously injured, including children. Since the beginning of the demonstrations, police forces have also arbitrarily detained numerous human rights defenders and journalists. The LEF is therefore responsible for serious human rights violations in Iran.	17.10.2022



VENDIM
Nr. 739, datë 23.11.2022

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË
RIMBURSIMIT TË MASAVE
ADMINISTRATIVE TË FALURA, TË
PAGUARA, SIPAS LIGJIT NR. 112/2020,
“PËR REGJISTRIN E PRONARËVE
PËRFITUES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15/1, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare e Biznesit përgatit listën e masave administrative të falura, të paguara, sipas parashikimeve të pikës 8, të nenit 15/1, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

2. Subjektet, të cilave u është falur gjoba e paguar, e vendosur ndaj tyre dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe kanë përmbushur detyrimet përkatëse për regjistrimin e pronarëve të tyre përfitues, paraqesin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit kërkesën për rimbursim, jo më vonë se data 15.12.2022, shoqëruar me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) emrin/mbiemrin e individit/emërtimin e subjektit;
- b) ID kartën e identitetit/NIPT-in;
- c) IBAN-in;
- ç) emrin e bankës pranë së cilës kanë llogarinë personale/llogarinë e subjektit;
- d) vërtetimin bankar, që llogaria bankare ku do të arkëtohet kthimi i gjobës është aktive;
- dh) ekstraktin e regjistrit të të dhënave të pronarëve përfitues.

3. Qendra Kombëtare e Biznesit, pas paraqitjes së dokumentacionit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike, kryen rimbursimin e gjobës në të njëjtën masë (ekuivalente në lek) në llogarinë bankare, të përcaktuar nga subjekti përfitues.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 740, datë 23.11.2022

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E FINANCave DHE
EKONOMISË, PËR RIMBURSIMIN E
MASAVE ADMINISTRATIVE TË
FALURA, TË PAGUARA, SIPAS LIGJIT
NR. 112/2020, “PËR REGJISTRIN E
PRONARËVE PËRFITUES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese fondi, në shumën prej 46 000 000 (dyzet e gjashtë milionë) lekësh, në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për Qendrën Kombëtare të Biznesit, për rimbursimin e masave administrative të paguara, të falura, sipas ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022, dhe i shtohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korrente” të programit buxhetor 04130 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”.

3. Shuma e papërdorur e fondit, sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, kthehet në fondin rezervë të buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2022.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 741, datë 23.11.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR
KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE TË
ARSIMIT TË LARTË PUBLIK TË
PAVARUR (IALPP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 120, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e arsimit të lartë (në vijim “IAL”), të cilat plotësojnë kriteret ligjore për t’u transformuar në institucione publike të pavarura të arsimit të lartë (në vijim “IALPP”), paraqesin kërkesën për transformim, ndërsa institucionet publike dhe subjektet e së drejtës private, në cilësinë e themeluesve, paraqesin kërkesën për krijimin e IALPP-së, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Themeluesi/t paraprakisht, për secilën kategori të IAL-ve, fillojnë procedurat e transformimit në IALPP, si më poshtë vijon:

a) vlerëson me ekspertë të licencuar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, ku do të zhvillojë veprimtarinë IALPP-ja dhe i kontabilizon me vlerën e tregut;

b) themelon fondacionin, sipas kuadrit ligjor në fuqi për organizatat jofitimprurëse, Kodit Civil dhe ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;

c) përgatit dokumentacionin e nevojshëm të fondacionit të themeluar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi për krijimin apo transformimin e IAL-së në IALPP dhe e paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila pas vlerësimit

teknik dhe ligjor të kërkesës, propozon në Këshillin e Ministrave krijimin e IALPP-së së propozuar;

ç) ndjek nëpërmjet portalit “e-Albania” procedurat e nevojshme dhe paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

3. Institucionet publike dhe subjektet e së drejtës private, në cilësinë e themeluesve, paraqesin për krijimin e IALPP-së dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën për themelimin e IALPP-së, e cila duhet të përmbajë emrin dhe objektivat afatgjatë të veprimtarisë arsimore, kërkimore dhe zhvilluese të institucionit;

b) aktin e krijimit dhe statutin e fondacionit, shoqëruar me vendimin e gjykatës kompetente;

c) vendimin e Bordit të Fondacionit për themelimin e IALPP-së;

ç) të dhënat për burimet financiare dhe gjendjen financiare, e cila duhet të garantojë zhvillimin e veprimtarisë së IAL-së, për të paktën 3 (tre) vjet akademikë;

d) planin e zhvillimit të IAL-së për 5 (pesë) vjetet e ardhshëm;

dh) raportin e auditimit financiar nga auditues të jashtëm, referuar nenit 116, të ligjit nr. 80/2015;

e) raportin e vlerësimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në administrim, pronësi apo posedim;

ë) organizimin akademik dhe administrativ të IALPP-së, si dhe dokumentacionin ligjor për personelin akademik dhe administrativ, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;

f) organizimin e programeve të studimit, planeve mësimore, programeve të lëndëve/moduleve të nënshkruara nga titullari i lëndës, jetëshkrimit të titullarit të lëndës, niveleve dhe emërtimeve të diplomave;

g) strukturën e IAL-së (organigrama);

gj) projektstatutin e IALPP-së;

h) kontratat e punës për personelin akademik të punësuar dhe kriteret e punësimit për çdo vend pune në IAL;

i) deklaratën për plotësimin e standardeve akademike;

j) relacionin për infrastrukturën nga inxhinier i licencuar dhe relacionin për laboratorët e bibliotekat, bazuar në standardet shtetërore;



k) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit.

4. IAL-të, që kërkojnë të transformohen në IALPP, kryejnë procedurat paraprake, si më poshtë vijon:

a) administratori i IAL-së, së bashku me auditues të jashtëm, referuar nenit 116, të ligjit nr. 80/2015, bëjnë paraprakisht vlerësimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, duke i kontabilizuar me vlerën e tregut. Shpenzimet për audituesin përballohen nga vetë IAL-ja;

b) administratori i IAL-së, bazuar në pasqyrat financiare të 3 (tri) viteve të fundit, harton raportin e ecurisë financiare të institucionit, ku identifikon masën e financimit nga të ardhurat e IAL-së, e cila duhet të garantojë zhvillimin e veprimtarisë së IAL-së për të paktën 3 (tri) vite akademike;

c) administratori harton planin e zhvillimit të IAL-së për 5 (pesë) vitet e ardhshme;

ç) administratori i IAL-së paraqet për mendim në senatin akademik dokumentacionin për plotësimin e kriterëve të mësipërme dhe gjendjes financiare, si dhe propozimin për transformim të IAL-së në IALPP;

d) në rast se mendimi i Senatit Akademik është pozitiv, atëherë Senati Akademik ia paraqet për vendimarrje Bordit të Administrimit;

dh) Bordi i Administrimit shprehet brenda 1 (një) muaji për propozimin e administratorit. Vendimi i Bordit të Administrimit për transformim duhet të merret me tre të katërtat e votave të anëtarëve të tij;

e) në rast të një vendimi pozitiv për transformim nga Bordi i Administrimit, dokumentacioni dhe vendimi i paraqitet ministrit përgjegjës për arsimin;

ë) fondacioni i themeluar, sipas kuadrit ligjor në fuqi për organizatat jofitimprurëse, Kodit Civil dhe ligjit nr. 80/2015, përgatit dokumentacionin e nevojshëm për ngritjen e IALPP-së dhe e paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila pas vlerësimit të dokumentacionit, sipas këtij vendimi dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 119, të ligjit nr. 80/2015, propozon në Këshillin e Ministrave krijimin e IALPP-së.

5. IAL-të, që kërkojnë të transformohen në IALPP, paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën për transformimin e IALPP-së, e cila duhet të përmbajë emrin dhe objektivat afatgjatë të veprimtarisë arsimore, kërkimore dhe zhvilluese të institucionit;

b) aktin e krijimit dhe statutin e fondacionit, shoqëruar me vendimin e gjykatës kompetente;

c) aktin e hapjes së IAL-së, aktin e akreditimit institucional dhe të të gjitha programeve të studimit;

ç) vendimin e Bordit të Fondacionit për themelimin e IALPP-së;

d) të dhënat për burimet financiare dhe gjendjen financiare, e cila duhet të garantojë zhvillimin e veprimtarisë së IAL-së, për të paktën 3 (tre) vjet akademikë;

dh) planin e zhvillimit të IAL-së për 5 (pesë) vjetet e ardhshme;

e) raportin e auditimit financiar nga auditues të jashtëm, referuar nenit 116, të ligjit nr. 80/2015;

ë) raportin e vlerësimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në administrim, pronësi apo posedim;

f) organizimin akademik dhe administrativ të IALPP-së, si dhe dokumentacionin ligjor për personelin akademik dhe administrativ, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;

g) organizimin e programeve të studimit, planeve mësimore, programeve të lëndëve/moduleve të nënshkruara nga titullari i lëndës, jetëshkrimit të titullarit të lëndës, niveleve dhe emërtimeve të diplomave;

gj) strukturën e IAL-së (organigrama);

h) projektstatutin e IALPP-së;

i) kontratat e punës për personelin akademik të punësuar, të paktën për 1 (një) vit akademik dhe kriteret e punësimit për çdo vend pune në IAL;

j) deklaratën për plotësimin e standardeve akademike;

k) relacionin për infrastrukturën nga inxhinier i licencuar dhe relacionin për laboratorët e bibliotekat, bazuar në standardet shtetërore;

l) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit;

ll) pasqyrat financiare për 3 (tre) vjetet e fundit;

m) deklaratën analitike për tatimin mbi të ardhurat dhe deklaratat e tatimit mbi të ardhurat



nga burime të tjera, për 3 (tre) vjetët e fundit, sipas kuadrit ligjor përkatës në fuqi;

n) vërtetimet që themeluesit nuk janë palë të paditura në procese gjyqësore, që kanë të bëjnë me çështje thelbësore, të cilat lidhen me veprimtarinë e IALPP-së.

6. IAL-të jopublike, që kërkojnë të transformohen në IALPP, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikën 5, paraqesin edhe dokumentet, si më poshtë vijon:

a) dokumentin zyrtar të akreditimit për institucionet private, që zotërojnë një formë akreditimi në një shtet tjetër;

b) dokumentin zyrtar të bashkëpunimit, si dhe dokumentin zyrtar të akreditimit të institucionit bashkëpunues, nëse ka, në rast se institucioni parashikon të ofrojë programe studimi të përbashkëta me IAL-të e tjera, vendase apo të huaja;

c) kontratën tip që studenti lidh me IALPP-në, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

ç) vërtetimet që themeluesit nuk janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

d) vërtetimin nga gjykata që IAL-ja ekzistuese nuk është në procedura falimentimi;

dh) vërtetimin nga prokuroria që personi juridik dhe (ose) përfaqësuesi i tij nuk janë në ndjekje penale.

7. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për krijimin e IALPP-së apo transformimin e IAL-së në IALPP është, si më poshtë vijon:

a) dokumentacioni shqyrtohet, sipas rregullave të brendshme të ministrisë përgjegjëse për arsimin brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të tij në portalin “*e-Albania*”. Në rast se konstatohen mangësi në dokumentacion, ministria përgjegjëse për arsimin i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda afatit kohor prej 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) kur dokumentacioni është i plotë, sipas kërkesave të këtij vendimi, vijon procedura me vlerësimin e plotësimit të standardeve nga ekspertë të jashtëm, nga lista e miratuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, të cilët caktohen me urdhër të ministrit

përgjegjës për arsimin. Numri i ekspertëve për vlerësimin paraprak institucional, tarifat që paguhën nga IAL-të, si dhe masa e pagesës së ekspertëve përcaktohen në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

c) ekspertët brenda 21 (njëzet e një) ditëve dorëzojnë raportin e vlerësimit në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga ekspertët, ministria përgjegjëse për arsimin njofton subjektin, i cili bën plotësimet e nevojshme brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga marrja e njoftimit;

ç) nëse pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet nga subjekti brenda këtij afati, prezumohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

d) dokumentacioni me plotësime i depozituar nga subjekti i përcillet ekspertëve, të cilët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dorëzojnë raportin e rivlerësuar. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministri i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

8. IAL-të publike, të cilat transformohen në IALPP, sipas përcaktimeve në këtë vendim, kthejnë në buxhetin e shtetit të gjitha fondet buxhetore të përfituara dhe të pashpenzuara deri në atë moment.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 742, datë 23.11.2022**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE
QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË
“SAMITIT BE-BP”, TË DATËS 6
DHJETOR 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të “Samitit të BE-BP”, që do të organizohet në Tiranë, në datën 6 dhjetor 2022.

2. Efekti financiar, prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM**Nr. 2913/2, datë 21.11.2022****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Komisionit të Posaçëm për Shqyrtimin e

Detyrimeve që Rrijedhin nga Vendimet Gjyqësore të Formës së Prerë për Menaxhimin/Rikthimin në një Pozicion të Shërbimit Civil, ish-punonjësit e Ministrisë së Brendshme, z. Ardian Maçi, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Posaçëm, si dhe Sekretariati Teknik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË BRENDSHME
Enea Hoti**

UDHËZIM**Nr. 186, datë, 28.9.2022**

**MBI PROCEDURAT PËR SIGURIMIN E
ASISTENCËS NË TRANZIT, ME
QËLLIM KTHIMIN NË RRUGË AJRORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 123, pika 2, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me qëllim harmonizimin e procedurave për ofrimin e asistencës në rastet e tranzitit për qëllime të largim/dëbimit në rrugë ajrore,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave për ndihmën midis autoriteteve kompetente në aeroportet e shteteve të tranzitit, në lidhje me largim/dëbimet e pashoqëruara dhe të shoqëruara në rrugë ajrore.

2. Përkufizime:

a) “Shtetas i një vendi të tretë” është çdo person që nuk është shtetas i shteteve (palë) kontraktuese.

b) “Shtet kontraktues kërkuar” është shteti (palë) kontraktues, që zbaton një vendim kthimi, në lidhje me një shtetas të palëve kontraktuese ose të një shtetasi të vendit të tretë.

c) “Shtet i tranzitit” është shteti ku ndodhet aeroporti i tranzitit nëpërmjet të cilit do të kryhet tranziti.

d) “Shoqërues” është personeli i sigurisë përgjegjës për shoqërimin e shtetasit të vendit të tretë, përfshirë personat përgjegjës për kujdesin mjekësor dhe përkthyesit.

e) “Tranzit ajror” është kalimi i shtetasit të vendit të tretë dhe sipas nevojës, kalimi i



shoqëruesve përmes zonës së aeroportit të shtetit të kërkuar për qëllimet e largim/dëbimit në rrugë ajrore.

3. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që dëshiron të kthejë në rrugë ajrore një shtetas të një vendi të tretë, shqyrton mundësinë e përdorimit të një fluturimi direkt drejt shtetit të destinacionit.

4. Kur autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dëshiron të kthejë një shtetas të një vendi të tretë, por për arsye të rrethanave praktike të arsyeshme nuk mund të përdorë një fluturim direkt drejt vendit të destinacionit, ai mund të kërkojë tranzitin ajror nëpërmjet një tjetër shteti (palë) kontraktues. Nuk bëhet kërkesë për tranzit ajror në parim, nëse masa e largimit kërkon ndryshim të aeroportit në territorin e shtetit kontraktues të kërkuar.

5. Shteti kontraktues i kërkuar mund të refuzojë tranzitin ajror, nëse:

a) shtetas i një vendi të tretë akuzohet për vepra penale ose kërkohet për kryerjen e një dënimi, sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit kontraktues të kërkuar;

b) tranziti nëpër shtete të tjera ose pranimi nga vendi i destinacionit nuk është i realizueshëm;

c) masa e largimit kërkon ndryshimin e aeroportit në territorin e shtetit kontraktues të kërkuar;

d) ndihma e kërkuar nuk mund të jepet në një moment të caktuar për arsye praktike;

e) shtetasi i vendit të tretë mund të jetë kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, për sigurinë kombëtare ose mund të cenojë marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit kontraktues.

6. Në rastin e paragrafit 5, germa “d”, shteti kontraktues i kërkuar duhet të informojë brenda 24 orëve autoritetin kompetent të shtetit kontraktues kërkues për një datë sa më afër datës së kërkuar në fillim, në të cilën mund të realizohet tranziti ajror për sa kohë që janë plotësuar kushtet e tjera.

7. Autorizimet për tranzit ajror të cilat janë lëshuar tashmë, mund të revokohen nga shteti kontraktues i kërkuar, nëse pas autorizimit shfaqen rrethana sipas kuptimit të paragrafit 5, të cilat justifikojnë refuzimin e tranzitit.

8. Shteti kontraktues i kërkuar njofton menjëherë shtetin kontraktues kërkues për

refuzimin ose revokimin e autorizimit për tranzitin ajror, në zbatim të paragrafit 5 ose 7, ose për çdo arsye tjetër pse tranziti nuk është i mundur duke dhënë një shpjegim për arsyet përkatëse.

9. Kërkesa për tranzit ajror të shoqëruar ose të pashoqëruar dhe për masat shoqëruese të ndihmës në zbatim të paragrafëve 15, 16 dhe 17, bëhet me shkrim nga shteti kontraktues kërkues. Ajo dërgohet në shtetin kontraktues të kërkuar sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast, jo më vonë se dy ditë përpara tranzitit. Ky afat kohor mund të mos respektohet në raste veçanërisht urgjente dhe të justifikuara.

10. Shteti kontraktues i kërkuar informon shtetin kontraktues kërkues për vendimin e marrë prej tij brenda dy ditësh. Ky afat kohor mund të shtyhet në raste të justifikuara, për një maksimum prej 48 orësh.

Tranziti ajror nuk fillon pa miratimin e shtetit kontraktues të kërkuar, në rastet:

a) kur asnjë shtet kontraktues i kërkuar nuk përgjigjet brenda afateve sa më sipër, operacionet e tranzitit mund të fillojnë me anë të një njoftimi nga shteti kontraktues kërkues;

b) mund të parashikohet, në bazë të marrëveshjeve ose masave dypalëshe ose shumëpalëshe, që operacionet e tranzitit të fillojnë me anë të një njoftimi nga shteti kontraktues kërkues.

11. Për të kërkuar dhe autorizuar tranzitin ajror, autoriteti i shtetit kontraktues kërkues i përcjell autoritetit të shtetit kontraktues të kërkuar informacionin e duhur nëpërmjet postës elektronike zyrtare.

12. Shteti kontraktues kërkues i jep shtetit kontraktues të kërkuar detajet e çdo kërkesë për tranzit.

13. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve është përgjegjës për trajtimin e kërkesave për tranzit ajror.

14. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve cakton pikat e kontaktit për aeroportin/et përkatëse të tranzitit, të cilat mund të kontaktohen gjatë gjithë operacioneve të tranzitit.

15. Shteti kontraktues kërkues merr masat e duhura për të siguruar që operacioni i tranzitit të kryhet në kohën më të shkurtër të mundshme. Operacioni i tranzitit kryhet maksimalisht brenda 24 orëve.



16. Shteti kontraktues i kërkuar, në bazë të konsultimeve të ndërsjella me shtetin kontraktues kërkuar, brenda kufijve të mjeteve në dispozicion dhe në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, ofron të gjitha masat ndihmëse të nevojshme që nga ulja dhe hapja e dyerve të mjeteve të fluturimit, derisa të sigurohet që shtetasi i vendit të tretë të jetë larguar. Konsultimet e ndërsjella nuk janë të nevojshme, në rastet e përmendura në paragrafin 17, germa “b”.

17. Konsultimet e ndërsjella kanë të bëjnë me masat e mëposhtme të ndihmës, në veçanti:

a) marrja e shtetasit të vendit të tretë në mjetin e fluturimit dhe shoqërimi i tij brenda mjediseve të aeroportit të tranzitit, në veçanti drejt fluturimit të tij lidhës;

b) ofrimi i kujdesit mjekësor emergjent për shtetasin e vendit të tretë dhe, nëse është nevojshme, për shoqëruesin e tij;

c) ofrimi i ushqimit për shtetasin e vendit të tretë dhe, nëse është e nevojshme, për shoqëruesin e tij;

d) marrja, ruajtja dhe dërgimi i dokumenteve të udhëtimit, veçanërisht në rastet e largimeve të pashoqëruara;

e) në rastet e tranzitit të pashoqëruar, informimi i shtetit kërkuar për vendin dhe kohën e nisjes së shtetasit të vendit të tretë nga territori i shtetit anëtar në fjalë;

f) informimi i shtetit kërkuar nëse kanë ndodhur incidente serioze gjatë tranzitit të shtetasit të vendit të tretë.

18. Në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, pala e kërkuar mund të:

a) vendosë dhe akomodojë shtetasit e një vendi të tretë në një objekt të sigurt;

b) përdorë mjete legjitime për të parandaluar ose për t'i dhënë fund çdo përpjekjeje të shtetasit të vendit të tretë për të kundërshtuar tranzitin.

19. Në rastet kur përfundimi i operacioneve të tranzitit nuk mund të garantohet pavarësisht ndihmës së dhënë në përputhje me paragrafët 16 dhe 17, pala e kërkuar, sipas kërkesës nga/dhe në konsultim me palën kërkuese, mund të marrë të gjithë masat ndihmëse të nevojshme për të vazhduar operacionin e tranzitit. Në këto raste, afati kohor i përmendur në paragrafin 15, mund të shtyhet deri në një maksimum prej 48 orësh.

20. Autoritetet kompetente të palës së kërkuar, përgjegjëse për masën, vendosin për natyrën dhe

masën e ndihmës së ofruar, sipas paragrafëve 17, 18 dhe 19.

21. Kostot e shërbimeve të ofruara, sipas paragrafit 17, germat “b” dhe “c”, mbulohen nga pala kërkuese.

22. Palët e interesuara japin informacionin e nevojshëm për kriteret e matjes së kostove.

23. Pala kërkuese merr përsipër të ripranojë menjëherë shtetasit e një vendi të tretë, nëse:

a) autorizimi për tranzitin ajror është refuzuar apo revokuar;

b) shtetasi i vendit të tretë ka hyrë në shtetin anëtar të kërkuar pa autorizim gjatë tranzitit;

c) largimi i shtetasit të vendit të tretë drejt një tjetër vendi tranziti ose drejt vendit të destinacionit, ose hipja në bordin e fluturimit lidhës, kanë qenë të pasuksesshme; ose

d) tranziti ajror është i pamundur për një arsye tjetër.

24. Pala e kërkuar ndihmon në ripranimin e shtetasit të një vendi të tretë në shtetin e palës kërkuese, në rastet e përmendura në paragrafin 23. Pala kërkuese mbulon shpenzimet për kthimin shtetasit të një vendi të tretë.

25. Gjatë kryerjes së operacionit të tranzitit, kompetencat e shoqëruesve zbatohen vetëm për vetëmbrojtje. Përveç kësaj, në mungesë të zyrtarëve të zbatimit të ligjit nga shteti i tranzitit ose me qëllim të mbështetjes së zyrtarëve të zbatimit të ligjit, shoqëruesit mund të ndërmarrin veprime të arsyeshme dhe proporcionale në përgjigje të një rreziku të menjëhershëm dhe serioz, në mënyrë që të parandalojnë që shtetasi i një vendi të tretë të arratiset, të shkaktojë dëmtim ndaj vetes ose ndaj një pale të tretë ose dëmtim të pronës. Në të gjitha rrethanat, shoqëruesit duhet të veprojnë në përputhje me legjislacionin e palës së kërkuar.

26. Shoqëruesit nuk mbajnë armë gjatë tranzitit ajror dhe mbajnë veshur rroba civile. Ata paraqesin mjetet e duhura të identifikimit, përfshirë autorizimin e tranzitit të dhënë nga shteti i tranzitit ose, kur është e zbatueshme, njoftimin e përmendur në paragrafin 8, me kërkesën e shtetit të kërkuar.

27. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

28. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 176, datë 15.9.2022

**MBI PROCEDURËN E SHPALLJES SË
TË HUAJIT PERSON I PADËSHIRUAR
DHE MIRATIMIN E MODELIT TË
URDHRIT PËR SHPALLJEN E NJË TË
HUAJI PERSON I PADËSHIRUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 104, pika 4, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me qëllim rregullimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për shpalljen e të huajt “person të padëshiruar” në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

1. Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve të përcaktuara në nenin 4, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë ligjore dhe përcaktimeve në nenin 104, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i propozojnë ministrit të Brendshëm shpalljen e të huajt si “person i padëshiruar”, duke argumentuar arsyen e kërkesës/propozimit.

2. Strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë ligjore, kanë të drejtën të propozojnë shpalljen e të huajt si “person i padëshiruar”, duke argumentuar arsyen e propozimit/kërkesës.

3. Ministri i Brendshëm, bazuar në propozimin/kërkesën e autoriteteve përgjegjëse të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, nxjerr urdhrin e shpalljes së të huajt si person i padëshiruar, sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi dhe njofton zyrtarisht Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ministri i Brendshëm, në rast

të refuzimit të propozimit të një të huaji si person i padëshiruar argumenton refuzimin, si dhe informon institucionin propozues.

4. Pasi njoftohet zyrtarisht nga ministri i Brendshëm për urdhrin e shpalljes “person i padëshiruar”, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, përgatit urdhrin e dëbimit për të huajin “person i padëshiruar” dhe e dërgon për nënshkrim pranë ministrit të Brendshëm.

5. Ministri i Brendshëm, pas nxjerrjes së urdhrit të dëbimit, njofton zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, e përcjell atë për ekzekutim pranë autoritetit shtetëror përgjegjës në nivel vendor për kufirin dhe migracionin.

6. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për kufirin dhe migracionin, pasi njoftohet zyrtarisht për urdhrin e dëbimit të nxjerrë nga ministri i Brendshëm, njofton të huajin dhe ekzekuton urdhrin e dëbimit, bazuar në kërkesat e nenit 106, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

**MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**
Olta Xhaçka

**DREJTOR I DEPARTAMENTIT
ORGANIZATIV DHE BASHKËPUNIMIT NË
DREJTORINË E SHËRBIMIT INFORMATIV
TË SHTETIT**
Rafail Milo



ANEKSI NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

“Sekret”

Nr. ____ prot.

Afati i klasifikimit ____ vjet

Kopje ____

Tiranë, më ____ . ____ . ____

URDHËR

Nr. ____ , datë ____ . ____ . ____

PËR SHPALLJE “PERSON TË PADËSHIRUAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1, të nenit 104, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, dhe të udhëzimit nr. ____, datë ____ . ____ . 20__, të Ministrit të Brendshëm, “Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”,

Bazuar në propozimin/kërkesën e autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve,

URDHËROJ:

1. Shpalljen “person të padëshiruar” në Republikën e Shqipërisë, për një periudhë ____ -vjeçare, për ____ të shtetasit:

Mbiemri Emri

Emri i babait Emri i nënës

Datëlindja Vendlindja

Gjinia

Shtetësia Nr. i dokumentit

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 220, datë 8.11.2022

MBI PROCEDURËN E ZGJATJES,
AFATET E ZGJATJES SË QËNDRIMIT,
RASTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË, SI
DHE DOKUMENTIN ME TË CILIN
PAJISET I HUAJI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 26, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”,

UDHËZOJMË:

1. I huaji, i pajisur me vizë për të hyrë dhe qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose i huaji i cili i nënshtrohet regjimit për hyrjen dhe qëndrimin pa vizë për një periudhë të përcaktuar, sipas ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, mund të kërkojë zgjatjen e afatit të qëndrimit, duke paraqitur një kërkesë *online* drejtuar autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku ka banimin e përkohshëm, ku të përcaktojë:

a) arsyen për të cilën nuk ka pasur mundësi të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë para përfundimit të afatit të qëndrimit të përcaktuar në vizë/ligj;

b) afatin për të cilin kërkon zgjatjen e qëndrimit.

2. Kërkesa e arsyetuar duhet të depozitohet jo më vonë se 7 ditë para përfundimit të afatit të qëndrimit të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të jetë e shoqëruar me dokumentacionin, si më poshtë:

a) formularin sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

b) dy fotografi;

c) dokumente të tjera justifikuese të motivit për të cilin kërkohet zgjatja e afatit.

3. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin përcjell kërkesën brenda 24 orëve nga depozitimi, pranë autoritetit qendror të kufirit dhe migracionit, e cila shqyrtohet në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave pranë këtij autoriteti.

Komisioni i propozon autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin miratimin ose refuzimin e kërkesës, si dhe njofton autoritetin vendor mbi vendimin e marrë, brenda 24 orëve nga depozitimi i kërkesës pranë këtij institucioni.

4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në bazë të vlerësimeve rast pas rasti, kërkon nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin verifikimin e arsyes së pretenduar nga i huaji, subjekt i kërkesës për zgjatjen e qëndrimit. Në këtë rast, përgjigja nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin duhet të jepet brenda 24 orëve nga kërkesa e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

5. Komisioni merr vendim mbi miratimin/refuzimin e kërkesës, brenda 3 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

6. Në rast të miratimit të kërkesës, autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin ku i huaji ka vendqëndrimin e përkohshëm, pajis të huajin subjekt të zgjatjes së qëndrimit me dokument në formatin e leje qëndrimit të tipit “A”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858/2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. Shtetasi i huaj, kur largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, paraqet dokumentin e zgjatjes së qëndrimit në Pikën e Kalimit Kufitar për të evituar penalitetet për qëndrimin e parregullt në territor.

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria për Evropën dhe Punës e Jashtme.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka



ANEKS NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
DVKM _____

Foto / Photo
3.5x4.5 cm

FORMULAR ZGJATJE QËNDRIMI NË SHQIPËRI
STAY EXTENSION FORM

Aplikim për zgjatje të / Application for extension of

☐ Afatit të Vizës / Term of Visa	☐ Zgjatje të qëndrimit në Shqipëri / Extension of stay in Albania
Zgjatja kërkohet deri / Extension is requested until: _____	

Kërkesa të shoqërohet me pasaportën tuaj. Të plotësohen të gjitha rubrikat me shkronja kapitale.
To be submitted with your passport to the authorities. All boxes must be filled in and write in Roman capitals.

I. Informacion për aplikantin / Information about the applicant

Mbiemri / Surname (family name)		Mbiemri i mëparshëm / Earlier surname (Earlier family name)	
Emri / First names (given names)			
Shtetësia / Nationality			
Ditëlindja / Date of birth Dita, muaji, viti / Day, month, year	Gjinia / Sex ☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Women	Gjendja Civile / Marital status ☐ Martuar / Married ☐ Divorcuar / Divorced ☐ Beqar / Single ☐ I(e) vel / Widow(er)	
Adresa në vendin e origjinës / Address in home country			

II. Informacion i dokumentit të udhëtimit / Travel document information

☐ Pasportë Kombëtare / National passport	☐ Other travel document
Nr. Pasaportës / Passport no.	Data e lëshimit / Date of issue
Data e skadimit të pasaportës / Passport expiry date	
Autoriteti lëshues / Issuing authority	Shteti / Country
Cila ambasade, mision diplomatik ka lëshuar vizën? Which embassy/diplomatic mission issued your visa?	
Nr. serial i vizës / Visa sticker no.	E vlefshme deri: _____ ditë : Valid until _____ days:
Data e hyrjes së fundit në territorin e Shqipërisë / Date of last entry into the Albanian area	

III. Arsyeja / qëllimi i aplikimit për zgjatje / Reason for / purpose of the application for extension

☐ Forcë madhore / Force majeure	☐ Shëndetësore / Health
☐ Arsye humanitare / Humanitarian grounds	☐ Të tjera / Other
(Të bashkëlidhen dokumente / Documentation must be attached)	
Pritësi / Visiting	
☐ Bashkëshort / Spouse	☐ Partner Civil / Cohabitant
☐ Prind / Parents	☐ Vëlla/Motër / Brother/sister
☐ Fëmijë / Child	☐ Partner Biznesi / Business partner
☐ Të tjera / Other	



IV. Informacion për personin referues në Shqipëri / Information about the reference person in Albania

Emri / Name	Shtetas shqiptar? / Albanian Citizen? ☐ Po / Yes ☐ Jo / No
Adresa, Qyteti / Address, city	Telefon nr. / Telephone no.
A pranon pritësi të plotësohet ky aplikim për zgjatjen e qëndrimit tuaj? will the host accept that an application is being filed for an extended stay with him/her? ☐ Po / Yes ☐ Jo / No	
A do të mbulojë pritësi shpenzimet për qëndrimin tuaj? / will the host pay for your stay? ☐ Po / Yes ☐ Jo / No	

V. Komente për Aplikimin / Applicant's comments

VI. Deklarim i pranimit dhe nënshkrimit / Declaration of consent and signature

A. Deklarata e korrektësisë . Unë konfirmoj, që i gjithë informacioni i hedhura nga mua në këtë formular aplikimi është i vërtetë dhe i plotë. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacioni të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e kërkesës ose riatdhesimi dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipëri B. Deklarata e pranimit për të lejuar autoritetet për të mbledhur informacionin e nevojshëm. Unë jam dakord për të lejuar autoritetet përkatëse të bëjë hetimet në lidhje me çështjet e mia private për të mundësuar ata që të merren me aplikimin tim, në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga mua në mbështetje të aplikimit tim C. Njoftim se autoritetet shqiptare kanë regjistruar informacion rreth jush dhe biznesit tuaj. Në përputhje me Aktin mbi Përpunimin e të Dhënave Personale , autoritetet Shqiptare janë të detyruara të njoftojnë se informatat të cilat ju keni dhënë në lidhje me aplikimin tuaj për vazhdimin e qëndrimit tuaj do të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar Elektronik të të Huajve, i cili është një regjistër i kompjuterizuar, për të cilin është përgjegjës Shërbimi i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin. Për shqyrtimin e çështjeve të qëndrimit tuaj në Shqipëri, informacioni do të përdoret nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Autoritete të tjera relevante A. Sworn declaration of correctness I hereby that the information I submit in this application is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory. B. Declaration of consent to allow authorities to gather necessary information. I consent to letting the relevant authorities make enquiries about my entirely private affairs for the purpose of enabling them to deal with my application, about documents submitted by me in support of my application. C. Notification that Albanian authorities have registered information about you and your affairs. In accordance with the Act on Processing of Personal data, Albanian authorities are obliged to notify you that the information which you have supplied in connection with your application for extension of your stay will be registered in the Foreigner Electronic Register, which is a computerized register for which the Department for border and Migration Service is responsible. The information will be used in connection with the consideration of issues regarding your stay in Albania, by the Department for Border and Migration and other relevant authority	
Vendi dhe data / Date and place	Nënshkrimi / Signature

Për përdorim zyrtar / For official use only

Bashkangjitur ☐ Pasaporta ose Dokument tjetër udhëtimi ☐ Të tjera	Data e pranimit : _____ Pranuar nga (nënshkrimi): _____
---	--

Aprovuar ☐ PO ☐ JO _____
Komente:

**URDHËR****Nr. 223, datë 22.11.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të ndryshuar; dhe të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor z. Enea Hoti, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik, koncesionet dhe partneritetin publik privat, për Ministrinë e Brendshme.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Ministrisë së Brendshme, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik, do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Çdo urdhër i mëparshëm delegimi, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, z. Enea Hoti.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM**Nr. 505, datë 21.11.2022****PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË
GJYKATËS SË APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 13 dhe 66, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të

Faqe | 18900

ndryshuar; nenin 44 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; me propozim të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, znj. Brikena Ukperaj dhe znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:**SEKSIONI I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Emërtimi dhe selia**

1. Gjykata e Apelit Tiranë emërtohet Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm fillon funksionimin më datë 1.2.2023.

3. Selia e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është në Tiranë, në adresën Bulevardi “Zhan D’Ark”.

4. Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë më datë 31.1.2023.

SEKSIONI II**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM****Neni 2****Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit
të Përgjithshëm**

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në gjykatën e apelit Tiranë qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në gjykatat e apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.



4. Pozicionet e shpallura për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, për të cilat në datën 1.2.2023 nuk ka përfunduar ende procedura e ngritjes në detyrë, konsiderohen pozicione të lira të përhershme në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Këshilli i Lartë Gjyqësor vijon procedurën e ngritjes në detyrë për këto pozicione të lira, për llogari të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas ligjit.

SEKSIONI III

ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimit të ligjit, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit.

4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë qëndron në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

SEKSIONI IV

ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4

Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Apelit Tiranë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e gjykatave të apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 5

Ndihmësit ligjorë

1. Ndihmësi ligjor me emërim përfundimtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Ndihmësi ligjor me emërim përfundimtar në gjykatat e apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilit i suprimohet pozicioni, për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në mënyrë të përhershme në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

SEKSIONI V

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 6

Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.1.2023, por që



nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 7

Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rindahen me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2. Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga të njëjtët gjyqtarë.

3. Për efekt të riorganizimit, transferimit dhe menaxhimit të çështjeve, planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, bëhet deri në 31.12.2022. Ky rregull nuk gjen zbatim për çështjet urgjente sipas ligjit.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 8

Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

1. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda muajit shkurt 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë, që rrjedhin nga mbyllja në datën 31.1.2023, e aktivitetit ekonomiko-financiar të gjykatave të apelit.

Neni 9

Hyrja në fuqi e vendimit

1. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Naureda Llagami

URDHËR
Nr. 164, datë 21.11.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 149/a, pika “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 157, pika “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe të nenit 73, pika 2, të vendimit nr. 285/2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zotit Emis Çërava.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik, do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri zoti Emis Çërava, Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Alfred Balla



VENDIM
Nr. 270, datë 2.11.2022

**MIRATIMI I “PROJEKTPROPOZIMIT
TË TAP-it, SRG-së DHE DESFA-së,
PËR PROCESIN E KAPACITETIT
RRITËS 2021–TETOR 2022”**

*Propozuar nga TAP AG dhe bashkëngjitur si
shtojca B*

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13; 15, pika 1, germa “a”; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përfundimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet, sipas direktivës 2009/73/EC (“Opinionit Përfundimtar i Përbashkët”), si dhe Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013; të neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror mbi miratimin e “Projektpropozimi i TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për Procesin e Kapacitetit Rritës 2021–tetor 2022”, sipas dokumentit të paraqitur nga TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja në datën 31 tetor 2022,

kujtojmë se:

- Me datë 1 shtator 2011, TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) “Aplikimin e Përfundimit për Gazsjellësin Trans Adriatik”, në përputhje me nenin 22, të direktivës së gazit 2003/55/EC;

- Në muajin qershor 2013, Ministria Italiane, Autoriteti Rregullator Grek (RAE) dhe ERE morën vendimin për përjashtimin nga dispozitat e nenit 9, 32 (“Aksesi i palëve të treta TPA”) dhe nenit 41.6, 41.8, 41.10 (“Tarifat e rregulluara”) të direktivës së gazit për kapacitetin fillestar prej 10 miliardë metrash kub në vit, sipas disa kushteve, duke përshtatur Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (këtu dhe më poshtë “FJO”), një dokument i hartuar së bashku nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë “Autoritetet”) dhe ndryshuar për t’u përputhur me vendimin e

komisionit [C(2013)2949 përfundimtar], datë 16 maj 2013.

- Opinionin 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013;

- Direktivën 2009/73/EC, të Parlamentit Evropian, të datës 13 korrik 2009;

- Direktivën e BE-së 2019/692, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 17 prill 2019;

- Rregulloren 715/2009/EC, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 13 korrik 2009;

- Rregulloren 2019/942/EC, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 5 qershor 2019;

- Rregulloren e re të BE-së 459/2017, miratuar më 16 mars 2017, që miraton Kodin e Rrjetit, i cili përcakton mekanizmat e shpërndarjes së kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit si për kapacitetin ekzistues ashtu edhe për atë në rritje (në tekstin më poshtë “CAM NC”),

duke marrë në konsideratë se:

- Sipas paragrafi 4.1, të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar, TAP AG kryen një test tregu përpara fillimit të dërgesave të gazit, me qëllim që t’u ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitet shtesë deri në arritjen e mundësia maksimale e zgjerimit të tubacionit (i ashtuquajtur kapaciteti zgjerues); në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar, i është dhënë TAP AG një përjashtim nga dispozitat e neneve 9 (“Pandërpreja”), 32 (IPA) për kapacitetin fillestar prej 10 bcm/vit dhe 41.6, 41.8, 41.10 (“Tarifat e rregulluara”) të direktivës së gazit, për një periudhë 25-vjeçare duke filluar nga fillimi i datës së funksionimit tregtar, në disa kushte.

- Ndër të tjera, sipas nenit 4.1 të FJO-së, TAP AG është i detyruar të kryejë testet e tregut në baza të rregullta, duke filluar jo më vonë se data e operacionit tregtar dhe, më pas, të paktën çdo dy vjet. TAP AG do të kryejë testet e tregut, sipas udhëzimeve të miratuara nga autoritetet, me synimin për t’u ofruar të gjitha palëve të interesuara kapacitet shtesë të disponueshëm deri në kapacitetin total prej 20 bcm/vit.

- Testi i Tregut, i përmendur në paragrafin e mëparshëm, duhet të kryhet sipas udhëzimeve të miratuara bashkërisht nga autoritetet rregullatore të energjisë italiane (ARERA), greke (RAE) dhe shqiptare (ERE) (në tekstin e mëtejshëm “autoritetet”);

- Me vendimin nr. 95, datë 17.6.2019 u miratuan bashkërisht “Udhëzimet për testimin e tregut të



Gazsjellësit Trans Adriatik 2019”, të paraqitur nga kompania TAP AG;

- Me vendimin nr. 122, datë 11.5.2021 u miratuan bashkërisht “Projektpropozimin e TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e rritjes së kapaciteteve 2019”, të paraqitur nga kompanitë TAP AG, SRG dhe DESFA; cikli i rritjes së kapaciteteve i filluar në vitin 2019 përfundoi me rezultate negative në vitin 2021, pasi nuk u dorëzua asnjë aplikim për kapacitete detyruese;

- Me vendimin nr. 151, datë 29.6.2021 u miratuan bashkërisht “Udhëzimet për testin e tregut 2021 të Gazsjellësit Trans Adriatik” (më tej “Udhëzimet e testit të tregut”) të paraqitur nga kompania TAP AG dhe në lidhje me kapacitetin e ri rritës duke filluar më 2021.

- Në datën 6 tetor 2022, SRG, TAP dhe DESFA iu paraqitën për shqyrtim tre rregullatorëve të energjisë, ERE, RAE dhe ARERA, Projektin “Procesi i rritjes së kapacitetit 2021”.

Duke pasur parasysh, se:

- CAM NC, i miratuar disa vite pas Opinionit të Përbashkët Përfundimtar, parashikon që OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmetimit) të kryejnë një procedurë të koordinuar për ofrimin e kapaciteteve shtesë në pikat e ndërlidhjes me vendet e Bashkimit Evropian dhe që kjo procedurë të fillojë në korrespondencë të kryerjen e ankandëve vjetore të kapaciteteve të parashikuara nga i njëjti CAM NC të hënën e parë të korrikut të paktën në të gjitha vitet teke;

- Kompania TAP AG ka nisur një proces koordinimi me OST-të ngjitur në mënyrë që zgjerimi i TAP-it të jetë në përputhje me zgjerimin e pikave përkatëse të ndërlidhjes;

- Udhëzimet e testit të tregut përputhen, për aq sa është e mundur me dispozitat e Opinionit të Përbashkët Përfundimtar me parashikimet e CAM NC;

- Në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, më 5 korrik 2019 TAP AG nisi fazën jodetyruese të procesit të Kapacitetit Rritës për TAP-in, në koordinim me OST-të italiane dhe greke, përkatësisht SRG-ja dhe DESFA. Të tria OST-të publikuan së bashku Raportin e Vlerësimit të Kërkesës, më 25 tetor 2021, duke arritur në përfundimin se indikacionet e marra ishin të mjaftueshme për të vazhduar me fazat pasuese të projektit të kapaciteteve shtesë;

- Në janar 2022, SRG-ja, DESFA-ja dhe TAP-i, në përputhje me nenin 27 (3) të NC CAM, nisën një konsultim publik mbi një projekt të kapaciteteve në rritje me qëllim të plotësimit, sa më shumë që të jetë e mundur të kërkesave jodetyruese të pranura;

- Pas përfundimit të projektit të kapaciteteve shtesë, me komunikimin e datës 31 tetor 2022, SRG-ja, DESFA-ja dhe TAP-i dërguan dokumentin “Propozimi i projektit të TAP-it, SRG-ja dhe DESFA-ja për procesin e rritjes së kapaciteteve 2021” në ARERA, ERE dhe RAE për miratim (shtojca B për këtë dispozitë);

Propozimi parashikon pikat, si më poshtë:

- Përshkrimi i projektit: rritja e kapacitetit të transportit përgjatë gjithë rrugës, nga Kipoi në Melendugno, nëpërmjet instalimit të stacioneve shtesë të kompresorëve.

- Faza e detyrueshme: mundësia e dorëzimit të ofertave detyruese që në janar 2023 (e ashtuquajtura faza e parë detyruese), me qëllim përshpejtimin e investimeve të nevojshme për rritjen e kapacitetit të disponueshëm në kohën më të shkurtër të mundshme. Në dritën e rezultateve të fazës së parë detyruese, OST-të do të vlerësojnë nevojën për të mbledhur oferta të tjera detyruese (e ashtuquajtura faza e dytë detyruese) gjatë vitit 2023.

- Mënyra e alokimit: përdorimi i të ashtuquajturit “Metodë alternative e shpërndarjes”, e parashikuar nga neni 30 i NC CAM, e cila konsiston në mundësinë e paraqitjes së ofertave detyruese për një horizont kohor të zgjatur deri në maksimum 20 vjet (në vend të 15) dhe të kushtëzuar me marrjen e kapacitetit: i. mbi më shumë pika ndërlidhjeje; ii. për një numër minimal vitesh; iii. për një sasi minimale. Ofertat janë renditur në rend zbritës në lidhje me vlerën aktuale neto të tyre dhe për këtë arsye u jepet përparësi atyre me kohëzgjatje më të gjatë dhe që lidhin më shumë pika ndërlidhjeje. Investimi kryhet nëse ka të paktën një ofertë me kohëzgjatje minimale 3 vjet dhe nëse testi ekonomik i referuar në art. 22 i NC CAM është i suksesshëm.

- Nivelet e ofertës: 4 nivele oferte në hyrje të Kipoi dhe tri nivele oferte në hyrje të Melendugno, që korrespondojnë në Melendugno me një kapacitet total prej 32.8 Gwh/ditë, 80.6 Gwh/ditë dhe 145.6 Gwh/ditë. Nivelet e furnizimit janë llogaritur duke marrë parasysh një PCS prej 9.71 kwh/Sm³ dhe janë të tilla që garantojnë që 10% e



kapacitetit teknik në rritje të rezervohet për produkte afatshkurtra.

- Parametrat ekonomikë: parametrat ekonomikë për çdo OST janë përshkruar në propozimin e Projektit. Testi ekonomik kryhet në mënyrë të pavarur për secilën prej tyre dhe investimet bëhen nëse ky test është i suksesshëm në të dyja anët e një pike interkonjeksioni për të paktën një nivel oferte.

- Afati kohor: kalendar i fazës detyruese përshkruhet në paragrafin “D” të propozimit dhe parashikon që njoftimi i referuar në nenin 28.3 të NC CAM për fillimin e procedurës të publikohet më 14 nëntor 2022 dhe se ndarja e kapacitetit detyrues zhvillohet deri më 30 janar 2023. Kapaciteti vihet në dispozicion në një periudhë të ndryshueshme ndërmjet tremujorit të fundit 2025 dhe tremujorit të fundit të 2027-s, në varësi të nivelit të furnizimit dhe pikës së ndërlidhjes.

- Kushtet kontraktuale: rregullat dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrjen në fazën e lidhjes dhe ndarjes së kapaciteteve janë ato të parashikuara tashmë në kodet e rrjetit të OST-ve individuale. Në lidhje me TAP-in, ekziston një opsion për të zgjedhur kohëzgjatjen e rezervimit të kapacitetit deri në një muaj përpara datës së funksionimit komercial të vetë kapacitetit. Në këtë rast, është përgjegjësi e përdoruesit të TAP-it që të marrë të njëjtin kapacitet edhe në anën tjetër të kufirit, duke e bërë kapacitetin e ndarë brenda një kohe të arsyeshme, me penaltetin e konfiskimit të rezervimit edhe në anën e TAP-it. Kjo e drejtë është dhënë për të zbutur rreziqet e mospërputhjes midis disponueshmërisë së kapacitetit dhe disponueshmërisë së gazit në rrjedhën e sipërme.

Në konkluzion:

- Në zbatim të nenit 4.1.7, TAP AG është i detyruar të përmbushë kërkesat detyruese të kapacitetit që rezultojnë nga çdo test tregu duke marrë parasysh përcaktimet e pikave 3, 6 dhe 9 të §4.7 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar. Zgjerimi bëhet nëse është ekonomikisht i qëndrueshëm, përkatësisht nëse të ardhurat shtesë nga kapaciteti që rezultojnë nga çdo test tregu janë të barabarta ose më të mëdha se kostot rritëse efikase, të përcaktuara sipas metodologjisë së TAP AG siç përcaktohet në Kodin Tarifor të TAP-it.

- Më 28 qershor 2021 (shqyrtimi ARERA 273/2021/R/gas), vendimi i ERE-s nr. 151, datë 29.6.2021, vendimi i RAE 571/2021) respektivisht ARERA, ERE dhe RAE miratuan “Udhëzimet për

testin e tregut 2021 të udhëzimeve të Gazsjellësit Trans Adriatik”.

Pikat kryesore të udhëzimeve të rëndësishme për këtë vendim, janë:

- Palët e interesuara duhet t’u paraqesin autoriteteve një deklaratë për të siguruar që treguesi i kërkesës së tyre jodetyruese përputhet me çdo kapacitet të zbatueshëm; ata duhet, gjithashtu, t’i konfirmojnë TAP AG, të paktën dy javë përpara përfundimit të fazës së vlerësimit që autoritetet e kanë konsideruar kërkesën në përputhje me kufijtë e kapacitetit.

- Faza e detyrueshme është parashikuar në udhëzimet e propozuara sepse rregullat e saj të detajuara do të varen nga kërkesat e marra gjatë fazës jodetyruese dhe do t’i nënshtrohen miratimit të mëtejshëm nga autoritetet.

Më 31 tetor 2022, TAP AG, SRG-ja dhe DESFA-ja paraqitën për miratim tek autoritetet një projektpropozim të përbashkët, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 28 të KK-së të CAM-së.

Sipas CAM-së (neni 28.2), autoritetet duhet të publikojnë vendime të koordinuara për projektpropozimin, duke marrë parasysh pikëpamjet e autoriteteve të tjera rregullatore kombëtare të përfshira.

Ndërkohë:

“Projektpropozimi i TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e kapacitetit rritës 2021–tetor 2022” ka të bëjë me 7 (shtatë) pika të ndërlidhjes (IP) përgjatë gjurmës së TAP-it: Kipoi (IR-GR), Nea Mesimvria (GR), Komotini (GR), Kuçovë (AL), Relievi Roskovec (AL), Fier (AL) dhe Melendugno (IT). Ky projektpropozim, për pjesën e Shqipërisë përfshin, sa vijon:

- Ofertat shtesë të kapacitetit nga TAP-i në pikën e ardhshme të daljes së Kuçovës si kapacitet daljeje të ndara;

- Ofertat shtesë të kapacitetit nga TAP-i në pikën e ardhshme të daljes së Fierit si kapacitet daljeje të ndara;

- Ofertat shtesë të kapacitetit nga TAP-i në pikën e ardhshme hyrëse të Fierit si kapacitet hyrës i ndarë;

- Kapacitetin shtesë të ofruar nga TAP-i si kapacitet dalës i ndarë në pikat përkatëse të daljes së ardhshme të relievit Roskovec.

Për të rritur mundësinë që të ardhurat për Projektin e Kapacitetit Rritës të arrihen në përputhje me dispozitat e nenit 30 (1) të CAM NC



dhe duke marrë parasysh kuadrin rregullator specifik të TAP-it, si dhe gjetjet e indikacioneve jodetyruese të kërkesës, SRG-ja, TAP AG dhe DESFA-ja propozojnë një sërë masash.

Kryerja e mundshme e dy raundeve të fazave detyruese do të realizohen: një i parë në janar 2023 dhe i dyti, nëse është e nevojshme në bazë të rezultateve të fazës së parë të detyrueshme, gjatë vitit 2023;

- Në datën 31 tetor 2022, SRG-ja, TAP-i dhe DESFA-ja iu paraqitën për shqyrtim tre rregullatorëve të energjisë, ERE, RAE dhe ARERA, “Projektpropozimin e TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e kapacitetit rritës 2021–tetor 2022”;

- “Projektpropozimi i TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e kapacitetit rritës 2021–tetor 2022” është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, udhëzimet e miratuara, Kodi i Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit dhe që nuk përfshijnë pengesa të panevojshme për procesin e parashikuar për ndërtimin e kapacitetit shtesë;

- “Projektpropozimi i TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për Procesin e Kapacitetit Rritës 2021–tetor 2022” është zhvilluar në bashkëpunim me OST-të fqinje me synimin për të siguruar një zhvillim të koordinuar të rrjetit;

- Të gjitha informacionet e listuara në nenin 28 të CAM NC janë përfshirë në këtë projektpropozim;

- Janë arritur kushtet e përcaktuara në nenin 30 (2) të CAM NC për aplikimin e mundshëm të një AAM, duke marrë parasysh që projekti përfshin më shumë se dy sisteme hyrje-dalje, ofertat kërkojnë përgjatë disa pikave të ndërlidhjes dhe ofertat me një kohëzgjatje prej kërkojnë më shumë se 1 vit;

- Parametrat ekonomikë të propozuar nga TAP AG janë në përputhje me Kodin Tarifor të TAP;

- Parametrat e tjerë ekonomikë janë verifikuar nga autoriteti kompetent në çdo vend dhe janë në përputhje me sistemet përkatëse të tarifimit;

- Ky dokumenti i përbashkët është miratuar, gjithashtu, edhe nga rregullatorët e Italisë dhe të Greqisë (ARERA dhe RAE);

- Prandaj është i nevojshëm miratimi i dokumentit të përbashkët “Miratimi i propozimit të Projektit të TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e rritjes së kapaciteteve 2021–tetor 2022” (shtojca A);

- Është, gjithashtu, i nevojshëm miratimi i dokumentit “Projektpropozimi i TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e rritjes së kapaciteteve 2021–tetor 2022” (shtojca B) për palët shqiptare dhe në kompetencën e autoritetit (Entit Rregullator të Energjisë).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Projektpropozimin e TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së për procesin e rritjes së kapacitetit 2021–tetor 2022”, të paraqitur nga kompanitë TAP AG, SRG dhe DESFA, me shkresën e datës 31 tetor 2022 (shtojca B), siç shprehet në vendimin e përbashkët me Italinë dhe Greqinë, përkatësisht ARERA dhe RAE (shtojca A);

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrë-veshjeve të njoftojë palët TAP AG, SRG dhe DESFA-ja për vendimin e Bordit të ERE-s.

3. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët.

4. Të publikojë këtë dispozitë në faqen e internetit të Entit Rregullator të Energjisë www.ere.gov.al duke përfshirë anekset (shtojca A dhe shtojca B).

KRYETAR
Petrit Ahmeti

PROPOZIM I PROJEKTTIT TË TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së PËR VITIN 2021, PËR PROCEDURËN PËR RITJE TË KAPACITETIT Tetor 2022

Përmbajtje

Hyrje

Përshkrim i projekteve për rritje të kapacitetit dhe vlerësimit të kostos

A.1 Kërkesa e tregut për rritje të kapacitetit

A.2 Përshkrimi i Projektit për rritje të kapacitetit

B. Ofertat sipas nivelit (neni 28 (1) Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

C. Mekanizma alternative të alokimit/ndarjes (neni 27(3) Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

D. Afatet e përkohshme të projektit për rritje të kapacitetit (neni 27 (3) CAM NC)

D.1 Afati kohor i ciklit për rritje të kapacitetit



D.2 Kohëzgjatja e realizimit të projektit

E. Rregullat dhe kushtet e përgjithshme për secilën fazë detyruese (neni 27 (3) NC CAM)

E.1 Kriteret e pjesëmarrjes dhe regjistrimi

E.2 Përmbajtja e ofertës detyruese

E.3 Vlerësimi i ofertës

E.4 Procedura paraprake për alokimin e kapacitetit (renditja e ofertave)

E.5 Ndarja/alokimi i ofertave marxhinale të barabarta (EMB)

E.6 Testi i qëndrueshmërisë ekonomike

E.7 Marrëveshja e Transportit të Gazit (“GTA”)

E.8 Ecuria e projektit, mungesa e lejeve, vonesat në vendosjen në dispozicion të kapacitetit të transportit

E.9 Forca madhore

E.10 Elementi IND dhe RP për qasjen e çmimit fiks (neni 28 (1) NC CAM)

G. Parametrat e testimit ekonomik (neni 28 (1) CAM NC)

G.1 Parametri i testit ekonomik për SRG-në

G.1.4 Faktori F (neni 22 (1) NC CAM)

G.2 Parametri për testimin ekonomik për DESFA-në – çmimi i referencës (neni 22(1) NC CAM)

H. Treguesit shtesë të kërkesës

H.1 Informacionet e kontaktit

Shtojca I. Dispozitat specifike të TAP-it

Shtojca II. Përkufizimet dhe shkurtimet

Shtojca III. Procedura konkurruese në sistemin e SRG-së

Shënim.

Çdo OST ka vepruar me mirëbesim për të siguruar që informacioni në këtë propozim të Projektit të jetë korrekt duke qenë që në datën e këtij propozimi të Projektit, asnjë përfaqësim ose garanci nuk bëhet nga asnjë OST për sa i përket saktësisë ose plotësisë së këtij informacioni dhe OST nuk do të pranojnë asnjë përgjegjësi, të çfarëdo lloji, ndaj njëri-tjetrit ose ndaj ndonjë pale të tretë, për pasaktësi ose nëse informacioni nuk është i plotë. Për më tepër OST nuk janë të detyruara të përditësojnë propozimin e Projektit për çdo ndryshim që ndodh pas datës së nxjerrjes së projektpropozimit. Sidoqoftë nëse informacioni i ri apo i rishikuar ofrohet te projektpropozimi OST nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit ashtu dhe ndaj palëve të treta.

Për më tepër, ndërsa secila prej OST-ve do të

përpiqet të bashkërendojë proceset dhe hapat e parashikuar sipas këtij projektpropozimi, asnjë OST nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj ndonjë pale të tretë për çdo veprim, mosveprim, shkelje ose vendim të OST të tjera ose ndonjë palë tjetër e tretë.

Hyrie

Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/459, datë 16 mars 2017 për krijimin e Kodit të Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit të sistemet e transmetimit të gazit (“**Rregullorja**” po ashtu referuar si “**CAM NC**” dhe “**NC CAM**”) vendos një proces të harmonizuar për të gjithë Bashkimin Evropian për të ofruar rritje të kapacitet midis vendeve anëtare. Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit i BE-së u aplikua në Shqipëri, si një palë kontraktore e Traktatit të Komunitetit të Energjisë duke filluar nga data 28 shkurt 2020.

Rregullat për ndarjen/veçimin e kapacitetit për Projektin e Rritjes së Kapacitetit sikurse përcaktohen te ky dokument marrin në konsideratë strukturën rregullatore specifike të TAP-it sipas Opinionit Përfundimtar të Përbashkët (“FJO”) të lëshuar nga autoritetet rregullatore kombëtare të Italisë (ARERA), Greqisë (RAE) dhe Shqipërisë (ERE), të referuara këtu si **autoritetet**, datë 6 qershor 2013 (**FJO**).

TAP-i është e përjashtuar nga disa dispozita të aksesit të palëve të treta, tarifave të rregulluara, ndarjes së pronësisë të direktivës 2009/73/EC, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët.

Përjashtimi nga tarifat e rregulluara dhe ndarjes së pronësisë po ashtu aplikohet për rritjen e kapacitetit të TAP-it (duke qenë që kapaciteti i vendosur në dispozicion nga Sistemi i Transportit i TAP-it, përveç Kapacitetit fillestar deri në 10 miliardë metër kub në vit). Kapaciteti i zgjerimit ofrohet në përputhje me parimet e aksesit të palëve të treta. Si rrjedhojë, kapaciteti i zgjerimit i TAP-it do të ofrohet sipas rregullave të alokimit/ndarjes së kapacitetit si përcaktohet nga Kodi i Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit në atë masë që ato nuk bien në konflikt me Opinioni Përfundimtar të Përbashkët (sipas paragrafit 4.6 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët) dhe si rrjedhojë strukturës së përshtatur rregullatore përmbledhur në shtojcën I të këtij propozim-projekti.

Pas fillimit të procedurës për rritjen e kapacitetit



në datën 1 korrik 2021, Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), Snam Rete Gas (SRG) dhe DESFA kanë marrë tregues jodetyrues të kërkesës dhe kanë hartuar një raport të përbashkët për vlerësimin e kërkesës (DAR), i cili është publikuar në datën 25 tetor 2021 duke dalë në përfundimin që kishte kërkesa të mjaftueshme treguese për të filluar Projektin për Rritjen e Kapacitetit.

Në muajin janar 2022, SRG-ja, DESFA-ja dhe TAP-i, sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 27 (3) të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit, së bashku filluan konsultimin publik mbi draft projektpropozimin e identifikuar të hartuar për t'u pajtuar me kërkesat e mara treguese për kërkesat jodetyruese. OST-të kanë marrë komente gjatë konsultimit publik nga 2 (dy) palë të interesuara. Këto komente, si dhe konsiderata më të përgjithshme për mjedisin e tregut dhe proceset e angazhimit¹ të palëve të interesuara, janë marrë në konsideratë sa është e mundur në fazën vijuese të hartimit të projektit për rritjen e kapacitetit.

Ky dokument është përgatitur nga SRG-ja, TAP-i dhe DESFA, sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 28 të Kodit të Rrjetit të Mekanizmave të Alokimit të Kapacitetit dhe përbën projektpropozimin për projektin për rritjen e kapacitetit të operatorëve të sistemit të transmetimit të përfshirë. Në përputhje me dispozitat e nenit 28 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit ky propozimprojekti u është paraqitur autoriteteve rregullatore italiane, greke dhe shqiptare për vlerësimet dhe miratimet e tyre.

Në mënyrë të veçantë Projekti për Rritjen e Kapacitetit përbëhet nga sa më poshtë:

- Rritja e kapacitetit ofruar nga TAP-i dhe SRG-ja në pikën e interkonjeksionit të Melendugno si produkt lidhës për kapacitetin, me dalje nga TAP-i dhe hyrje nga SRG-ja.

- Rritja e kapacitetit ofruar nga TAP-i dhe DESFA-ja në pikën e interkonjeksionit të Nea Mesimvria si produkt lidhës për kapacitetin, me dalje nga DESFA-ja dhe hyrje nga TAP-i.

- Rritja e kapacitetit ofruar nga TAP-i dhe DESFA-ja në pikën e interkonjeksionit të Nea

Mesimvria si produkt lidhës për kapacitetin, me dalje nga TAP-i dhe hyrje nga DESFA-ja.²

- Rritja e kapacitetit ofruar nga TAP-i në pikën e interkonjeksionit të Kipoi, si kapacitet hyrës të ndërprerë.

- Rritja e kapacitetit ofruar nga TAP-i në pikën e interkonjeksionit të Komotini si kapacitet dalës i ndërprerë. Kapaciteti i ofruar reflekton kapacitetin e disponueshëm të pikës së daljes së TAP-it në pikën e interkonjeksionit të Komotini pa faktorizuar asnjë kapacitet të zgjerimit në interkonektorin Greqi-Bullgari (IGB). Prandaj, pjesëmarrësit do të jenë vetëm përgjegjës për të siguruar që kapaciteti përkatës i zgjerimit të jetë i disponueshëm në anën tjetër të Pikës së Interkonjeksionit të Komotinit me Interkonektorin Greqi-Bullgari dhe TAP-i nuk ofron asnjë garanci dhe nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj pjesëmarrësve për sa i përket kësaj situate. Pjesëmarrësit duhet të kenë parasysh gjithashtu se vetë Interkonektori Greqi-Bullgari nuk do të marrë pjesë si një OST fqinje në testimin e tregut.

- Ofertat për rritje të kapacitetit nga TAP-i në pikën e mundshme të daljes në Kuçovë si kapacitet ndarës të ndërprerë.²

- Oferta e rritjes së kapacitetit nga TAP-i, në pikën e mundshme dalëse në Fier si kapacitet dalës i ndërprerë.³

- Oferta e rritjes së kapacitetit nga TAP-i, në pikën e mundshme hyrëse në Fier si kapacitet hyrës i ndërprerë.⁴

- Rritja e kapacitetit ofruar nga TAP-i si kapacitet dalës i ndërprerë në pikën e mundshme dalëse të Relievit Roskovec.⁵


² Produktet e këtij kapaciteti në Nea Mesimvria bazohen në një iniciativë përkatëse të OST dhe nuk përpiqen të mbulojnë indikacionet e kërkesës jodetyruese të paraqitura gjatë fazës jodetyruese.

³ Është përgjegjësi e Pjesëmarrësit të iniciojë çdo procedurë që mund të jetë e nevojshme që kapaciteti të vihet në dispozicion në rrjedhën e poshtme të TAP-it. TAP-i nuk paraqet asnjë përfaqësim për disponueshmërinë e një kapaciteti të tillë ose për ekzistencën e objekteve të kërkuara jashtë TAP-it.

⁴ Është përgjegjësi e Pjesëmarrësit të nisë çdo procedurë që mund të jetë e nevojshme për t'u vënë në dispozicion kapacitetet në rrjedhën e poshtme të TAP-it. TAP-i nuk paraqet asnjë përfaqësim për disponueshmërinë e një kapaciteti të tillë ose për ekzistencën e objekteve të kërkuara jashtë TAP.

⁵ TAP-i nuk paraqet asnjë përfaqësim për disponueshmërinë e kapacitetit në rrjedhën e poshtme të TAP-it ose për ekzistencën e objekteve të kërkuara jashtë TAP-i.

¹ Më 18 korrik 2022, BE-ja dhe Azerbajxhani nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për një partneritet strategjik në fushën e energjisë. Ai përfshin një angazhim për të dyfishuar kapacitetin e Korridorit Jugor të Gazit për të ofruar të paktën 20 miliardë metra kub në BE në vit deri në vitin 2027.



Ky projekt për rritje të kapacitetit drejtohet nga rritje të mundshme të kapacitetit teknik te pikat e interkonjeksionit përgjatë gjurmës së Gazsjellësit TAP. Nëse përditësimet e infrastrukturës të nevojshme për Projektin e Rritjes së Kapacitetit realizohen nga OST-ja e ndërlidhura, atëherë rrjedha shtesë e gazit natyror nga kufiri grek–turk do të arrijë në tregjet e Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë. Prandaj ky Projekt për Rritjen e Kapacitetit është kryer në bashkëpunim të ngushtë nga TAP-i, SGR dhe DESFA, për të siguruar ofrimin e kapaciteteve te pikat e interkonjeksionit të përbashkëta të OST-ve të përfshira. Pavarësisht nga një bashkërendim i tillë, çdo OST do të jetë përgjegjës për përmirësimet e veta të infrastrukturës dhe OST e tjera nuk do të kenë asnjë përgjegjësi ndaj asnjëres palë për ndërmarrjen, ose nuk do të ndërmarrin përmirësimet e tilla të infrastrukturës.

Kini parasysh që kapaciteti i vëllimit për zgjidhjet teknike do të shprehet në Sm³ ose Nm³, ndërkohë që rritja e kapacitetit që ofrohet për rezervim gjatë secilës fazë detyruese do të shprehet në kwh/ditë. Në mënyrë indikative, një konvencion i një vlerës minimale kalorifike bruto (“GCV”) prej 9.71 ⁶ kwh/Sm³ (10.23 kwh/Nm³) mund të zbatohet për shndërrim midis kapacitetit në vëllim dhe në energji.

Përkthimi i projektit për rritje të kapacitetit dhe vlerësimi i kostos

A.1 Kërkesa e tregut për rritje të kapacitetit

Treguesit jodetyrues të kërkesës nga pikat e interkonjeksionit përshkruhen në detaje te Raporti për Vlerësimin e Kërkesës (“DAR”) publikuar nga

TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-së në datën 25 tetor 2021.⁷

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e përfundimeve të nivelit të lartë nga DAR në lidhje me kërkesat jodetyruese për kapacitetin e sigurt në drejtimin para:

- Në pikën e interkonjeksionit në Kipoi kërkesat jodetyruese janë 5,500,000 kwh/ditë nga viti 2024/25 deri në vitin e gazit 2030/31.

- Në pikën e interkonjeksionit në Melendugno, kërkesat jodetyruese arrijnë kulmin në 60.700.000 kwh/ditë në periudhën 2026–2032. Më pas ato reduktohen gradualisht në 26.500.000 kwh/ditë në periudhën 2032–2036. Nuk është marrë asnjë kërkesë për periudhën pas vitit 2040. Vini re, se nga këto shifra, vetëm kërkesa për 15,000,000 kwh/d është pranuar nga TAP-i dhe SRG-ja, për periudhën 2021/22–2030/31.

- Në pikën e interkonjeksionit në Nea Mesimvria, kërkesat jodetyruese (për dalje nga sistemi DESFA dhe – hyrje në gazsjellësin TAP) janë të barabarta me 15,000,000 kwh/ditë për periudhën 2021/22–2022/23. Pas kësaj periudhe, kapaciteti i kërkuar është i barabartë me 30,000,000 kwh/ditë deri në vitin e gazit 2030/31.

- Në pikën e interkonjeksionit në Kuçovë, TAP-i ka marrë kërkesa jodetyruese të barabarta me 7,500,000 kwh/d nga viti i gazit 2023/24 deri në vitin e gazit 2030/31.

- Në pikën e interkonjeksionit në Fier, TAP-i ka marrë kërkesa jodetyruese të barabarta me 7,500,000 kwh/d nga viti i gazit 2023/24 deri në vitin e gazit 2030/31.

- Në pikën e daljes së Relievit Roskovec, TAP-i ka marrë kërkesa jodetyruese të barabarta me

⁶ Për pikën e interkonjeksionit në Melendugno nivelet e ofertës janë llogaritur duke marrë parasysh kapacitetin ekzistues të kontraktuar të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 11.07 kwh/Sm³ dhe kapacitetin e zgjerimit të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 9,71 kwh/Sm³.

⁷ [Market tests › Trans Adriatic Pipeline \(TAP\) \(tap-ag.com\)](https://www.market-tests.com/Trans-Adriatic-Pipeline-(TAP)-(tap-ag.com))



5,500,000 kwh/d nga viti i gazit 2024/25 deri në vitin e gazit 2030/31.

Kërkesat për lidhje të ardhura për TAP-in në Shqipëri

a) Përveç kërkesave jodetyruese për kapacitet, TAP-i ka marrë kërkesat e mëposhtme jodetyruese për lidhje:

a) një pikë dalje në Relievin Roskovec, Shqipëri me një kapacitet teknik rreth 7,500,000 kwh/d;

b) një pikë dalje në Kuçovë, Shqipëri me një kapacitet teknik rreth 7,500,000 kwh/d;

c) 2 (dy) kërkesa për lidhje jodetyruese për sa i përket Fierit (me një kapacitet teknik të kërkuar për dalje rreth 7,500,000 kwh/d dhe për hyrje përkatësisht 1.8 miliardë metër kub në vit), potencialisht duke e bërë pikën e interkonjeksionit me dy drejtime.

DAR arriti në përfundimin se treguesit e kërkesës të marra nga TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja ishin të mjaftueshme për të nisur fazën e projektimit të një Projekti për Rritje të Kapacitetit në përputhje me paragrafin 2 të nenit 26 të NC CAM.

A.2 Përshkrimi i Projektit për rritje të kapacitetit

Bazuar te kërkesat e kapacitetit të marra gjatë fazës treguese për kërkesat jodetyruese, TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja filluan të analizojnë zhvillimet e mundshme të infrastrukturës te sistemet e transmetimit për të përmbushur kërkesat e palëve të interesuara.

Paragrafët më poshtë ofrojnë informacion shtesë mbi alternativat dhe kostot shoqëruese për çdo OST. Shohim që kostot e investimit që shpjegohen më poshtë vendosen në përputhje me praktikën e vendosura rregullatore, si zbatohen në mënyrë individuale për çdo OST.

TAP

Sipas shqyrtimit të treguesve jodetyrues të kërkesës dhe kushteve të Raportit për Vlerësimin e Kërkesës (DAR), TAP identifikoi projektet alternative të zgjerimit si më poshtë:

a. Niveli 1: zgjerimi minimal i TAP-it – me një kapacitet total teknik prej 39.8 MSm³ në ditë në hyrje të Kipoi (387 Gwh/ditë) (**Projekti i Zgjerimit Minimal**);

b. Niveli 2: zgjerimi i kufizuar i TAP-it – me një kapacitet total teknik prej 45.3 MSm³ në ditë në hyrje të Kipoi (440 Gwh/ditë) (**Projekti i Zgjerimit të Kufizuar**);

c. Niveli 3: zgjerim pjesor i TAP-t – me një kapacitet total teknik prej 52.7 MSm³ në ditë në hyrje të Kipoi (512 Gwh/ditë) (**Projekti i Zgjerimit Pjesor**);

d. Niveli 4: zgjerimi i plotë i TAP-it – me një kapacitet total teknik prej 62.6 MSm³ në ditë në hyrje të Kipoi (608 Gwh/ditë) (**Projekti i Zgjerimit të Plotë**).

Zgjerimi i gazsjellësit TAP mund të arrihet duke instaluar njësi kompresimi shtesë te stacionet e kompresimit GCS00 (Kipoi) dhe ACS03 (Fier), me ndërtimin e stacioneve shtesë të kompresimit GCS01 (Serres) dhe ACS02 (Bilisht) dhe me rivendosjen e mundshme të njërive ekzistuese të stacioneve të kompresimit të një ose të dy stacionet ekzistuese të kompresimit GCS00 (Kipoi) dhe ACS03 (Fier). Nuk kërkohen modifikime të pjesa e gazsjellësit midis stacioneve të kompresimit.

Shkalla e zgjerimit varet nga kërkesat e sigurta për kapacitetin e zgjerimit.

Projektet e zgjerimit të përshkruara te ky dokument (përfshirë kapacitetet teknike të vlerësuara) mund t'u nënshtrohen rregullimeve gjatë zhvillimit të tyre, përfshirë optimizimin sipas ofertave detyruese të marra nga TAP-i.

Katër konfigurimet e ndryshme treguese të zhvillimit të infrastrukturës, me vlerësim paraprak të kostove sipas analizave të riskut të kostos bazuar te studimi Pre-FEED përshkruhen te paragrafët e mëposhtëm:

Niveli 1: Projekti i Zgjerimit Minimal të TAP-it

Punimet që kërkohen për zgjerimin për të lejuar transportin e 39.8 MSm³/ditë (387 Gwh/ditë) janë:

- GCS00: Përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit me shtimin e 1 njësie të kompresimit (përafërsisht. 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve përkatëse;

Kostoja e këtij projekti është 132 M€⁸. Vlerësimi i kostos mund të optimizohet përmes publikimit të njoftimit të përbashkët nga TAP-i, në varësi të disponueshmërisë së përcaktimeve të tjera teknike gjatë asaj kohe.

Niveli 2: Projekti i zgjerimit të kufizuar të TAP-it

⁸ Vlerësimi i klasës 4, në përputhje me Sistemin e Klasifikimit të Vlerësimit të Kostos të Praktikave të Rekomanduara Ndërkombëtare të AACE®-siç zbatohet në prokurimin dhe ndërtimin inxhinierik për industrinë e procesit nr. 18R-97.



Punimet që kërkohen për zgjerimin për të lejuar transportin e 45.3 MSm³/ditë (440 Gwh/në ditë), janë:

- GCS00: Përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit me 2 njësi kompresimi shtesë (përafërsisht 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve përkatëse;
- ACS02: nuk kërkohet përditësim i infrastrukturës;
- ACS03: Përmirësim i stacioneve ekzistues të kompresimit me shtimin e 2 njësive të kompresimit (përafërsisht 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
- IPR01: nuk kërkohet përditësim i infrastrukturës;

Kostoja e këtij projekti është 469 M€⁹. Vlerësimi i koston mund të optimizohet përmes publikimit të njoftimit të përbashkët nga TAP-i, në varësi të disponueshmërisë së përcaktimeve të tjera teknike gjatë asaj kohe.

Niveli 3: Projekti i zgjerimit pjesor të TAP-it

Punimet që kërkohen për zgjerimin për të lejuar transportin e 52.7 MSm³/ditë (512 Gwh/ditë) janë:

- GCS00: përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit me 2 njësi kompresimi shtesë (përafërsisht 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve përkatëse;
- ACS02: përmirësim i objektit ekzistues matës në një stacion kompresimi me shtimin e 3+1 njësive të kompresimit (përafërsisht 25 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
- ACS03: përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit me 2 njësi kompresimi shtesë (përafërsisht 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
- IPR01: përmirësim i stacionit të reduktimit të matjes dhe presionit;

Kostoja e këtij projekti është 896M€. ¹⁰ Vlerësimi i koston mund të optimizohet përmes publikimit të njoftimit të përbashkët nga TAP-i, në varësi të disponueshmërisë së përcaktimeve të tjera teknike gjatë asaj kohe.

⁹ Vlerësimi i klasës 4, në përputhje me Sistemin e Klasifikimit të Vlerësimit të Koston të Praktikave të Rekomanduara Ndërkombëtare të AACE®-siç zbatohet në prokurimin dhe ndërtimin inxhinierik për industrinë e procesit nr. 18R-97. Vlerësimi i koston përfshin një emergjencë që pasqyron saktësinë e klasës 4 të vlerësimit dhe çdo lejm të aplikueshëm.

¹⁰ Referohuni në shënimin e mësipërm.

Niveli 4: Projekti i zgjerimit të plotë të TAP-it

Punimet që kërkohen për zgjerimin për të lejuar transportin e 62.6 MSm³/ditë (608 Gwh/ditë) janë:

- GCS00: përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit me shtimin e 3 njësive të kompresimit (përafërsisht 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
 - GCS01: përmirësim i objektit ekzistues për pastrimin e papastërtive (scraper) të një stacion kompresimi me shtimin e 2+1 njësive të kompresimit (përafërsisht 25 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
 - ACS02: përmirësim i objektit ekzistues matës në një stacion kompresimi me shtimin e 3+1 njësive të kompresimit (përafërsisht 25 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
 - ACS03: përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit me 2 njësi kompresimi shtesë (përafërsisht 15 mw secila), përfshirë përditësimin e objekteve, proceseve dhe shërbimeve respektive;
 - IPR01: përmirësim i stacionit të reduktimit të matjes dhe presionit;
- Kostoja e këtij projekti është 1267M€. ¹¹ Vlerësimi i koston mund të optimizohet përmes publikimit të njoftimit të përbashkët nga TAP-i, në varësi të disponueshmërisë së përcaktimeve të tjera teknike gjatë asaj kohe.

SRG

Niveli 1 (30,1 MSm³/ditë – 328 Gwh/ditë¹²), niveli 2 (35,6 MSm³/ditë – 381 Gwh/ditë¹³) dhe niveli 3 (43,0 MSm³/ditë – 453 Gwh/ditë¹⁴)

¹¹ Referohuni në shënimin e mësipërm.

¹² Për pikën e interkonjeksionit në Melendugno, nivelet e ofertës u llogaritën duke marrë parasysh kapacitetin ekzistues të kontraktuar të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 11.07 kwh/Sm³ dhe kapacitetin e zgjerimit të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 9,71 kwh/Sm³.

¹³ Për pikën e interkonjeksionit në Melendugno, nivelet e ofertës u llogaritën duke marrë parasysh kapacitetin ekzistues të kontraktuar të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 11.07 kwh/Sm³ dhe kapacitetin e zgjerimit të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 9,71 kwh/Sm³.

¹⁴ Për pikën e interkonjeksionit në Melendugno, nivelet e ofertës u llogaritën duke marrë parasysh kapacitetin ekzistues të kontraktuar të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 11.07 kwh/Sm³ dhe kapacitetin e zgjerimit të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 9,71 kwh/Sm³.



Hyrja në Melendugno

Infrastruktura ekzistuese do të mjaftonte për të shpërndarë këto oferta për nivelin dhe si pasojë nuk kërkohen investime të tjera nga ana e pikës së interkonjeksionit e SRG-së. Kapaciteti i ofruar në pikën e interkonjeksionit në Melendugno për nivelin e ofertës 1, 2 dhe 3 do të jetë në konkurrencë nga ana e SRG-së me pikat e tjera të interkonjeksionit të Mazara dhe Gela, kështu që alokimi i kapacitetit do t'i nënshtrohet kufizimit aktual të kapacitetit, në lidhje me atë infrastrukturat ekzistuese, të publikuara në faqen e internetit të SRG-së.¹⁵

DESFA

Niveli i rritjes së kapacitetit të ofruar nga DESFA-ja në kuadër të procesit për rritjen, llogaritet duke marrë në konsideratë kapacitetet teknike ekzistuese të pikave hyrëse të sistemit të gazit të DESFA, si dhe projektet e miratuara tashmë në kuadër të Planit 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit ("TYNDP") të DESFA-së për periudhën 2022–2031. Nea Mesimvria lidh sistemin grek me Gazsjellësin TAP. Një stacion kompresimi (CS) operon në Nea Mesimvria. Një stacion i ri kompresimi po planifikohet në zonën e Ampelia po ashtu po planifikohet përmirësim i stacionit ekzistues të kompresimit në Nea Mesimvria. Po ashtu, sipas Planit të Zhvillimit 2022–2031, një stacion kompresimi i ri (përforcues) po planifikohet në Nea Mesimvria për të mundësuar rrjedhën në drejtim të kundërt tek TAP-i. Përmirësimet e sistemit të transmetimit të përfshira në (TYNDP) 2022–2031 të DESFA-së konsiderohen si parakusht për simulimin hidraulik dhe llogaritjen e nivelit/eve të ofertës nga DESFA-ja.

DESFA-ja ka kryer studime paraprake teknike për të identifikuar investimet që nevojiten për të vendosur në dispozicion për rritjen e kapacitetit të pika e interkonjeksionit e Nea Mesimvria. Këto studime teknike marrin në konsideratë kërkesat në total që i paraqiten DESFA-së nga palët e interesuara, gjatë fazës jodetyruese. Këto kërkesa në total kapin maksimumin prej 30,000,000 kwh/d si paraqiten te paragrafi A.1 dhe u referohen rrjedhave nga TAP-i drejt sistemit të gazit të DESFA-së në pikën e interkonjeksionit në Nea Mesimvria. DESFA-ja

nuk ka marrë asnjë kërkesë jodetyruese për rritje të kapacitetit nga TAP-i drejt sistemit të gazit të DESFA-së.

DESFA-ja ka përfshirë në miratimin tashmë të dhënë nga rregullatori grek RAE TYNDP 2022–2031, një kompresor të ri përforcues në Nea Mesimvria për të lehtësuar rrjedhat nga Sistemi i gazit të DESFA-së drejt TAP-it. Ky kompresor përforcues do t'i mundësojë DESFA-së të ofrojë produkte me kapacitet të fortë në pikën dalëse të Nea Mesimvria. Kompresori pritët të ketë përfunduar në fund të Q4 2023 dhe data komerciale për vendosjen në funksion pritët në Q1 2024. Ndikimi i rritjes së flukseve përmes pikës dalëse të Nea Mesimvrisë u shqyrtua duke kryer simulime hidraulike të sistemit të transmetimit në një rast hidraulik shumë të ngarkuar. Rezultati është se niveli i kërkesave të fluksit të paraqitura gjatë fazës jodetyruese mund të mbulohet pa ndonjë investim të ri pas përfundimit të stacionit të kompresimit (CS) përforcues të lartpërmendur.

Për më tepër, DESFA-ja ka shqyrtuar gjithashtu mundësinë për të ofruar të paktën një nivel oferte në drejtimin e rrjedhës nga TAP-i drejt sistemit të DESFA-së edhe nëse nuk është paraqitur asnjë kërkesë jodetyruese gjatë fazës jodetyruese. Synimi është mbulimi i çdo interesi të mundshëm për transmetimin e gazit nga TAP-i në DESFA nëpërmjet pikës ekzistuese të interkonjeksionit në Nea Mesimvria, që nuk është shprehur gjatë fazës jodetyruese. Prandaj, DESFA-ja synon t'u ofrojë pjesëmarrësve të tregut mundësinë e rezervimit të kapaciteteve në të dy drejtimet gjatë fazës/eve të ardhshme detyruese.

Nivelet e investimeve janë si më poshtë:

Kapaciteti i pikës dalëse në Nea Mesimvria niveli 1: rritja e kapacitetit prej 30 Gwh/ditë

Infrastruktura tashmë e projektuar do të mjaftonte për të ofruar këtë nivel oferte dhe kështu nuk nevojiten investime shtesë për pikën e interkonjeksionit nga DESFA-ja. Niveli i sipërpërmendur i ofertës ka si parakusht përfundimin e stacionit të planifikuar të kompresimit në Ampelia dhe stacionin e kompresorit përforcues në Nea Mesimvria, tashmë të përfshira në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit për periudhën 2022–2031 të miratuar nga DESFA-ja.

Kapaciteti i pikës hyrëse në Nea Mesimvria Niveli 1: rritja e kapacitetit prej 26 Gwh/ditë

Për ofertat niveli 1, nevojitet një gazsjellës i ri

¹⁵ Procedura specifike e funksionimit është e disponueshme në shtojcën III.



me diametër 30" nga pika e Apelia në nyjën Lamia (38 km). Ky gazsjellës i ri, do të vendoset paralelisht me atë ekzistues, kur është e mundur, për të minimizuar kostot e projektit, efektet në mjedis dhe kohën që kërkohet për ndërtimin e projektit. Një njësi e re kompresimi 13 mw (2+1 x 6,5 mw) duhet të instalohet në nyjën Platamonas. Kostoja e projektit përkatës është vlerësuar në 108 milionë euro.

Kapaciteti i pikës hyrëse në Nea Mesimvria Nivel 2: rritja e kapacitetit prej 49 Gwh/ditë

Për ofertat nivel 2, nevojitet një gazsjellës i ri me diametër 30" nga zona e Larisës deri në nyjën Sperheios (92 km). Ky gazsjellës i ri, do të vendoset paralelisht me atë ekzistues, kur është e mundur, për të minimizuar kostot e projektit, efektet në mjedis dhe kohën që kërkohet për ndërtimin e projektit. Një njësi e re kompresimi 18 mw (2+1 x 8) duhet të instalohet në nyjën Litorchoro. Kostoja e projektit përkatës është vlerësuar në 189 milionë euro.

Nivelet e sipërpërmendura të ofertës kanë si parakusht përfundimin e stacionit të planifikuar të Kompresimit në Ampelia dhe përmirësimin e stacionin e kompresorit në Nea Mesimvria të përfshirë tashmë në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të DESFA-së për periudhën 2022–2031.

Deri në përfundimin e stacioneve të kompresimit të përmendura më sipër (që parashikohet të përfundohen deri në përfundim të vitit 2023), kapaciteti teknik (pika hyrëse DESFA) në pikën e interkonjeksionit në Nea Mesimvria do të ofrohet në përfundim së bashku me atë ekzistues në pikën e interkonjeksionit në Kipoi. Sasia totale e kapacitetit të ofruar në Nea Mesimvria është e barabartë me 4.8 MNm³/d, nga të cilat 4.3 MNm³/d do të ofrohen në përfundim së bashku me kapacitetin e pikës hyrëse të DESFA-së në Kipoi.

Pas përfundimit të stacioneve të kompresimit të përmendura më sipër dhe **debottlenecking** (është procesi i identifikimit të zonave specifike dhe /ose pajisjeve në pajisjet e naftës dhe gazit që kufizojnë rrjedhën e produktit (i njohur ndryshe si ngushtica) dhe optimizimi i tyre në mënyrë që kapaciteti i përgjithshëm në impiant të mund të rritet) i sistemit grek të gazit, kapaciteti teknik në pikën e interkonjeksionit në Nea Mesimvria do të jetë e barabartë me 4.6 MNm³/d dhe nuk do të ofrohet përmes ankandëve konkurruese.

B. Oferta sipas nivelit (sipas nenit 28 (1) të Kodit të Rrjetit të Mekanizmit për Alokimin e

Kapacitetit NC CAM)

Sipas konfigurimeve të ndryshme të projektit të përshkruara më sipër, do të jetë e mundur të propozohen oferta për nivele të veçanta për pikat e interkonjeksionit. Niveli i ofertës mund të kombinohet në mënyra të ndryshme, në varësi të grupit të përgjithshëm të ofertave detyruese të marra, ju lutemi, kini parasysh se kapacitetet në pikat e ndryshme të hyrjes dhe daljes së TAP-it nuk janë grumbulluese. Ata mund të jenë në konkurrencë me njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, kapacitetet për zgjidhjet e ndryshme teknike të përcaktuara në paragrafin A.2.1 më sipër, supozojnë se të gjitha rezervimet e reja përdorin gjatësinë e plotë të tubacionit (d.m.th., pragjet për TAP-in në pikën hyrëse në Kipoi që gjenden më poshtë bazohen në simulimet hidraulike duke supozuar që rezervimet janë të lidhura me të njëjtën sasi rezervimesh për TAP-in me pikë dalje në Melendugno).

Po ashtu lexuesit duhet të kenë parasysh kushtet e paragrafit E.6 në lidhje me kërkesat vjetore që bëhen për TAP-in.

Ofertat sipas nivelit në tabelën më poshtë – ofrojnë një përmbledhje të kapaciteteve të ofruara te pikat e interkonjeksionit së bashku nga të gjitha OST – përfaqësojnë kapacitetin që mund të ndahet te fazat detyruese të ofertës të Projektit për Rritjen e Kapacitetit si kapacitet afatgjatë (duke marrë parasysh çdo kapacitet neto në dispozicion të kapacitetit të rezervuar dhe kapacitetin që do të rezervohet në një periudhë afatshkurtër). Për të garantuar shërbim të sigurt transporti, nivelet llogariten sipas të gjithë gazit që do të transportohet përmes gazsjellësit TAP, duke pasur një vlerë minimale kalorifike bruto (GCV) prej 9.71 kwh/Sm³ (36.84 MJ/Nm³ ose 10.23kwh/Nm³).¹⁶

Ju lutemi, vini re se datat e fillimit në tabelat e mëposhtme supozojnë se faza e parë detyruese e ofertës do të zhvillohet në janar 2023.¹⁷

¹⁶ Kushtet e referencës për metër kub normal janë 25°C për djegjen dhe 0°C për vëllimin në presionin atmosferik.

Për pikën e interkonjeksionit në Melendugno, nivelet e ofertës janë llogaritur duke marrë parasysh kapacitetin e kontraktuar të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 11.07 kwh/Sm³ dhe kapacitetin e zgjerimit të konvertuar me një vlerë minimale kalorifike bruto GCV të barabartë me 9,71 kwh/Sm³.

¹⁷ Ju lutemi, referojuni paragrafit D për më shumë detaje mbi kohën.

Kipoi¹⁸

	Kapaciteti i ofruar (kwh/d)				Hyrja/dalja dhe kapaciteti ofertues i OST-së
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	
Data e fillimit	Q4-2025	Q4-2026	Q4-2027	Q4-2027	Hyrja TAP
Kapaciteti	32,829,131	80,571,207	145,631,271	231,954,059	

Nea Mesimvria - Dalja DESFA/HyrjaTAP

	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d)	Hyrja / Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
	Niveli 1	
Data e fillimit	Q4-2025	Dalja DESFA dhe Hyrja TAP
Kapaciteti	30,000,000	

Nea Mesimvria - Hyrja DESFA/DaljaTAP

	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d) Niveli 1	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d) Niveli 2	Hyrja / Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
Data e fillimit	Q1 2027	Q3 2027	Hyrja DESFA dhe Dalja TAP
Kapaciteti	26,000,000	49,000,000	

Komotini

	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d)	Hyrja / Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
Data e fillimit	Q4 2025	Dalja TAP
Kapaciteti	30,000,000	

Kuçovë¹⁹

	Kapaciteti i fruar (kwh/d) Niveli 1	Hyrja /Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
Data e fillimit	Q4 2025	Dalja TAP
Kapaciteti	7,500,000	

¹⁸ Vini re, se edhe pse rritja e kapacitetit ofruar në hyrje në Kipoi është më i ulët se në dalje nga Melendugno, rritja e kapacitetit në Melendugno teorikisht mund të rezervohet dhe përdoret ende, pasi transportuesit mund të zgjedhin të mos nominojnë sipas rezervimeve të tyre ekzistuese në TAP për pikat e interkonjeksionit në Nea Mesimvria dhe Komotini, duke lejuar kështu një fluks më të lartë në Melendugno.

¹⁹ Ju lutemi, kini parasysh që TAP nuk paraqet asnjë përfaqësim për ekzistencën e objekteve në rrjedhën e poshtme ose disponueshmërinë e kapacitetit në këtë pikë.



Relievi Roskovec

	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d)	Hyrja / Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
	Niveli 1	
Data e fillimit	Q4 2025	Dalja TAP
Kapaciteti	7,500,000	

Fier²⁰

	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d)	Hyrja / Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
	Niveli 1	
Data e fillimit	Q4 2025	Dalja TAP
Kapaciteti	7,500,000	

Fier

	Kapaciteti i Ofruar (kWh/d)	Hyrja / Dalja dhe kapaciteti ofertues i OST
Data e fillimit	Q4 2025	Hyrja TAP
Kapaciteti	44,900,000	

Melendugno²¹

	Kapacitet i ofruar (kwh/d)			Kapacitet hyrës / dalës dhe kapacitet ofrues i OST-së
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Pika e daljes TAP dhe pika e hyrjes SRG
Data e fillimit ²²	Q4-2025	Q4-2026	Q4 2027	
Kapaciteti	32,829,131	80,571,207	145,631,271	

²⁰ Ju lutemi, kini parasysh, që TAP-i nuk paraqet asnjë përfaqësim për ekzistencën e objekteve në rrjedhën e poshtme ose disponueshmërinë e kapacitetit në këtë pikë.

²¹ Kapaciteti i ofruar në pikën e interkonjeksionit në Melendugno do të jetë në konkurrencë nga ana e SRG-së me pikat e tjera të interkonjeksionit në Mazara dhe Gela, kështu që shpërndarja e kapacitetit do t'u nënshtrohet kufizimeve të kapacitetit siç publikohet në faqen e internetit të SRG-së. Procedura specifike e funksionimit është e disponueshme në shtojcën III.

²² Ju lutemi, vini re se datat e fillimit të përfshira i referohen disponueshmërisë së TAP-it, pasi nuk kërkohet asnjë punë nga ana e SRG-së.



Në përputhje me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët (FJO) dhe Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit (NC CAM), një sasi kapaciteti prej 10% e kapacitetit të zgjerimit do të vendoset mënjane për t'u ofertuar si kapacitet afatshkurtër, që aplikohet për çdo OST përveç numrave të përmendur më sipër. Në lidhje me projektin fillestar të TAP-it, sipas paragrafit 4.1.10, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP-i ka detyrimin të vendosë mënjane 5 % të kapacitetit fillestar për ankandet afatshkurtër.

C. Mekanizmi alternativ i alokimit/veçimit (neni 27(3) pikat “c”, “f” të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit NC CAM)

Për të rritur mundësinë që të realizohet ekonomikisht Projekti për Rritjen e Kapacitetit, sipas dispozitave të nenit 30 (1) të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit dhe duke marrë parasysh kuadrin e veçantë rregullator të TAP-it, si dhe gjetjet e treguesve jodetyrues të kërkesës, SRG-ja, TAP-i dhe DESFA-ja kanë si qëllim të aplikojnë Mekanizmin Alternativ të Alokimit/veçimit (“**AAM**”) me një periudhë më të gjerë rezervimi të kapacitetit prej 20 vjetësh pas fillimit të vendosjes në funksion, duke iu nënshtruar miratimit nga autoritetet e përfshira.

Kriteret parashikuar sipas nenit 30 (2) të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit për aplikimin e mundshëm të Mekanizmit Alternativ të Veçimit arrihen nga Projekti për Rritjen e Kapacitetit, si më poshtë²³:

- Projekti për Rritjen e Kapacitetit përfshin të paktën tri sisteme hyrëse-dalëse në BE (TAP, SRG, DESFA), Shqipëri dhe ekziston mundësia për sisteme të tjera hyrëse-dalëse në të ardhmen.

- Kërkesat jodetyruese për kapacitetin e sigurt afatgjatë (FFLT) u morën për 5 pika interkonjeksioni të përfshira në tabelën në paragrafin B.

- Interesat në lidhje me rezervimet e kapacitetit prej më shumë se 1 vit.

- Pjesëmarrësit kanë treguar interes për angazhimet që lidhin më shumë se një pikë interkonjeksioni

Sipas dispozitës së nenit 30 (3) të Kodit të

Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit (CAM NC), TAP, DESFA-ja dhe SRG kanë si qëllim lejin e palëve të interesuara që të paraqesin oferta detyruese në rastet e mëposhtme:

- detyrimin që në një pikë interkonjeksioni të lidhet me angazhimet e pikës (pikave) të tjera;

- detyrimin përmes standarde të ndryshme vjetore të produkteve të kapacitetit;

- detyrimin e kushtëzuar për veçimin/ndarjen e sasisë minimale të kapacitetit.

Duke pasur parasysh karakteristikat për Projektin për Rritjen e Kapacitetit, Mekanizmi i propozuar Alternativ i Veçimit ka prioritet tek ofertat të cilat varen nga kohëzgjatja e rezervimit sipas nenit 30(4) të Kodit të Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit (CAM NC). Në mënyrë të veçantë, TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja u japin përparësi detyrimeve me kohëzgjatje prej të paktën 3 produkteve standarde vjetore radhazi duke filluar nga E-COD, e cila lidh më shumë se një pikë interkonjeksioni përgjatë gjurmës së gazit si specifikohet më tej te pjesët e tjera të këtij dokumenti. Ofertat detyruese do të vazhdojnë sipas pjesëmarrësve të cilët duhet të pajtohen me kërkesat e vendosura në paragrafin E.1. Në rast kongestionit, që të pajtohet me strukturën e veçantë rregullatore të TAP-it (që do të thotë Kodin e Tarifave të TAP) dhe për të siguruar rezultatet koherente të veçimit/alokimit për OST-të e ndërlydhura, do të zhvillohet një renditje sipas vlerës aktuale neto (“**NPV**”) për të ardhurat në rritje për çdo ofertë detyruese për njësi të kapacitetit vjetor të kërkuar si specifikohet më tej në paragrafin E.²⁴

D. Afati i përkohshëm për projektin për rritjen e kapacitetit (neni 27 (3), pika “d” e Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit CAM NC)

Ky kapitull përshkruan afatin për përfundimin e Projektit për Rritjen e Kapacitetit (paragrafi D.1) dhe jep një parashikim për kohën që nevojitet për realizimin e rritjes së kapacitetit të ri (paragrafi D.2).

D.1 Afati i ciklit për rritjen e kapacitetit

Bazuar në reagimet e marra gjatë konsultimit publik, i cili përfundoi më 18 mars 2022 dhe duke marrë parasysh zhvillimet e fundit të tregut të gazit,

²³ Ju lutemi, referojuni, gjithashtu, provave të mundësuar nga Raporti për Vlerësimin e Kërkesës DAR.
Faqe | 18916

²⁴ Kodi i tarifave TAP nuk parashikon ankand, përveç rasteve të jashtëzakonshme të ofertave marxhinale të barabarta.



OST-të propozojnë miratimin e një afati kohor të përsheptuar dhe organizimin e një faze detyruese të ofertës në janar 2023, e ndjekur nga një fazë e dytë detyruese të ofertës në vitin 2023.

Nëse OST-të zgjedhin, sipas gjykimit të tyre, të zhvillojnë një fazë të dytë detyruese, atëherë kjo fazë e dytë detyruese do të përfshijë të njëjtat faza (d.m.th., faza e informimit dhe faza detyruese e ofertës e ndjekur nga alokimi i kapaciteteve, testin e qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) dhe hyrja në Marrëveshjen për Transportin e Gazit (“GTA”).

Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i kushteve precedent të vendosur nga çdo OST në pjesën E.7, angazhimet e ndërmarra gjatë fazës së parë detyruese nuk do të ndikohen në rastin e një faze të dytë detyruese.

Pjesëmarrësit duhet të kenë parasysh se OST-të e interesuara rezervojnë të drejtën për të organizuar një fazë të dytë detyruese. Pasi të merret vendimi për organizimin e një faze të dytë detyruese, ai do t’u njoftohet autoriteteve rregullatore kombëtare dhe OST-të e interesuara nuk do të kenë asnjë përgjegjësi ndaj asnjë pale në lidhje me një vendim të tillë.

D.1.1 Afati kohor për fazën e parë detyruese (2022)

Faza e parë detyruese do të fillojë me publikimin e njoftimit të përbashkët në faqet e internetit të TAP-it, SRG-së dhe DESFA-së, e parashikuar të zhvillohet më 14 nëntor 2022. Një fazë detyruese përbëhet nga një fazë informimi dhe një fazë detyruese e ofertës (kjo vlen për të dy fazat detyruese që mund të zhvillohen).

Gjatë fazës së parë të informimit, palëve të interesuara për të marrë pjesë në fazën e parë

detyruese të ofertës, do t’u kërkohet, në përputhje me kërkesat specifike të OST-ve të përcaktuara në paragrafin E.1 më poshtë, të regjistrohen me OST-të e përfshira si aplikante për të marrë pjesë në fazën e parë detyruese të ofertës.

Në fillim të kësaj faze të parë të informimit, së bashku me njoftimin e përbashkët, në faqet e tyre të internetit, TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja do të publikojnë një njoftim të fazës detyruese dhe një listë të dokumentacionit përkatës që duhet të dorëzohet nga aplikantët për regjistrimin, si dhe afatin përkatës për dorëzimin e këtij dokumentacioni.

Tek dritarja për paraqitjen e ofertave që fillon në janar 2023, palëve të interesuara për të marrë pjesë në fazën e parë detyruese të ofertës do t’u kërkohet të paraqesin oferta detyruese jo më vonë se fundi i dritares për paraqitjen e ofertave. Ju lutemi, referohuni në paragrafin E.2, i cili përcakton përmbajtjen e ofertave detyruese.

Me përfundimin e dritares për paraqitjen e ofertave, TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja do të vazhdojnë me vlerësimin e ofertave, alokimin/veçimin paraprak të kapacitetit dhe testin e qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), duke nënshkruar Marrëveshje për Transportin e Gazit (“GTA”) me pjesëmarrësit e suksesshëm. Faza e parë detyruese përfundon kur asnjë nga ofertat nuk e kalon nivelin e testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) ose nuk nënshkruan Marrëveshjen për Transportin e Gazit (GTAs), që aplikohet për çdo OST, e cila bëhet efektive (shikoni paragrafin E.7 mbi kushtet standarde për Marrëveshjen e Transportit të Gazit GTA).

Afati për programin (datat e parashikuara)

Programi	Datat
A. Faza e informimit	14 nëntor – 13 janar 2023
TAP/SRG/DESFA vendosin në dispozicion dokumentacionin që duhet të paraqitet nga çdo OST	14 nëntor 2022
Periudha e regjistrimit	14 nëntor–13 dhjetor 2022
TAP/SRG/DESFA vlerësim i pajtueshmërisë së aplikuesit	14 dhjetor – 13 janar 2023
B. Faza detyruese e ofertave	16 janar – 15 shkurt 2023
Dritarja për paraqitjen e ofertës	16 janar – 22 janar 2023
Periudha për vlerësimin e ofertave	23 janar– 25 janar 2023



Programi	Datat
Ndarja/veçimi paraprak i kapacitetit	26 janar – 28 janar 2023
Rezultatet e publikuara të testit të qëndrueshmërisë ekonomike	30 janar 2023
C Ndarja/veçimi i kapacitetit	30 janar 2023
D Përfshirja nga marrëveshjet e transportit të gazit	15 shkurt 2023
E	

D.2 Kohëzgjatja për realizimin e projektit

Tek tabela më poshtë paraqitet një pamje paraprake e periudhës që pritet nga OST-të e përfshira për realizimin e projekteve përkatës.

OST	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
TAP	35 muaj nga ndarja/veçimi i kapacitetit	47 muaj nga ndarja/veçimi i kapacitetit	59 muaj nga ndarja/veçimi i kapacitetit	59 muaj nga ndarja/veçimi i kapacitetit
SRG	NO1, NO2, NO3: Rritja e kapacitetit do të vihet në dispozicion pa asnjë përpjekje shtesë për shkak të investimit paraprak – koha në varësi të TAP-it			
DESFA	Në drejtim nga DESFA-ja në TAP: Kapaciteti në rritje mund të jetë i disponueshëm pas përfundimit të projekteve përkatëse, të miratuara tashmë në TYNDP të DESFA-së (përfundimi i vlerësuar në Q1 2024)			
DESFA	Në drejtim nga TAP-i në DESFA: 48 muaj OL 1 (përfundimi i parashikuar në Q1 2027) 54 muaj for OL 2 (përfundimi i parashikuar në Q3 2027)			

TAP

Pas marrjes së ofertave detyruese dhe një testi pozitiv të qëndrueshmërisë ekonomike për një nga katër projektet e zgjerimit për kapacitetin hyrës, TAP do të vazhdojë të zhvillojë dhe të specifikojë më tej elementët teknikë, orarin dhe kostot e Projektit të zgjedhur të Zgjerimit.²⁵ Paralelisht me zhvillimin e FEED-it, TAP-i do të kërkojë leje kryesore përkatëse dhe financim nga palët e treta, nëse ka.

TAP-i dhe pjesëmarrësit do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në lidhje me çdo përditësim të programit dhe do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për ta mbajtur tjetrin të përditësuar në lidhje me zhvillimet, ndryshimet ose vonesat që mund të ndikojnë në afatin kohor sipas të cilit mund të zbatohet Projekti i Zgjerimit (përfshirë, në lidhje me TAP, vonesat e parashikuara në datën e fillimit (siç përcaktohet në tabelën 2 të Marrëveshjes së

Transportit) dhe në lidhje me secilin pjesëmarrës, çështjet që kanë të bëjnë me funksionimet në rrjedhën e sipërme dhe disponueshmërinë e parashikuar të gazit për transport si pjesë e Projektit të Zgjerimit).

SRG

Kapaciteti për nivelin e ofertës 1, 2 dhe 3 është tashmë i disponueshëm.

SRG-ja mund të heqë dorë nga kushti (“Kushtet”) e mëparshme sipas marrëveshjeve të transportit të gazit (GTAs) dhe do të vazhdojë me zbatimin e projektit (shikoni paragrafin E.7).

DESFA

Bazuar në studimet teknike paraprake, DESFA-ja vlerëson se projektet e nevojshme për ofrimin e rritjes së kapacitetit (kompresori përforcues në Nea Mesimvria dhe Stacioni i ri i Kompresimit (CS) në Ampelia), siç përshkruhet në pjesën A.2.4 do të përfundojnë deri në Q4-2023, kështu që DESFA-ja do të të jetë në gjendje të ofrojë kapacitet të qëndrueshëm dalës në pikën dalëse të Nea Mesimvria në Q1-2024. Në çdo rast, duhet

²⁵ Në opsionin TAP, punimet paraprake inxhinierike dhe të projektimit mund të fillojnë gjithashtu përpara EVT.
Faqe | 18918



theksuar se afati kohor i lartpërmendur, për nivelin e ofertës të DESFA-së do të sqarohet më tej gjatë fazës së studimeve teknike.

Përveç kësaj, DESFA-ja do të ofrojë gjithashtu dy nivele ofertash për kapacitetin hyrës në pikën e interkonjeksionit në Nea Mesimvria (shih paragrafin A.2.3 më lart). Bazuar në studimet teknike paraprake, DESFA-ja vlerësoi projektet e nevojshme për ofrimin e rritjes së kapaciteteve. Për ofertën niveli 1 investimi i nevojshëm pritet të finalizohet brenda 48 muajve dhe kapaciteti do të ofrohet deri në Q1-2027 ndërsa për ofertën niveli 2 investimi i nevojshëm pritet të finalizohet brenda 54 muajve dhe kapaciteti do të ofrohet deri në Q3-2027. Në çdo rast, duhet theksuar se afatet kohore të sipërpërmendura, për nivelet e ofertës të DESFA-së do të sqarohen më tej gjatë fazës së studimeve teknike.

E. Rregullat dhe kushtet e përgjithshme për fazën detyruese (neni 27 (3) pika g e Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Ky kapitull përshkruan rregullat dhe kushtet e përgjithshme të cilat OST-të e përfshira do të aplikojnë për pjesëmarrje të palëve të interesuara në fazën detyruese.

Secila fazë detyruese do të hapet për të gjitha palët e interesuara, përfshirë ato që nuk kanë paraqitur kërkesën jodetyruese gjatë fazës jodetyruese të testimit të tregut për vitin 2021.

Vlerësimi për shërbimin e transportit për sistemet respektive të OST-së lejohet në mënyrë të paanshme dhe të barabartë për të gjitha palët e interesuara të cilat plotësojnë kërkesat e veçanta si tregohet më poshtë në këtë dokument.

Rritja e kapacitetit do të ofrohet si produkt i lidhur/detyruar (ku është e mundur) për pjesëmarrësit që kanë një kohëzgjatje minimale prej 3 vjetësh radhazi, me datën e fundit e mundshme të përfundimit për kapacitetin në Gazsjellësin TAP është skadimi i përjashtimit të TAP-it (14 nëntor 2045). Kërkesat për një kohëzgjatje më të shkurtër do të merren në konsideratë gjatë fazës së alokimit, sipas kufizimeve të përshkruara më poshtë.²⁶

²⁶ Kohëzgjatja minimale trevjeçare për ofertat që kontribuojnë në përcaktimin e shtrirjes së një zgjerimi është vendosur për të shmangur një kulm të shkurtër të kërkesës që çon në kërkesa jooptimale për investime dhe në ekonominë e zinxhirit të vlerës. Vini re, se kërkesa më

TAP

Kapaciteti i rezervuar në Gazsjellësin TAP duhet të ketë një datë fillestare përfundimi që është e njëjtë me datën e përfundimit të rezervimit përkatës në sistemin përkatës të OST-së fqinje dhe një kapacitet i tillë i pandërprerë i rezervuar në Gazsjellësin TAP do të jetë i lidhur me kapacitetin në sistemin përkatës të OST-së fqinje. Megjithatë, në lidhje me kapacitetin e alokuar në Gazsjellësin TAP, çdo pjesëmarrës do të ketë të drejtën, në përputhje me Marrëveshjen e Transportit të Gazit GTA, të njoftojë një datë të zgjatur përfundimtare për rezervimin e kapacitetit të tij. Kjo datë e zgjatur përfundimtare duhet të emërohet jo më vonë se dy muaj përpara E-COD dhe fillimisht lejon një zgjatje deri në datën 14 nëntor 2045. Nëse një pjesëmarrës e ushtron këtë të drejtë në lidhje me kapacitetin e rezervuar në Gazsjellësin TAP, do të jetë përgjegjësi e pjesëmarrësit për blerjen e kapaciteteve që përputhen në sistemin e OST-së fqinje. Për pikat e interkonjeksionit ku kapaciteti vihet në dispozicion si kapacitet i lidhur:

- pjesëmarrësi duhet t'i konfirmojë TAP-it jo më vonë se një muaj pas bërjes së një nominimi të tillë nëse dhe në çfarë mase ka blerë kapacitet që përputhet në sistemin e OST-së fqinje.

- çdo kapacitet i zgjerimit në TAP për të cilin pjesëmarrësi ka blerë kapacitet që përputhet me OST-në fqinje do të bashkohet me atë kapacitet në OST fqinje; dhe

- çdo kapacitet i zgjerimit në TAP, për të cilin pjesëmarrësi nuk ka blerë kapacitet që përputhet brenda periudhës një mujore të specifikuar më sipër, nuk do të mbahet nga pjesëmarrësi për të shmangur rezervimet e mbetura të kapaciteteve të ndërprera në TAP.

Pavarësisht opsionit për të njoftuar një datë të zgjatur përfundimtare për kapacitetin e rezervuar në Gazsjellësin TAP, TAP do të përdorë vetëm rezervime të kapacitetit të sigurt të pandërprerë me qëllim llogaritjen dhe kalimit të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) për çdo Projekt Zgjerimi të zbatueshëm. Megjithatë, mund të ketë rrethana kur ky opsion për të njoftuar një datë të zgjatur përfundimtare të rezervimeve në Gazsjellësin TAP do të pengojë TAP të ndajë/veçojë kapacitetin (qoftë në këtë

të shkurtra mund të përfshihen në një EVT nëse kërkohet që kjo të kalohet (shih E. 6).



projektzgjërimi ose në një fazë të ardhshme detyruese) që, nëse do të ndahej, do të rezultonte në një test pozitiv të qëndrueshmërisë ekonomike dhe të shkaktojë një zgjerim të mëtejshëm. Kjo mund të ndodhë nëse një pjesëmarrës kërkon kapacitet që aktualisht është i rezervuar sipas opsionit të zgjerimit të mbajtur nga një pjesëmarrës tjetër. Nëse kjo ndodh, për t'u dhënë përparësi zgjerimeve të mëtejshme, TAP-i mund të njoftojë pjesëmarrësin përkatës se data e fundit përfundimtare për zgjatjen është vendosur një datë më e hershme që i lejon TAP-i t'i ndajë kapacitetin e kërkuar pjesëmarrësit tjetër.

Vini re, gjithashtu se në lidhje me shpërndarjen e kapacitetit të lidhur, në rast të një vonese ose mospërputhjeje në datën e fillimit të kapacitetit për një OST fqinje, TAP-i ka të drejtën (por jo detyrimin) të bie dakord dhe të zbatojë mënyra për të zbutur pasojat e një vonese ose mospërputhjeje të tillë, duke përfshirë bërjen e rregullimeve për çdo ndarje të kapacitetit të lidhur ose, në lidhje me ofertat e lidhura, të kapacitetit të alokuar si në pikat e daljes ashtu edhe në ato të hyrjes, siç mund të bihet dakord me pjesëmarrësin përkatës. Çdo lehtësim i tillë pritet të jetë neutral për TAP-in.

SRG

Për të shmangur dyshimin, e drejta e sipërpërmendur e dhënë nga TAP-i pjesëmarrësve për të njoftuar një datë të përditësuar përfundimtare për rezervimin e kapacitetit të tij në Gazsjellësin TAP, nuk ofron asnjë të drejtë në lidhje me ofertën nga ana e SRG-së. Në lidhje me shpërndarjen e kapacitetit të lidhur, në rast të një vonese ose mospërputhjeje në datën e fillimit të kapacitetit për një OST fqinje, SRG-ja ka të drejtën (por jo detyrimin) të bie dakord dhe të zbatojë mënyra për të zbutur pasojat e një vonese ose mospërputhjeje të tillë, duke përfshirë duke bërë rregullime për çdo alokim të kapacitetit të lidhur siç mund të bihet dakord me pjesëmarrësin përkatës. Çdo lehtësim i tillë pritet të jetë neutral për SRG-në.

DESFA

Për të shmangur dyshimet, e drejta e sipërpërmendur e dhënë nga TAP-i për pjesëmarrësit për të njoftuar një datë të përditësuar përfundimtare për rezervimin e kapacitetit të tij, nuk ofron asnjë të drejtë në lidhje me ofertën nga ana e DESFA-së.

Në lidhje me shpërndarjen e kapacitetit të lidhur, në rast të një vonese ose mospërputhjeje në

datën e fillimit të kapacitetit për një OST fqinje, DESFA-ja ka të drejtën (por jo detyrimin) të bie dakord dhe të zbatojë mënyra për të zbutur pasojat e një vonese të tillë ose mospërputhjeje, duke përfshirë bërjen e rregullimeve për çdo alokim të kapacitetit të lidhur siç mund të bihet dakord me pjesëmarrësin përkatës. Çdo lehtësim i tillë pritet të jetë neutral për DESFA-në.

E.1 Kriteret e pjesëmarrjes dhe regjistrimi

Kërkesat e referuara në këtë paragraf E.1 do të zbatohen për fazën detyruese të kryer nga OST-ja.

Aplikuesit do të duhet të dorëzojnë formularët e plotësuar të Regjistrimit të Fazës Detyruese në TAP, SRG dhe DESFA, të cilat do të sigurohen së bashku me njoftimin e përbashkët dhe njoftimin e fazës detyruese të secilit OST. Informacioni që do të dorëzohet nga aplikantët do të përfshijë (por pa u kufizuar në) informacionin e mëposhtëm:

A. Emrin e kompanisë dhe adresën;

B. Emrin dhe detajet e kontaktit të personit që përfaqëson kompaninë;

C. Listën e pikave të interkonjeksionit ku aplikuesi mendon të paraqesë angazhimin detyrues.

Kërkesat e mësipërme të regjistrimit zbatohen së bashku dhe duke iu nënshtruar kërkesave të mëtejshme të çdo OST në lidhje me regjistrimin dhe kuadrin e tyre rregullator të zbatueshëm, në secilin rast siç tregohet më poshtë.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë (brenda afateve të kërkuara) të gjitha dokumentet e nevojshme, siç përshkruhet në këtë paragraf E.1, njoftimin e fazës detyruese të secilës OST dhe njoftimin e përbashkët, dhe gjithashtu potencialisht t'u mundësohet të operojë në një platformë të identifikuar kapaciteti të përbashkët nëse kjo vendoset nga OST-të e përfshira, siç tregohet në njoftimin e përbashkët.

Në përfundim të periudhës së regjistrimit, TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja do t'u komunikojnë aplikuesve përshtatshmërinë e tyre për të marrë pjesë te faza e ofertës detyruese.

Duke marrë pjesë te faza e ofertës detyruese, secilit pjesëmarrës do t'i kërkohej të pranojë që:

- Alokimi i kapacitetit referuar gjatë procesit të rritjes së kapacitetit do t'i nënshtrohet rezultatit pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike për OST-të e përfshira;

- Në rastin e një rezultati negativ të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), OST-ja duhet të kthejë çdo garanci bankare të paraqitur gjatë



regjistrimit ose me ofertat dhe asnjë kapacitet për transport i kontraktuar nuk do të alokohet/ndahet, veçohet;

- Në rastin e një rezultati pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), të kryer përpara alokimit të kapacitetit, pjesëmarrësi i suksesshëm duhet të nënshkruajë një Marrëveshje për Transportin e Gazit dhe duhet t'u kalojë OST-ve përkatëse garancitë bankare përshkruar në paragrafin E.7 më poshtë;

- Në rastin kur një pjesëmarrësi nuk i alokohet rritja e kapacitetit pas një testi pozitiv të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), garancia bankare duhet të kthehet;

- Nëse pjesëmarrësit i ndahet kapaciteti, por Marrëveshja për Transportin e Gazit (GTA) ndërmjet OST-së dhe pjesëmarrësit nuk ekzekutohet ndërmjet palëve përkatëse ose nuk bëhet, për ndonjë arsye, plotësisht efektive, pjesëmarrësi do t'u nënshtrohet rregullave specifike të OST-së, siç përcaktohet më poshtë.

TAP

TAP-i pranon si pjesëmarrëse në fazën detyruese ose: i. palët që janë tashmë të regjistruara në TAP sipas rregullave të Kodit të Rrjetit të TAP-it (**pala/ët e regjistruara**)²⁷; ose ii. palët që kanë filluar siç duhet këtë proces regjistrimi (duke ndjekur hapat e treguar në faqen e internetit të TAP-it “Si të bëheni palë e regjistruar” dhe pasi të kenë plotësuar dhe dorëzuar saktë formularin fillestar të pjesëmarrjes.²⁸ Deri në fund të periudhës së regjistrimit siç tregohet më sipër në paragrafin D (d.m.th. 13 dhjetor 2022):

- Aplikuesit duhet të kenë dorëzuar një formular të regjistrimit të fazës detyruese të nënshkruar siç duhet për testimin e tregut 2021²⁹; ju lutemi, vini re se së bashku me formularin e regjistrimit të fazës detyruese, të gjitha palët duhet të dorëzojnë një marrëveshje konfidencialiteti³⁰ (siç kërkohet në

formularin e regjistrimit të fazës detyruese)³¹; dhe

- Çdo aplikues që nuk është ende palë e regjistruar në TAP duhet të ketë filluar gjithashtu procesin për t'u bërë palë e regjistruar sipas rregullave të Kodit të Rrjetit TAP duke plotësuar dhe dorëzuar saktë formularin fillestar të pjesëmarrjes. Për të qenë më të qartë, këtyre aplikuesve u kërkohet gjithashtu të paraqesin një formular regjistrimi të fazës detyruese dhe marrëveshje të konfidencialitetit, siç është përmendur më lart.³²

Në formularin e regjistrimit të fazës detyruese, ndër të tjera çështje, çdo aplikues duhet të pranojë:

- që asnjë gaz i sanksionuar nuk do të transportohet përmes gazsjellësit TAP.

- detyrimi i tyre për t'u përfshirë në vlerësimin e kapacitetit me autoritetet dhe për të paraqitur çdo informacion të kërkuar për të kryer një vlerësim të tillë tek autoritetet përkatëse (ARERA në Itali, RAE në Greqi dhe ERE në Shqipëri). Pasi të jetë bërë vlerësimi, aplikuesit i kërkohet të informojë TAP për çdo kufi/limit kapaciteti që mund të vendoset pas vlerësimit të dominimit.

Pas konfirmimit nga TAP se një aplikues ka të drejtë të marrë pjesë në fazën e ofertës detyruese, aplikuesi i tillë bëhet pjesëmarrës. Një pjesëmarrës mund të dorëzojë një formular të ofertës detyruese në përputhje me kërkesat e këtij projektpropozimi, njoftimit të përbashkët, njoftimit të fazës detyruese të publikuar nga çdo OST dhe formularit të ofertës detyruese.

Kur një pjesëmarrës dorëzon një formular oferte detyruese në TAP, pjesëmarrësit do t'i kërkohet në të njëjtën kohë t'i dorëzojë TAP-it një garanci bankare sipas kërkesës (**garancia e ofertës**) me një datë skadimi jo më herët se 30 prill 2023 nga një bankë me reputacion ndërkombëtar, me një vlerësim minimal të kredisë BBB – në Standard dhe Poor's ose Baa3 në Moody's, ose në mënyrë alternative të lëshuar nga çdo institut financiar grek i mbikëqyrur nga ECB (banka sistematike, përkatësisht çdo nga Alpha Bank, Eurobank, Banka Kombëtare e Greqisë dhe Piraeus Bank), i cili është miratuar paraprakisht nga TAP-i sipas gjykimit të tij absolut, i arkëtueshëm me kërkesën e parë të TAP-it dhe i barabartë në vlerë me më të ulëtën e:

I. 15% e kapacitetit maksimal vjetor të kërkuar

²⁷ “Palë e regjistruar” nënkupton çdo person që ka plotësuar kushtet për t'u bërë Palë e Regjistruar e specifikuar në paragrafin 3.1 të Kodit të Rrjetit TAP dhe ka marrë konfirmimin nga transportuesi për statusin e tij si Palë e Regjistruar, në përputhje me Kodin e Rrjetit TAP.

²⁸ <https://www.tap-ag.com/shippers/applying-to-become-a-registered-party>

²⁹ Linku është bërë një herë; formulari i regjistrimit të fazës detyruese që aplikuesit duhet të dorëzojnë në TAP është dhënë në seksionin e shtojcave të këtij njoftimi të fazës detyruese.

³⁰ Modeli i Marrëveshjes së Konfidencialitetit do të gjendet në shtojcën XX të këtij njoftimi të fazës detyruese.

³¹ Shtoni linkun në formularin BP Reg.

³² <https://www.tap-ag.com/shippers/applying-to-become-a-registered-party>



nga pjesëmarrësi në të gjitha pikat e interkonjeksionit shumëzuar me tarifën e TAP-it për kapacitetin e sigurt afatgjatë në drejtim përpara, publikuar për vitin kalendarik 2022; dhe

II. 30 MEUR.

Garancia e ofertës jepet si garanci në lidhje me angazhimet dhe detyrimet e pjesëmarrësit sipas dhe në lidhje me këtë propozimprojekti. TAP-i ka të drejtë të bëjë një kërkesë sipas garancisë së ofertës në çdo kohë deri në shumën totale të disponueshme për kërkesë sipas garancisë së ofertës, nëse:

i. në çdo kohë, vlerësimi i kredisë i bankës që ofron garancinë e ofertës nuk i plotëson më kërkesat e përcaktuara më sipër (përfshirë në lidhje me vlerësimin minimal të kredisë) ose nëse garancia e ofertës ka një datë skadimi përpara 30 prillit 2023 dhe garancia e ofertës nuk është e rinovuar (në të njëjtën formë si garancia e ofertës që zëvendëson dhe plotëson kërkesat e përcaktuara më lart në lidhje me ofruesin) në jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para skadimit të garancisë origjinale të ofertës;

ii. Pjesëmarrësi nuk arrin të përmbushë angazhimet dhe detyrimet e tij që lindin si rezultat dhe në lidhje me tërheqjen e ofertës së tij ose përfundimin e një Marrëveshje për Transportin e Gazit (GTA) (shih paragrafin E.7 më poshtë); ose

iii. Pjesëmarrësi nuk ofron garancinë pas ofertës në përputhje me paragrafin E.7 më poshtë.

Nëse garancia e ofertës do të kryhet vetëm në lidhje me rrethanat e përcaktuara në pikat “i” ose “iii” më sipër dhe nëse, sipas gjykimit të vetëm të TAP-it, rrethana të tilla janë korrigjuar në mënyrë adekuatë nga lëshimi i një garancie ose dispozite të rinovuar ose të re të ofertës, ose dhënien e garancisë pas ofertës në përputhje me paragrafin E.7 (siç zbatohet) ose me zbatimin e marrëveshjeve të tjera të pranueshme për TAP-in, TAP-i do t'i kthejë pjesëmarrësit ato shuma, nëse ka, të marra nga TAP-i për kryerjen e garancisë së ofertës për shkak të rrethanave të përcaktuara në pikat “i” ose “iii”, nëse shuma të tilla nuk janë përdorur nga TAP-i në përputhje me këtë projektpropozim.

Garancia e ofertës e dhënë për TAP-in nga secili pjesëmarrës do t'i kthehet nga TAP-i këtij pjesëmarrësi sapo:

- TAP-i konfirmon se pjesëmarrësit nuk do t'i alokohen kapacitetet në Projektin e Zgjerimit;
- Rezultati i testit të qëndrueshmërisë ekono-

mike (EVT), përfundimisht përcaktohet si negativ (në përputhje me dispozitat e paragrafit E. 6 të këtij projektpropozimi); ose

- Nëse pjesëmarrësit i alokohet një rritje e kapacitetit si pjesë e Projektit të Zgjerimit, me sigurimin e një garancie pas ofertës për TAP-i në përputhje me paragrafin E.7 më poshtë.

Duke paraqitur një formular të ofertës detyruese në TAP, pjesëmarrësi pranon:

- që dorëzimi i një oferte detyruese do të përbëjë një angazhim të pakthyesëm për të hyrë në një Marrëveshje për Transportin e Gazit (GTA) me TAP-in, vetëm në varësi të rezultatit të suksesshëm të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT); dhe

- pasojat e përfundimit të Marrëveshjes për Transportin e Gazit (GTA), siç përcaktohet në paragrafin E.7 më poshtë.

Pavarësisht nga sa më sipër, TAP-i sipas gjykimit të tij (dhe në masën e rënë dakord paraprakisht me TAP) mund të pranojë një formë alternative të mbështetjes kreditore të pranueshme për të, në vend të një garancie bankare. Nëse ofrohet një mbështetje e tillë alternative kreditore, ajo duhet të ofrohet në mënyrë të tillë që të mund të përdoret nga TAP-i në rrethanat në të cilat TAP-i do të lejohej të njoftonte garancinë bankare. Të gjitha të drejtat, mjetet juridike dhe kompetencat e TAP-i, në lidhje me garancitë bankare (siç përcaktohet në këtë projektpropozim) do të zbatohen në mënyrë të barabartë për këtë formë alternative të mbështetjes kreditore.

SRG

Aplikuesve do t'u kërkohej të deklarojnë zotërimin e kërkesave përkatëse të përcaktuara në paragrafin 1.1, kapitulli 5 dhe të respektojnë kushtet e përmendura në paragrafët 1.4 dhe 9.1 të kapitullit 5 të Kodit të Rrjetit të Gazit Snam Rete.

Çdo deklaratë për zotërimin e kërkesave (detyrimeve, angazhimeve, deklaratave ose pranimeve), si dhe çdo kërkesë/komunikim ose shprehje vullneti, e bërë nga Pjesëmarrësi, përfshirë përmes funksionimit të faqes së internetit të SRG-së ose të platformës së përbashkët për rezervimin e kapaciteteve, përbën detyrimin formal dhe angazhimin mbi atë pjesë të Pjesëmarrësve, të cilët pranojnë edhe në lidhje me palët e treta – dhe të gjitha detyrimet që lindin nga shkeljet/gabimet ose heqjet.

Pjesëmarrësve u kërkohej të paraqesin në SRG brenda përfundimit të fazës së informimit:



- Marrëveshjen e Transportit të Gazit (GTA) të nënshkruar nga personi që ka prokurën.

- “Garancia e parë”: një garanci bankare, e arkëtueshme me kërkesë të parë, e lëshuar nga një institut financiar italian ose kompani italiane sigurimesh ose degë italiane e një banke të huaj ose kompanie të huaja sigurimesh me një vlerësim minimal të kreditit BBB – në Standard dhe Poor’s ose vlerësimet e Fitch, Baa3 në Moody’s ose BBB të ulëta në DBRS ose një depozitë sigurie pa interes, përkatësisht e barabartë në vlerë me 20% të tarifës maksimale vjetore të kapacitetit (bazuar në tarifën treguese të vënë në dispozicion nga SRG-ja) të rritjes së kapacitetit që ata synojnë të kërkojnë dhe me datë skadimi jo më herët se 15.8.2023.

SRG-ja do të publikojë në faqen e saj të internetit vlerën që parashikohet për detyrimin vjetor të kapacitetit referuar Projektit për Rritjen e Kapacitetit.

Ofertat detyruese nga pjesëmarrësit do të pranohen sipas limiteve të garancive të para të cilat do të paraqiten SRG sipas dispozitave më sipër.

Garancia e parë e dhënë për SRG-në nga secili pjesëmarrës do t’i kthehet nga SRG-ja këtij pjesëmarrësi, sapo:

- SRG-ja konfirmon se pjesëmarrësit nuk do t’u alokohen kapacitetet në Projektin e Zgjerimit;

- Rezultati i testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), përfundimisht përcaktohet si negativ (në përputhje me dispozitat e paragrafit E6 të këtij projektpropozimi); ose

- Nëse pjesëmarrësit i alokohen një rritje e kapacitetit si pjesë e Projektit të Zgjerimit, pas dhënies së garancive të kontratave në SRG në përputhje me paragrafin E.7, më poshtë.

Duke paraqitur një formular të ofertës detyruese në SRG, pjesëmarrësi pranon:

- që dorëzimi i një oferte detyruese do të përbëjë një angazhim të pakthyeshëm për të hyrë në një Marrëveshje për Transportin e Gazit (GTA) me SRG-në, vetëm në varësi të rezultatit të suksesshëm të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT); dhe pasojat e përfundimit të Marrëveshjes për Transportin e Gazit (GTA), siç përcaktohet në paragrafin E.7 më poshtë.

DESFA

Aplikuesve do t’u kërkohej të deklarojnë zotërimin e kërkesave përkatëse të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të DESFA-së, shtojcën I të Marrëveshjes Standarde të Transmetimit të Sistemit

Kombëtar të Gazit Natyror (NNGS) dhe Aplikimin përkatës. Vetëm përdoruesit e transmetimit, siç përcaktohet në Kodin e Rrjetit të DESFA, mund të dorëzojnë oferta detyruese për kapacitetin hyrës/dalës në/nga sistemi DESFA, në fazën e ofertës detyruese. Kërkesat specifike që duhet të plotësohen nga palët e interesuara do të përcaktohen në detaje në nenin e DESFA-së të njoftimit të përbashkët (njoftimi i fazës detyruese të DESFA-s). DESFA-ja nuk do të lejojë asnjë palë të interesuar të paraqesë oferta detyruese nëse këto kërkesa nuk plotësohen dhe edhe nëse dorëzohen do të refuzohet për këtë arsye.

Çdo deklaratë për zotërimin e kërkesave (detyrimeve, angazhimeve, deklaratave ose pranimeve), si dhe çdo kërkesë/komunikim ose shprehje vullneti, e bërë nga pjesëmarrësi, përfshirë përmes funksionimit të faqes së internetit të DESFA-së ose të platformës së përbashkët për rezervimin e kapaciteteve, përbën detyrimin formal dhe angazhimin mbi atë pjesë të Pjesëmarrësve, të cilët pranohen edhe në lidhje me palët e treta – dhe të gjitha detyrimet që lindin nga shkeljet/gabimet ose heqjet.

Pjesëmarrësve u kërkohej t’i paraqesin DESFA-së brenda afateve të kërkuara një garanci bankare (garancia e ofertës detyruese), e arkëtueshme me kërkesë të parë të DESFA-së, të lëshuar nga çdo institut financiar grek i mbikëqyrur nga ECB (banka sistemike, përkatësisht çdo nga Alpha Bank, Eurobank, Banka Kombëtare e Greqisë dhe Banka e Pireut) duke përfshirë filialet e tyre ose çdo degë greke të një banke me reputacion ndërkombëtar me një vlerësim minimal të kredisë nga agjencitë e mëposhtme: BBB në Standard and Poor’s, BBB në Fitch ose Baa3 në Moody’s, ose ndonjë bankë me reputacion ndërkombëtar me një vlerësim kredie të shkallës minimale të investimit (siç përshkruhet më sipër), ose ndonjë filial i një banke me reputacion ndërkombëtar me një vlerësim kredie të shkallës minimale të investimit (siç përshkruhet më lart) ose çdo filial i një banke me reputacion ndërkombëtar pa një vlerësim kredie të shkallës minimale të investimit (ose pa ndonjë vlerësim), me kusht që garancia bankare të jetë e garantuar nga çdo bankë me reputacion ndërkombëtar, një vlerësim kredie të shkallës minimale së investimit (siç përshkruhet më sipër); e cila është miratuar paraprakisht nga DESFA-ja, sipas gjykimit të saj, e barabartë në vlerë me 20% të tarifës maksimale vjetore të



kapacitetit (bazuar në tarifën treguese të vënë në dispozicion nga DESFA-ja, duke përfshirë çdo prim minimal të detyrueshëm) të rritjes së kapacitetit që ata synojnë të kërkojnë, e vlefshme deri në 2 (dy) muaj nga zbatimi i Marrëveshjeve për Transportin e Gazit sipas D.1.1.

DESFA-ja do të publikojë në faqen e internetit vlerën e përlogaritur të tarifës vjetore të kapacitetit sipas Projektit për Rritjen e Kapacitetit.

Ofertat detyruese nga pjesëmarrësit do të pranohen vetëm brenda kufijve të garancive që do t'i paraqiten DESFA-së sipas dispozitave të mësipërme. Duke paraqitur një kërkesë të detyrueshme në DESFA, pjesëmarrësi pranon që kërkesa në fjalë do të përbëjë një angazhim të parevokueshëm për të hyrë në një Marrëveshje për Transportin e Gazit (GTA) me DESFA, në varësi të rezultatit të suksesshëm të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT).

Garancia e ofertës detyruese e dhënë për DESFA-në nga secili pjesëmarrës do t'i kthehet nga DESFA-ja këtij pjesëmarrësi sapo:

- DESFA-ja konfirmon se pjesëmarrësit nuk do t'i alokohen kapacitetet në Projektin e Zgjerimit;

- Rezultati i testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), përfundimisht përcaktohet si negativ (në përputhje me dispozitat e paragrafit E6 të këtij projektpropozimi); ose

- Nëse pjesëmarrësit i alokohen një rritje e kapacitetit si pjesë e Projektit të Zgjerimit, pas dhënies së garancive bankare të Marrëveshjeve për Transportin e Gazit (GTA) në DESFA në përputhje me paragrafin E.7 më poshtë

E.2 Përmblajtja e ofertës detyruese

Gjatë fazës së ofertës detyruese, pjesëmarrësit duhet të paraqesin ofertat detyruese për produktet e rritjes së kapacitetit për çdo OST.

Tek çdo ofertë detyruese pjesëmarrësit duhet të specifikojnë:

Pjesëmarrësit duhet të tregojnë nëse oferta detyruese është një **ofertë e lidhur**, duke qenë që nga treguesit e formatit të ofertës. Te një ofertë e lidhur kapaciteti që kërkohej te pika e hyrjes e TAP-it duhet të jetë e barabartë me kapacitetin dalës që kërkohej te një pikë tjetër interkonjeksioni/pikë dalje.

- **Kapaciteti i kërkuar (gjatë kwh/ditë) për pikën e hyrjes dhe të daljes.** Kapaciteti që kërkohej nuk duhet të kalojë rritjen maksimale të kapacitetit që ofrohet te një pikë e veçantë

interkonjeksioni, si përcaktohet tek tabela përkatëse në paragrafin B.

- **Data e fillimit që kërkohej.**

- **Data e fundit e ofertës.** Përveç kërkesave vjetore (me limitet si poshtë shënuar dhe përshkruar në paragrafin E.6), kohëzgjatja nuk mund të jetë më pak se 3 vjet radhazi të gazit, me datën më të vonë/të fundit të mundshme për rezervim të kapacitetit në Gazsjellësin TAP që është 14 nëntor 2045. Për të shmangur dyshimet, çdo ofertë detyruese duhet të lidhet me vitet radhazi.

- **Treguesi nëse ulja e kapacitetit pranohet ose jo.** Pjesëmarrësi po ashtu duhet të tregojë nëse ata do të pranojnë uljen e alokimit/ndarjes së kapacitetit (dhe deri në çfarë shume) në rastin kur kongestionet dhe oferta e tyre janë marxhinale. Për ofertat e lidhura, çdo ulje/zbritje në kapacitet te pikat e interkonjeksionit ku oferta e lidhur vlerësohet të jetë marxhinale, do të çojë në një ulje të barabartë të rritjes së kapacitetit te pikat e lidhura të interkonjeksionit. (duhet të theksohet që kapaciteti i lidhur/detyrues, uljet/reduktohet në të njëjtën sasi tek të dy anët e pikës së interkonjeksionit).

Pjesëmarrësit mund të paraqesin më shumë se një ofertë detyruese. Ofertat e paraqitura nga i njëjti pjesëmarrës mund të variojnë, sipas pikës së interkonjeksionit, kohëzgjatjes së kapacitetit të kërkuar dhe sasisë së kapacitetit. Si rregull i përgjithshëm, tek e njëjta ofertë detyruese, pjesëmarrësit mund të specifikojnë vetëm një vlerë të rritjes së kapacitetit për të gjitha vitet e gazit që kërkohej. Oferta detyruese megjithatë mund të tregojë një ngritje/rritje gjatë dy viteve të para të periudhës së cilës i përkasin ofertat detyruese, me një vlerë minimale për vitin e parë të gazit prej 40% e kapacitetit dhe 70% gjatë vitit të dytë. Nëse pjesëmarrësit dëshirojnë të profilizojnë më tej kërkesën për kapacitet, ato duhet të paraqesin oferta të veçanta detyruese.

Një ofertë detyruese nuk kërkon specifikimin e një çmimi oferte, duke qenë që çmimi që aplikohet për rritje të kapacitetit për qëllim të procesit të vlerësimit duhet të jetë i barabartë me çmimin rezervë plus çdo çmim minimal të detyrueshëm në rastet kur aplikohet. Tarifa e TAP-it specifikohet sipas Kodit të Tarifave të TAP-it. Tarifa vjetore përkatëse e kapacitetit nga SRG-ja dhe DESFA-ja, sipas dispozitave të rregulloreve përkatëse të



tarifave, të miratuara nga autoritetet përkatëse (për t'u përdorur si çmim referencë e vlerësuar për kohëzgjatjen e kërkesave fillestare të rritjes të kapacitetit), do të publikohet në faqet e tyre të internetit gjatë fazës së informimit. Nuk do të ketë asnjë çmim ankandi shtesë mbi çmimet e referencës (përveç në lidhje me procesin e ofertës marxhinale të barabartë të përcaktuar në paragrafin E.5 më poshtë) me përjashtim të pikës së interkonjeksionit në Melendugno ku pjesëmarrësit, duke marrë parasysh kufizimin konkurrues, do të paraqesin gjithashtu një tregues të çmim të ankandit që janë të gatshëm të paguajnë dhe që do të merren parasysh për renditjen e ofertave të tyre siç përshkruhet në shtojcën III. Ofertat do të duhet të dorëzohen brenda dritares për paraqitjen e ofertave sipas udhëzimeve të cilat do të ofrohen gjatë njoftimit të fazës detyruese të publikuara nga OST-ja.

Me paraqitjen e formularit për ofertat detyruese, një pjesëmarrës do të konsiderohet se ka rënë dakord me kushtet dhe procesin e përcaktuar në këtë propozimprojekti dhe njoftimin e përbashkët të publikuar nga OST-ja, si dhe me njoftimin e fazës detyruese të çdo OST-je përkatëse duke përfshirë procesin në lidhje me propozimin e përgjithshëm të projektit dhe detyrimin e mundshëm të pjesëmarrësit për kostot e ndërprerjes në lidhje me një Marrëveshje për Transportin e Gazit (GTA) që nuk ekzekutohet midis palëve përkatëse ose nuk bëhet plotësisht efektive në përputhje me kushtet e tij dhe/ose përfundimin ose modifikimin e procesit për rritjen e kapacitetit. (shih më shumë detaje në paragrafët E.1 dhe E.7).

E.3 Vlerësim i ofertave

Në përfundim të dritares për paraqitjen e ofertave, çdo OST duhet të vlerësojë ofertat detyruese të marra nëse ato janë përfunduar dhe pajtohen me kërkesat respektive të përcaktuara në këtë propozimprojekti, njoftimi i përbashkët dhe njoftimi i fazës detyruese të lëshuar nga çdo OST (përfshirë, aty ku kapaciteti po vihet në dispozicion si kapacitet i lidhur, secilës prej OST-së të përfshira i janë bërë oferta detyruese të barabarta). Ato oferta detyruese të cilat pranohen nga kjo fazë, merren në konsideratë gjatë procedurës së veçimit paraprak të kapacitetit, paragrafi E.4 më poshtë. Në rast kundërshtimi të ofertës detyruese, OST-ja respektive duhet t'ia njoftojë dhe justifikojë

pjesëmarrësit dhe OST-të të tjera të përfshira brenda 5 ditë pune nga përfundimi i dritares/pjesës për paraqitjen e ofertës. Për të shmangur dyshimin, OST-ja refuzuese nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj OST-ve të tjera të përfshira ose ndonjë pale tjetër në lidhje me një refuzim të tillë.

E.4 Procedura paraprake për veçimin e kapacitetit (renditja e ofertave)

Rregullat për ndarjen paraprake të kapacitetit për rritjen e kapacitetit tek të pesta pikat e interkonjeksionit, përshkruhen më poshtë. Nëse një OST kufizon ose refuzon çdo ofertë detyruese në një pikë interkonjeksioni ku kapaciteti vihet në dispozicion si kapacitet i lidhur, oferta detyruese e lidhur e bërë me OST-në tjetër të përfshirë gjithashtu do të kufizohet ose refuzohet në të njëjtën masë.

OST-ja duhet të ndërmarrin veprimet e përmendura më poshtë.

- Për çdo vit, shumica e kërkesave të kapacitetit për ofertat detyruese kryhet te çdo pikë interkonjeksioni.

- Nëse nuk ka kongestion te pika e interkonjeksionit, OST-të e përfshira duhet të ndërmarrin ndarjen/veçimin paraprak të kapacitetit dhe të vazhdojnë me procesin e testit të qëndrueshmërisë ekonomike të përcaktuar në paragrafin E.6.

- Nëse ka kongestion te një pikë interkonjeksioni dhe duke pasur parasysh strukturën e veçantë rregullatore të përcaktuar për TAP-in nga autoritetet, ofertat detyruese të marra në lidhje me atë pikë interkonjeksioni renditen sipas raportit të vlerës aktuale neto (NPV) të të ardhurave hipotetike te sistemi i TAP-it nga oferta pjesëtuar me kapacitetin maksimal vjetor të ofertës. Në rastin e ofertave të lidhura, të ardhurat hipotetike përfshijnë të ardhurat nga TAP-i dhe ato nga pika e hyrjes në Kipoi dhe pika dalje të TAP-it pjesë përbërëse e ofertës. Oferta marxhinale te pika e interkonjeksionit në kongestion/të mbingarkuar, i alokohet kapacitetit shtesë të mbetur derisa pjesëmarrësi të deklarojë shprehimisht, tek oferta detyruese se nuk pranon zvogëlim të kapacitetit. Nëse pjesëmarrësi i këtyre ofertave marxhinale nuk pranon zvogëlimin/uljen e kapacitetit, kapaciteti që mbetet i ndahet pjesëmarrësit tjetër me një vlerë aktuale neto më të ulët/raport i kapacitetit. Nëse nuk ka pjesëmarrës të tjerë me vlerën aktuale neto më të vogël/raport



të kapacitetit, vetëm kapaciteti i alokuar (pa pjesëmarrës) do të merret parasysh tek testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT).

- Në rastin e dy ose më shumë ofertave të barabarta marxhinale, duhet të fillohet një ankand sipas paragrafit E.5.

- Nëse oferta lidhëse ndodh që të jetë një nga ofertat e barabarta marxhinale, reduktimi i barabartë i kapacitetit do të kryhet nga OST-ja e përfshira te pikat e lidhura të interkonjeksionit / pikat dalëse.

- Rezultati i procesit paraprak të alokimit përmban një tabelë e cila tregon çdo nivel oferte dhe pikat e interkonjeksionit të cilat tregojnë të gjitha ofertat detyruese.

Afatet kohore dhe detajet administrative që lidhen me procesin e paraqitjes së ofertës do të specifikohen te njoftimi i përbashkët nga OST-ja.

E.5 Ndarja e ofertave marxhinale të barabarta (EMB)

Ankandet do të zhvillohen vetëm te pikat e interkonjeksionit ku ka oferta marxhinale të barabarta.

Vetëm pjesëmarrësit me oferta marxhinale të barabarta do të përfshihen në ankand. Vetëm pjesëmarrësit me oferta marxhinale të barabarta do të përfshihen në ankand. [Për pikat e interkonjeksionit ku kapaciteti vihet në dispozicion si kapacitet i lidhur, do të zhvillohet një ankand i vetëm në lidhje me ofertat detyruese në të dyja anët e asaj pike interkonjeksioni.]

Pjesëmarrësit me oferta marxhinale të barabarta do të ftohen që të paraqesin deri në 3 (tri) oferta për kapacitetin marxhinal të aplikueshëm. Secila nga këto oferta përfshin një sasi kapaciteti (deri te kapaciteti maksimal në dispozicion në ankand), rishikuar sipas datës së fundit të ofertës (nëse kjo është më vonë se oferta origjinale) dhe çmimi i ankandit do të merret parasysh mbi çmimin rezervë, i cili shërben si çmim dysHEME në ankand.

OST-të e përfshira do të ftojnë ofertuesit me oferta marxhinale të barabarta (**EMB Bidders**) që të paraqesin ofertat e reja brenda 5 ditë pune nga përfundimi i seksionit/dritares për paraqitjen e ofertave. Formulari për ofertat detyruese marxhinale të barabarta (EMB Binding Bid Form) duhet të paraqitet nga ofertuesit brenda 5 ditë nga ftesa. OST-të duhet të përcaktojnë afatin e saktë (kohën dhe datën) për paraqitjen e ofertave marxhinale të barabarta (EMB Bid Submission) te

ftesa, e cila do t'u dërgohet ofertuesve të ofertës marxhinale të barabartë (**EMB Bid Submission Deadline**).

Për SRG-në, ofertat marxhinale të barabarta do të shoqërohen nga një ndryshim në garancinë e parë të përshkruar në paragrafin E.1 të barabartë me 20% të kapacitetit të kërkuar shumëzuar me tarifën e re të aplikuar të SRG-së (çmimi i rezervës i paraqitur në paragrafin G.1.1 + çmimin e mundshëm).

Për DESFA-në, garancitë bankare të përshkruara në paragrafin E.1, duhet të ndryshohen në përputhje me rrethanat dhe të bëhen të barabarta me 20% të tarifës maksimale vjetore të kapacitetit (bazuar në tarifën treguese të vënë në dispozicion nga DESFA-në, duke përfshirë çdo çmim minimal të detyrueshëm + çmimin e mundshëm) të rritjes së kapacitetit që pjesëmarrësit synojnë të kërkojnë.

Për TAP-in, nëse ofertuesit me oferta marxhinale të barabarta kërkojnë rritje të kapacitetit (deri në nivelin maksimal të kapacitetit marxhinal të zbatueshëm) ndaj atij të kërkuar në ofertën e tyre origjinale, atëherë ofertat marxhinale të barabarta do të shoqërohen nga një garanci bankare nga një bankë me reputacion ndërkombëtar të miratuar nga TAP-i në diskrecionin e tij absolut, i cili plotëson të njëjtat kritere të përcaktuara në paragrafin E.1.

Ofertat marxhinale të barabarta vlerësohen nga OST-ja e përfshira brenda 5 ditë pune nga afati për paraqitjen e ofertave marxhinale të barabarta. Në rast kundërshtimi të formularit të ofertës detyruese marxhinale të barabartë (EMB Binding Bid Form), OST-ja duhet të njoftojnë ofertuesin respektiv brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit për paraqitjen e ofertave marxhinale të barabarta. Ofertat e pranuar merren në konsideratë gjatë procedurës paraprake për ndarjen e kapacitetit të kryer në përputhje me paragrafin E.4 të propozimit të projektit.

Sipas këtij hapi, OST-ja e përfshira duhet të llogarisin vlerën aktuale neto (NPV) për të gjitha ofertat e paraqitura (me qëllim, që të merret në konsideratë çmimi i ankandit) dhe renditja e të gjitha ofertave sipas vlerës aktuale neto (NPV)/raportit të kapaciteti si përmendur më sipër. Nëse ndodh përsëritja e kapacitetit, kapaciteti alokohet për pjesëmarrësit me NPV më të lartë / raport i kapacitetit. Pjesëmarrësi/ pjesëmarrësit të cilët kanë paraqitur oferta marxhinale u alokohet



kapaciteti i mbetur, duke siguruar që çdo pjesëmarrës që merr kapacitet më pak nga sa kërkohet mund të tërhiqet, nëse oferta detyruese e tyre specifikon që reduktimi/kufizimi nuk pranohet.

E.6 Testi i qëndrueshmërisë ekonomike

Testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) kryhet në mënyrë të pavarur nga çdo OST në anët e tyre të pikës së interkonjeksionit.

Për TAP-in, testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) merr parasysh vlerën aktuale neto të vlerësimit të kostos dhe rritjen hipotetike të të ardhurave, duke aplikuar normat e synuara të brendshme të kthimit (IRR) për TAP-in duke qenë që faktori zbritës (shikoni Kodin e Tarifave të TAP/shtojca 1 për më shumë detaje). Për të shmangur dyshimet, testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) ka të bëjë me anët e TAP-it të të gjitha pikave të interkonjeksionit ku ofrohet shtesë kapaciteti. Kostot përfshijnë të gjitha kostot që shkaktohen nga TAP-i që zgjerimi i gazjellësit të pajtohet me nivelin e ofertës. Prandaj të ardhurat për llogaritjen e vlerës aktuale neto që lidhet me të ardhurat shtesë që do të mblidhen nga TAP-i nga aplikimi i tarifës së TAP-it për të gjithë kapacitetin shtesë që do të ndahet tek ana e TAP për të gjitha pikat e interkonjeksionit.

Kini parasysh që TAP-i ka të drejtën të ndajë kapacitetin e kërkuar në këto oferta detyruese dhe ta ofrojë kapacitetin me faza, dhe nëse ndodh kjo e lejon TAP-in të ofrojë një pjesë të kapacitetit që kërkohet nga pjesëmarrësit tek ofertat detyruese në një fazë të hershme. Kjo nënkupton që shumë E-CODE mund të ndodhin brenda të njëjtit projekt zgjerimi. Kjo mënyrë do të shmangë që pjesëmarrësve t'u kërkohet të presin derisa TAP-i të mund të akomodojë sasinë e plotë të kapacitetit të kërkuar nga ky pjesëmarrës. Një shpërndarje e tillë e kapaciteteve në faza mund të kërkojë një zhvillim më kompleks të projektit dhe çdo kosto do të përfshihet në përditësimin përfundimtar të tarifave.

Pragjet/kufijtë e kapacitetit të ofruara për pikën e hyrjes në Kipoi dhe pikën e daljes në Melendugno llogariten sipas simulimeve të rrjedhës, duke supozuar që të gjitha detyrimet afatshkurtra, dhe rezervimet e reja afat-gjata mund të përmbushen duke përdorur gjatësinë e plotë të Gazsjellësit TAP. Duke pasur parasysh numrin e madh të kombinimeve të mundshme të pikave të

hyrjes dhe daljes tek TAP-i, mund të nevojiten simulime hidraulike për të vendosur se cila zgjidhje zgjerimi kërkohet për të vendosur disa oferta të caktuara. Për më tej, kini parasysh që zgjidhjet teknike për TAP-in mund të përshtaten që të akomodojnë këto kombinime ofertash.

TAP-i do të pranojë ofertat për kapacitet për periudha të veçanta, por edhe për periudha më të vogla se 3 vjet radhazi (**“Kërkesa vjetore”**). Megjithatë, çdo kërkesë vjetore sipas Kodit të Tarifave të TAP-it nuk do të trajtohet si rezervim për zgjerim kapaciteti dhe nuk do të merret parasysh nga testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) që të kryhet sipas paragrafit E.6. Megjithatë nëse kërkohet për të kaluar testin e qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) dhe sipas gjykimit të vetëm të TAP-it, që këto rezervime të mund të përfshihen tek EVT dhe të merren parasysh më tej për alokimin e kapacitetit dhe Kodin e Tarifave të TAP-it. Në këtë rast këto rezervime nuk do të konsiderohen si kërkesa vjetore.

Kërkesat vjetore do të alokojnë kapacitet vetëm me përfundimin e EVT-së dhe nënshkrimin e GTA-së me pjesëmarrës të suksesshëm për zgjerim kapaciteti. Kërkesat vjetore do t'u caktohet kapacitet në masën që ka kapacitet të mbetur në dispozicion për vitin përkatës deri në nivelin e ofertës që do të zbatohet si pjesë e projektit për rritjen e kapacitetit. Nëse TAP-i nuk është në gjendje që të alokojë kapacitet për të gjitha kërkesat vjetore gjatë një viti të veçantë, ai do të alokojë kapacitet sipas procedurës së ngjashme të vendosjes së prioritetit në paragrafin E.5.

Për SRG-në, testi i qëndrueshmërisë ekonomike merr parasysh vlerën aktuale të rritjes së parashikuar me të ardhurat e lejuara shumëzuar me faktorin – f (shikoni paragrafin G.1) të miratuar nga Rregullatori Italian ARERA dhe vlerën aktuale të angazhimeve detyruese të pjesëmarrësve për të kontraktuar kapacitet, e cila llogaritet si shuma që u zbritet çmimeve përkatëse të referencës dhe një çmimi minimal i mundshëm i detyrueshëm shumëzuar me shumën e kapacitetit rritës të kontraktuar sipas nenit 22 të Kodit të Rrjetit të Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit të BE-së.

Për DESFA-në, testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) merr në konsideratë vlerën aktuale të rritjes që parashikohet tek të ardhurat e saj të lejuara shumëzuar me faktorin – f (shikoni



paragrafin G.2) miratuar nga Rregullatori Grek RAE dhe vlerën aktuale të angazhimeve detyruese të pjesëmarrësve për të kontraktuar kapacitet, e cila llogaritet si një shumë që u zbritet çmimeve respektive të referencës dhe çmimin minimal të detyrueshëm të mundshëm shumëzuar me sasinë e kapacitetit shtesë të kontraktuar sipas nenit 22 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së.

OST-të të cilat do të kryejnë testin e qëndrueshmërisë ekonomike duhet të ndjekin rezultatet e mëposhtme:

- TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja secila do të verifikojnë testin e qëndrueshmërisë ekonomike me nivelin më të ulët të ofertës, e cila pajtohet me shumën maksimale të ofertave detyruese për çdo pikë interkonjeksioni. Nëse rezulton pozitive për të gjitha OST-të e përfshira, kapaciteti alokohet sipas renditjes së ofertës.

Nëse EVT rezulton negative për një nga OST e përfshirë, ofertat detyruese kufizohen dhe testohet niveli më i ulët i ofertës për pikat e interkonjeksionit të përfshira. Kufizimi i ofertave të lidhura mund të ndikojë te niveli i ofertës që do të testohet te pika tjetër e interkonjeksionit. Nëse OST-ja kufizon ose kundërshton ofertat detyruese te pikat e interkonjeksionit, ku kapaciteti është vendosur në dispozicion si kapacitet i lidhur, oferta detyruese e lidhur e bërë për OST-në tjetër të përfshirë do të kufizohet ose kundërshtohet në të njëjtën masë.

- Procesi vazhdon derisa të gjendet një kombinim i niveleve të ofertave që japin EVT pozitive për OST-të e përfshira. Procesi i ankandit sipas paragrafit E.5 mund të duhet të kryhet para përfundimit të alokimit të kapacitetit të zgjerimit te një nivel i dhënë ofertash. Nëse pas kufizimit sipas pikës B, ofertat e pikës së interkonjeksionit përsëri japin një EVT negative për një OST, procesi vazhdon pa ato oferta dhe EVT për atë OST konsiderohet negativ. Në atë rast nuk do të ketë alokim të kapacitetit te pika e interkonjeksionit.

- Nëse EVT rezulton negative tek të gjitha nivelet e ofertave:

- a) Sipas paragrafit 3.3.1(d) të Kodit të Tarifave të TAP-it (tashmë të miratuar nga autoritetet) në rastin e një EVT negative, TAP-i ka të drejtën që të investigojë më tej nëse ka një zgjidhje teknike e cila pajtohet me një pjesë të kërkesave që mund të çojë në një vlerë aktuale neto (NPV) pozitive dhe

përpyqje të arsyeshme që bazohen te diskutimi me pjesëmarrësit që nga faza detyruese për ndryshime të mundshme në të ardhmen për rezervimet përkatëse ose zgjidhje komerciale të cilat mund të çojnë në një vlerë aktuale neto pozitive.

- b) Sipas nenit 24.4 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit (CAM NC) nëse rishpërndarja e të ardhurave mund të çojë në ulje të nivelit të angazhimeve detyruese të përdoruesve të rrjetit për të kontraktuar kapacitet, kërkon një rezultat pozitiv të testit ekonomik, OST-të mund t'u paraqesin autoriteteve rregullatore përkatëse për miratim të koordinuar, mekanizmat për rishpërndarjen e të ardhurave nga kapaciteti në rritje.

- c) Vetëm kur pasi të kini rishikuar pragun e zgjerimit dhe ofertat, dhe EVT vazhdon të jetë negative, OST-të e përfshira duhet të informojnë menjëherë autoritetet përkatëse për këtë rezultat. ofertat detyruese nga pjesëmarrësit duhet të jenë të vlefshme derisa autoritetet të kenë përfunduar ose të kenë hequr dorë, verifikim i palëve të treta përkrahur në nenin 4.1.8 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët. TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja do të informojnë pjesëmarrësit për përfundimin e Projektit për Rritje Kapaciteti.

TAP-i, SNAM-i dhe DESFA-ja do t'u komunikojnë së bashku rezultatet e EVT-së, të fazës së parë detyruese të ofertave për pjesëmarrësit përkatës jo më vonë se data 30 janar 2023, në rastin e TAP – sipas – dispozitave të paragrafit 3.3.1(d) të Kodit të Tarifave të TAP-it (të miratuar nga autoritetet) në rastin e një EVT negative.

E.7 Marrëveshja e transportit të gazit (“GTA”)

Çdo pjesëmarrësi të suksesshëm do t'i kërkohej të nënshkruajë Marrëveshjen e Transportit të Gazit (GTA) me OST-në përkatëse në përputhje me kuadrin rregullator përkatës të zbatueshëm në lidhje me kapacitetin e alokuar, siç detajohet më poshtë.

Përveç kërkesave specifike të OST të përcaktuara më poshtë, OST kanë përcaktuar një sërë afatesh kohore dhe parimesh në procesin e Marrëveshjes së Transportit të Gazit (GTA) – të cilat kanë të bëjnë me:

- Nënshkrimin ose firmosjen e Marrëveshjeve përkatëse të Transportit të Gazit (GTA) deri në datën 15 shkurt 2023;

- Marrëveshjet e Transportit të Gazit (GTA)



hyjnë në fuqi pas plotësimit të një sërë kushtesh paraprake, të cilat do të plotësojnë nevojat e secilës OST;

- Me mbylljen e projektit për rritje kapaciteti dhe shpalljen e pavlefshme të Marrëveshjeve të Transportit të Gazit (GTA), nëse kushtet paraprake nuk plotësohen ose OST-të përkatëse heqin dorë nga to, deri në datën 31 dhjetor 2023.

Detaje të mëtejshme, duke reflektuar ligjin në fuqi dhe specifikat komerciale janë dhënë, në lidhje me secilën OST më poshtë.

TAP

Pas një rezultati pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) dhe pas sigurimit të alokimit të kapacitetit, **TAP-i, do të:**

a) vazhdojë projektimin e zgjidhjeve teknike të cilat ofrojnë kapacitetin e nivelit të përzgjedhur të ofertës dhe do të lejojnë TAP-it të vlerësojë programin dhe kostot për zgjidhjet specifike të zgjerimit me një shkallë më të lartë saktësie;³³

b) kërkojë lejet kryesore të domosdoshme për punimet e zgjerimit në shtetet pritëse;

c) kërkojë financim të palëve të treta për punimet e zgjerimit, nëse aplikohet;

d) nënshkruajë marrëveshjet e transportit të gazit (GTA) të cilat çojnë në një EVT pozitive jo më vonë se data 15 shkurt 2023. Secila marrëveshje e transportit të gazit (GTA) do të hyjë në fuqi pas plotësimit të një sërë kushtesh paraprake të vendosura sipas nevojave të TAP-it ose të hequra nga TAP-i. Këto kushte paraprake përfshijnë:

i. janë marrë vlerësimet mbi kostot dhe planifikim i punimeve paraprake inxhinierike dhe të Projektimit (FEED), së bashku me lejet kryesore të kërkuara.

ii. duke qenë që TAP-i është njoftuar nga OST-ja fqinje që në lidhje me çdo kapacitet të lidhur, rezervimi përkatës i pjesëmarrësit të sistemi i OST-së fqinje i TAP-it është i pakushtëzuar dhe Pjesëmarrësi përkatës që ka paraqitur mbështetje të pranueshme krediti si kërkohet sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit (GTA); dhe

iii. vlerësimet e përditësuara, të detajuara të kostos të gjeneruara nga FEED, data e rishuar, e përlogaritur për vendosjen në funksion (REOD) dhe kapaciteti që (herë pas here) alokohet në gazsjellësin TAP akoma japin një EVT pozitive.

Nëse informacioni i rishikuar do të çonte në një EVT negative, TAP-i do të diskutojë me pjesëmarrësit mundësinë për të zgatur afatin e rezervimeve sipas ofertës (ofertave) deri në një datë të vonë në përfundim të përjashtimit të TAP-it.

e) Me ose përpara nënshkrimit të GTA-së nga TAP-i, çdo pjesëmarrës të cilit i është ndarë/alokuar kapacitet të projekti i zgjerimit sipas vlerës së garancisë pas ofertës (**vlera e njoftuar**) që pjesëmarrësi duhet të ofrojë, kjo e llogaritur sipas dispozitave më poshtë (shikoni paragrafin me titull “Përlogaritja e vlerës së njoftuar” më poshtë). Përveç vlerës së njoftuar, pjesëmarrësit duhet t'i ofrohet informacioni i mëposhtëm:

i. kapacitetin që i është alokuar pjesëmarrësit nga TAP-i;

ii. kapaciteti i përgjithshëm /total i alokuar nga TAP-i;

iii. nëse kapaciteti do të vendoset në dispozicion të pjesëmarrësit si pjesë e “Zgjerimit minimal”, “Zgjerimit të kufizuar”, “Zgjerimit pjesor” ose “Zgjerimit të plotë”.

Jo më vonë se data 28 shkurt 2023, pjesëmarrësit duhet të japin një garanci bankare në shumën e njëjtë me vlerën e njoftuar dhe me një datë skadimi jo më herët se 29 shkurt 2024 (**garancia pas ofertës**) nga një bankë e njohur ndërkombëtare me një vlerësim minimal kredie BBB sipas Standard and Poor ose Baa3 sipas Moody's, ose që është nxjerrë nga çdo institut financiar grek në mbikëqyrje të ECB (banka në sistem, përkatësisht çdo Alpha Bank, Eurobank, Banka Kombëtare e Greqisë dhe Pireus Bank), të cilat janë miratuar paraprakisht nga TAP-i me konfidencialitet absolut.

Garancia pas ofertës ofrohet si një siguri në lidhje me detyrimet e pjesëmarrësit sipas dhe në lidhje me këtë propozimprojekti dhe GTA. TAP-it, sipas **limitit të përfundimit (Termination Cap)** të vendosur më poshtë, do t'i caktohet të bëjë një kërkesë sipas garancisë pas ofertës në çdo kohë për çdo shumë deri te sasia totale në dispozicion për kërkesën sipas garancisë pas ofertës, nëse:

i. në çdo kohë, që vlerësimi i kredisë së bankës që ofron garancinë pas ofertës, e cila nuk përmbush kërkesat e vendosura më sipër (përfshirë në lidhje me vlerësimin minimal të kredisë) ose nëse garancia pas ofertës përfundon para datës 29 shkurt 2024 dhe nuk rinovohet garancia pas ofertës (si pasojë, në të njëjtën formë si te garancia pas

³³ Kini parasysh që studimi FEED mund të fillonte përpara përfundimit të EVT-së, në konfidencialitet të TAP-it.



ofertës ajo zëvendëson dhe plotëson kërkesat e vendosura më sipër) është dhënë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para përfundimit të garancisë pas ofertës; ose

ii. pjesëmarrësi nuk bën pagesën e pjesës së tij të kostove të ndërprerjes që lidhen me përfundimin dhe/ose joefektivitetin e GTA-së së tij (shih më shumë detaje më poshtë).

Nëse garancia pas ofertës quhet kështu vetëm në lidhje me rrethanat e vendosura në pikën (i) më sipër dhe nëse në konfidencialitet të TAP-it, këto rrethana janë rregulluar si duhet me anë të lëshimit të garancisë të re pas ofertës, ose me zbatimin e angazhimeve të tjera që përmbushen nga TAP-i, TAP-i do t'i ripaguajë pjesëmarrësit këto pagesa, nëse ka të tilla, të marra nga TAP-i sipas garancisë pas ofertës për shkak të rrethanave të vendosura në pikën "i" në atë shkallë që këto shuma të mos shfrytëzohen nga TAP-i sipas propozimit të projektit.

Garancia pas ofertës që i ishte ofruar TAP-it nga çdo pjesëmarrës do t'i rikthehet secilit pjesëmarrës nga TAP-i:

- Kur GTA-ja e pjesëmarrësit të jetë plotësisht efektive në përputhje me termet e saj; ose

- Nëse GTA-ja e pjesëmarrësit ndërpritet, duke ofruar që kjo garanci pas ofertës do t'i rikthehet vetëm kur të përmbushen dhe shlyhen të gjitha detyrimet e pjesëmarrësit në lidhje me ndërprerjen (shikoni më poshtë).

Pavarësisht nga sa më sipër, TAP-i mundet sipas konfidencialitetit të tij (dhe në masën e rënë dakord paraprakisht me TAP-in) të pranojë një formë alternative të mbështetjes kreditore të pranueshme për të në vend të një garancie bankare. Nëse ofrohet një mbështetje e tillë alternative kreditore, ajo duhet të sigurohet e tillë që të mund të përdoret nga TAP-i në rrethanat në të cilat TAP-i do të lejohej të kontaktonte garancinë bankare. Të gjitha të drejtat, mjetet juridike dhe të drejtat e TAP-it në lidhje me garancitë bankare (siç përcaktohet në këtë projektpropozim) do të zbatohen në mënyrë të barabartë për këtë formë alternative të mbështetjes kreditore.

Përlllogaritja e vlerës së njoftuar

Vlera e njoftuar për garancitë pas ofertës (*Post-Bid Guarantee*) përlllogaritet sipas parimit të TAP-it duke qenë në gjendje që në të gjitha rastet të mbulojë kostot e ndërprerjes, dhe si rezultat i Marrëveshjes së Transportit të Gazit (GTA) që ka

përfunduar sipas afateve të saj dhe që TAP-i nuk mund ta rikuperojë si pjesë e një projekti në vazhdim të zgjerimit ose projekti të reduktuar të zgjerimit. Si rezultat, ajo vetëm mund të llogaritet dhe të njoftohet nga TAP-i pas një EVT pozitive dhe pasi të ketë ndodhur alokimi i kapacitetit duke qenë që këto kosto varen nëse TAP-i zbaton projektin minimal të zgjerimit, projektin e kufizuar të zgjerimit, projektin pjesor të zgjerimit ose projektin e plotë të zgjerimit (shikoni paragrafin A2.1 më sipër), si dhe përbërjen e ofertave detyruese që u është alokuar kapacitet si pjesë e këtij projekti të zgjerimit.

Për të përlllogaritur këtë vlerë të njoftuar për të ofruar garancinë pas ofertës, TAP-i do të përdorë shifrat më poshtë (çdo vlerësim të koston së ndërprerjes ose **TCE**):

- Nëse zbatohet **Projekti Minimal i Zgjerimit**, vlerësimi i koston së ndërprerjes do të jetë **51 M EURO**;

- Nëse zbatohet **Projekti i Kufizuar i Zgjerimit**, vlerësimi i koston së ndërprerjes do të jetë **96 MEUR**;

- Nëse zbatohet **Projekti Pjesor i Zgjerimit**, vlerësimi i koston së ndërprerjes do të jetë **107 MEUR**;

- Nëse zbatohet **Projekti i Plotë i Zgjerimit**, vlerësimi i koston së ndërprerjes do të jetë **119 MEUR**.

Vlera e njoftuar do të llogaritet si më e madhe nga:

- Pjesa proporcionale e pjesëmarrësit (që do të thotë kapaciteti maksimal i alokuar për pjesëmarrësin pjesëtuar me kapacitetin total të alokuar në fazën përkatëse të detyrueshme) të vlerësimit të koston së ndërprerjes që zbatohet.

- Diferenca midis: A) vlerësimit të koston së ndërprerjes të zbatueshme për nivelin e projektit të zgjerimit të zgjedhur nga TAP-i pas EVT fillestare pozitive; dhe B) vlerësimit të koston së ndërprerjes të zbatueshëm për nivelin maksimal të projektit të zgjerimit në lidhje me të cilin TAP-i do të jetë në gjendje të marrë një EVT pozitive nëse pjesëmarrësi përkatës do të dilte nga projekti i zgjerimit.

Ndërprerja e GTA-së

- a) Nëse kushtet paraprake nuk plotësohen ose shfuqizohen sipas afateve të konfirmimit të transportit dhe afateve të përcaktuara deri me tani, TAP-i mund, në ose përpara datës 31 dhjetorit



2023, të ndërpresë GTA-të (në çdo rast, në përputhje me kushtet e GTA-së) dhe/ose të mbyllë Projektin e Rritjes së Kapacitetit.

b) Nëse pjesëmarrësi nuk jep një garanci pas ofertës të Bankës në datën ose përpara datës 28 shkurt 2023, TAP-i do të ketë të drejtën të ndërpresë GTA-në menjëherë.

c) Nëse data e fillimit (siç përcaktohet te konfirmimi i transportit) nuk ka ndodhur deri në datën që i përkon tridhjetë e gjashtë (36) muaj pas REOD, atëherë secila palë mund të ndërpresë GTA menjëherë.

d) Pjesëmarrësi mund të ndërpresë GTA-në deri më 30 nëntor 2023; ose:

i. si një option të tij; ose

ii. në rastin kur REOD vonohet nga data e planifikuar për të filluar:

1. Më shumë se 3 muaj (nëse kapaciteti i pjesëmarrësit alokohet si pjesë e projektit minimal të zgjerimit ose projektit të limituar të zgjerimit); ose

2. Më shumë se 6 muaj (nëse kapaciteti i pjesëmarrësit alokohet si pjesë e projektit pjesor të zgjerimit ose projektit të plotë të zgjerimit).³⁴

Pasojat e tërheqjes së ofertës ose ndërprerja e Marrëveshjes së Transportit të Gazit (GTA)

Pjesëmarrësit duhet të kenë parasysh se kostot e ndërprerjes në lidhje me ndërprerjen e projektit të zgjerimit që kanë kaluar një EVT do të jenë (sipas, nëse është e përshtatshme limitit të ndërprerjes) të rikuperueshme nga pjesëmarrësi siç përcaktohet në paragrafët e mëposhtëm. Nëse ka kosto të ndërprerjes të cilat TAP-i nuk është në gjendje t'i rikuperojë nga pjesëmarrësit ose t'i përfshijë brenda një niveli më të ulët të projektit të zgjerimit, TAP-i do të përfshijë këto kosto të ndërprerjes brenda bazës së kostos eventuale tarifore të përdorur për përlogaritjen e EVT-së për fazat e ardhshme detyruese.

A. Tërheqja e ofertave detyruese para se TAP-i të nënshkruajë GTA-në ose ndërprerja e GTA-ësë, pasi TAP-i nënshkruan GTA-në, por para se pjesëmarrësi të japë garancinë pas ofertës

Paragrafi (A) aplikohet:

I. në rastin kur pjesëmarrësi tërheq, shfuqizon ose kundërshton ofertën detyruese **para** plotësimi

të kapacitetit të alokimit dhe/ose nënshkrimit të GTA nga TAP-i; ose

II. pasi TAP-i nënshkruan GTA por para dispozitave të garancisë pas ofertës, nëse pjesëmarrësi ndërpret GTA me dëshirën e tij ose nuk ofron garancinë pas ofertës në datën ose përpara datës 28 shkurt 2023 dhe TAP-i ushtron të drejtën e saj për të ndërprerë GTA.

- TAP-i, fillimisht do të rikryejë EVT-në, duke përjashtuar ofertën detyruese të pjesëmarrësit ose kapacitetin e alokuar për të.

- Nëse EVT-ja e përsëritur është negative, TAP-i mund të zhvillojë diskutime me pjesëmarrësit e mbetur nëse mund të bëhet ndonjë rregullim tek ofertat e tyre detyruese ose te kapaciteti i alokuar në mënyrë që të kthejë EVT pozitive për projektin e zgjerimit.

- Në rastin kur TAP-i arrin në përfundimin (duke vepruar me konfidencialitet):

1. Që pavarësisht çdo diskutimi që mund të ketë zhvilluar me pjesëmarrësit e mbetur, EVT e përsëritur mbetet negative dhe/ose TAP-i mbyll projektin për rritjen e kapacitetit, pjesëmarrësi i tërhequr do të jetë përgjegjës për kostot e ndërprerjes si rezultat i kësaj ndërprerje ose tërheqjeje, me kusht që një detyrim i tillë të mos kalojë kufirin e garancisë së ofertës së pjesëmarrësit që tërhiqet. TAP-i ka të drejtë të kërkojë shumën të tillë sipas garancisë së ofertës nëse këto shumë nuk paguhet nga pjesëmarrësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i. Në rast se kostot përkatëse të ndërprerjes tejkalojnë kufirin e garancisë së ofertës së pjesëmarrësit, TAP-i do të ketë të drejtë të kërkojë nga secili pjesëmarrës i mbetur (deri në kufirin e garancisë së ofertës së çdo pjesëmarrësi të mbetur) një pjesë proporcionale të pjesës së mbetur të kostove të ndërprerjes. Llogaritja në përpjesëtim me kapacitetin shtesë vjetor maksimal të secilit pjesëmarrës si pjesë e kapacitetit total maksimal vjetor shtesë të alokuar si pjesë e Projektit të Zgjerimit.

2. Që kjo përsëritje e EVT të jetë pozitive për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit:

i. pjesëmarrësi që ka ndërprerë ose tërhequr duhet të jetë i detyruar (që deri në limitin e garancisë së ofertës) për kostot e ndërprerjes, që si rezultat i kësaj ndërprerje ose tërheqjeje, TAP-i vendos (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje të rikuperojë si pjesë e këtij niveli

³⁴ Kuptohet që pjesëmarrësve do t'u lejohet periudha minimale për të ushtruar mundësinë e tyre për t'u tërhequr nëse aplikohet.



reduktimi të Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtën që të ankimojë këto shuma deri në një shumë që është në dispozicion sipas garancisë së ofertës në rastin kur këto shuma nuk paguhën nga pjesëmarrësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i. Në rast se kostot përkatëse të ndërprerjes tejkalojnë kufirin e garancisë së ofertës së pjesëmarrësit, duke qenë që EVT mbetet pozitive kur llogaritet kjo pjesë e mbetur e kostove të ndërprerjes, këto kosto do të mbeten brenda bazës së kostos të Projektit të Zgjerimit.

ii. Nëse, në çdo kohë të kësaj ndërprerje, vlera e njoftuar që kërkohet të ofrohet nga pjesëmarrësit si garanci bankare pas ofertës është njoftuar nga TAP-i për pjesëmarrësit:

a) TAP-i mund të njoftojë pjesëmarrësit e mbetur për një vlerë të rishikuar të njoftuar, në mënyrë që të reflektojë uljen e nivelit të Projektit të Zgjerimit që po ndiqet.

b) Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit e mbetur zgjedhin që të mos ofrojnë një garanci pas ofertës në shumën e barabartë me vlerën e rishikuar të njoftuar, GTA mund të ndërpritet ose nga TAP-i ose nga pjesëmarrësi brenda 15 ditë pas njoftimit nga TAP-i të ndërprerjes së pjesëmarrësve fillestare. Nëse kryhet kjo dhe EVT përsëri mbetet pozitive, për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit, të gjithë pjesëmarrësit ekzistues (përfshirë pjesëmarrësin që ka kryer i pari ndërprerjen) duhet të paguajnë një pjesë proporcionale të kostove të ndërprerjes, që si rezultat i ndërprerjes, TAP-i vendos (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje të mbulojë si pjesë e nivelit të reduktuar të Projektit të Zgjerimit. Nëse si pasojë e ndërprerjes përcaktohet nga TAP-i që EVT-ja të jetë negative, pasojat e vendosura në pikën 1 më sipër duhet të aplikohen nga të gjithë Pjesëmarrësit.

c) Nëse si rezultat i një ndërprerje të tillë vendoset nga TAP-i që EVT-ja të jetë negative, pasojat e vendosura në pikën 1 më sipër do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit.

3. Që përsëritja e EVT-së të jetë pozitive për të njëjtin nivel të Projektit të Zgjerimit, pjesëmarrësi ekzistues nuk duhet të ketë me detyrime tek TAP-i, dhe të gjitha kostot e shkaktuara nga TAP-i si pjesë e Projektit të Rritjes së Kapacitetit do të mbeten kosto bazë. Megjithatë, nëse në kohën e këtij ndryshimi TAP ka njoftuar pjesëmarrësin

(pjesëmarrësit) e mbetur për vlerën e njoftuar të garancisë pas ofertës së bankës, atëherë të gjithë pjesëmarrësve të mbetur do t'u kërkohet të ofrojnë një garanci (garancitë) bankare pas ofertës të barabarta në vlerë me vlerën e rishikuar të njoftuar (që i është njoftuar pjesëmarrësit (pjesëmarrësve) nga TAP-i), për të reflektuar pjesën përpjesëtimore të rishikuar të secilit pjesëmarrës të vlerësimit të kostove të ndërprerjes që aplikohen për shkak të ndërprerjes fillestare.

B. Ndërprerja e GTA-së, pasi pjesëmarrësi ka ofruar garancinë pas ofertës por para datës 31 dhjetor 2023

B1. Nëse pasi pjesëmarrësi ka ofruar garancinë pas ofertës:

I. Pjesëmarrësi ndërpret GTA me dëshirën e tij; ose

II. TAP-i ndërpret GTA sepse pjesëmarrësi nuk ofron mbështetjen e kreditit të GTA-së brenda afatit që aplikohet nga GTA-ja.

Fillimisht TAP-i do të përsëritë EVT, duke përjashtuar kapacitetin e alokuar të këtyre pjesëmarrësve.

Nëse EVT e përsëritur është negative, TAP-i mund të zhvillojë diskutime me pjesëmarrësit e mbetur nëse mund të bëhet ndonjë rregullim në kapacitetin e tyre të alokuar në mënyrë që të mbajë një EVT pozitive për Projektin e Zgjerimit. Në rast se TAP-i arrin në përfundimin (duke vepruar në konfidencialitet të plotë):

1. Që pavarësisht çdo diskutimi që mund të ketë zhvilluar me pjesëmarrësit e mbetur, EVT-ja e përsëritur mbetet negative dhe/ose TAP-i mbyll Projektin për Rritje Kapaciteti, pjesëmarrësi i tërhequr do të jetë përgjegjës për kostot e ndërprerjes. Në rast se kostot përkatëse të ndërprerjes tejkalojnë kufirin e garancisë së ofertës së pjesëmarrësit, TAP-i do të ketë të drejtë të kërkojë nga secili pjesëmarrës i mbetur (deri në kufirin e garancisë së ofertës së çdo pjesëmarrësi të mbetur) një pjesë proporcionale të pjesës së mbetur të kostove të ndërprerjes, llogaritur në përpjesëtim me kapacitetin shtesë vjetor maksimal të secilit pjesëmarrës si pjesë e kapacitetit total maksimal vjetor shtesë të alokuar si pjesë e Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtë të kërkojë shuma të tilla sipas garancisë pas ofertës nëse këto shuma nuk paguhën nga pjesëmarrësi përkatës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i.



2. Që kjo përsëritje e EVT është pozitive për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit:

i. pjesëmarrësi përkatës është i detyruar (deri në limitin e ndërprerjes) për kostot e ndërprerjes që si pasojë e kësaj ndërprerje, TAP-i vendos (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje të rikuperojë si pjesë e këtij niveli reduktimi të Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtën që t'i ankimojë këto shuma deri në një shumë që është në dispozicion sipas garancisë së ofertës në rastin kur këto shuma nuk paguhen nga pjesëmarrësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i;

ii. garancitë pas ofertës të Pjesëmarrësve të mbetur do të ridimensionohen për të pasqyruar reduktimin e nivelit të Projektit të Zgjerimit që po ndiqet;

iii. nëse ndonjë nga pjesëmarrësit e mbetur zgjedhin që të mos ofrojnë një garanci pas ofertës të ridimensionuar, GTA-ja mund të ndërpritet ose nga TAP-i ose nga pjesëmarrësi brenda 15 ditë pas njoftimit nga TAP-i të ndërprerjes nga pjesëmarrësi fillestar. Nëse kryhet kjo dhe EVT-ja përsëri mbetet pozitive, për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit, të gjithë pjesëmarrësit ekzistues (përfshirë pjesëmarrësin që ka kryer i pari ndërprerjen) duhet të paguajnë një pjesë proporcionale të kostove të ndërprerjes, që si rezultat i ndërprerjes, TAP-i vendos (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje të mbulojë si pjesë e nivelit të reduktuar të Projektit të Zgjerimit. Nëse si pasojë e kësaj ndërprerje tjetër EVT përfundimisht përcaktohet nga TAP-i që të jetë negative, të gjithë pjesëmarrësit ekzistues/ata që kanë kryer ndërprerjen (përfshirë pjesëmarrësit që kanë kryer ndërprerjen në fillim) duhet të paguajnë pjesën e përpjesëtuar të kostove të ndërprerjes, deri te limiti i ndërprerjes (**Termination Cap**). Nëse ndonjë limit i ndërprerjes, pjesë e kostove respektive të ndërprerjes tejkalon limitet e ndërprerjes të pjesëmarrësve ekzistues, TAP-i ka të drejtën që të kërkojë nga çdo pjesëmarrës i mbetur (deri në limitin e ndërprerjes të çdo pjesëmarrësi të mbetur) një pjesë përpjesëtimore të pjesës së mbetur të kostove të ndërprerjes.

3. Që përsëritja e EVT-së të jetë pozitive për të njëjtin nivel të Projektit të Zgjerimit, pjesëmarrësi ekzistues nuk duhet të ketë me detyrime tek TAP-i, dhe të gjitha kostot e shkaktuara nga TAP si pjesë e

Projektit të Rritjes së Kapacitetit do të mbeten kosto bazë. Të gjithë pjesëmarrësve të mbetur do t'u kërkohej të ofrojnë një garanci (garancitë) të rishikuar bankare pas ofertës të barabarta në vlerë me vlerën e rishikuar të njoftuar (që i është njoftuar pjesëmarrësit (pjesëmarrësve) nga TAP-i), për të reflektuar pjesën përpjesëtimore të rishikuar të secilit pjesëmarrës të vlerësimit të kostove të ndërprerjes që aplikohen për shkak të ndërprerjes fillestare.

B2. Nëse një ose më shumë pjesëmarrës ndërpresin GTA sipas njoftimit të REOD-së, sipas kushteve të GTA-së, TAP-i fillimisht duhet të përsëritë EVT-në, me rezervimet në dispozicion për alokimin e kapacitetit, në periudhën e kësaj ndërprerje.

Nëse EVT-ja e përsëritur është negative, TAP-i mund të zhvillojë diskutime me pjesëmarrësit e mbetur nëse mund të bëhet ndonjë rregullim në kapacitetin e tyre të alokuar në mënyrë që të mbajë një EVT pozitive për Projektin e Zgjerimit.

Në rast se TAP-i arrin në përfundimin (duke vepruar në konfidencialitet të plotë):

që pavarësisht çdo diskutimi që mund të ketë zhvilluar me pjesëmarrësit e mbetur, EVT-ja e përsëritur mbetet negative dhe TAP-i mbyll Projektin për Rritje Kapaciteti, çdo pjesëmarrës do të jetë përgjegjës deri te limiti i ndërprerjes, për një pjesë proporcionale të kostove të ndërprerjes së TAP, që përlogariten në përpjesëtim me rritjen maksimale vjetore të kapacitetit të alokuar si pjesë e Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtë të kërkojë shuma të tilla sipas garancisë pas ofertës të pjesëmarrësit nëse këto shuma nuk paguhen nga pjesëmarrësi përkatës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i.

1. Që kjo përsëritje e EVT-së është pozitive për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit:

i. çdo pjesëmarrës (përfshirë pjesëmarrësin ekzistues) është i detyruar deri në kufirin përkatës të ndërprerjes, për një pjesë përpjesëtimore të kostove të ndërprerjes që si rezultat i kësaj ndërprerje, TAP-i vendos në (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje t'i përballojë si pjesë e nivelit të reduktuar të Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtën që t'i kërkojë këto shuma deri në një shumë që është në dispozicion sipas garancisë pas ofertës në rastin kur këto shuma nuk paguhen nga pjesëmarrësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i;



ii. garancitë pas ofertës të pjesëmarrësve të mbetur do të ridimensionohen për të pasqyruar reduktimin e nivelit të Projektit të Zgjerimit që po ndiqet;

iii. nëse ndonjë nga pjesëmarrësit e mbetur zgjedhin që të mos ofrojnë një garanci pas ofertës të ridimensionuar, GTA-ja mund të ndërpritet ose nga TAP-i ose nga pjesëmarrësi brenda 15 ditë pas njoftimit nga TAP-i të ndërprerjes nga pjesëmarrësi fillestar. Nëse kryhet kjo dhe EVT-ja përsëri mbetet pozitive, për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit, të gjithë pjesëmarrësit ekzistues (përfshirë pjesëmarrësin që ka kryer i pari ndërprerjen) duhet të paguajnë një pjesë proporcionale të kostove të ndërprerjes, që si rezultat i ndërprerjes, TAP-i vendos (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje të mbulojë si pjesë e nivelit të reduktuar të Projektit të Zgjerimit. Nëse si pasojë e kësaj ndërprerjeje tjetër, EVT-ja, përfundimisht përcaktohet nga TAP-i që të jetë negative, për të gjithë pjesëmarrësit do të aplikohen pasojat e vendosura në pikën 1.

2. Që përsëritja e EVT-së të jetë pozitive për të njëjtin nivel të Projektit të Zgjerimit, pjesëmarrësi ekzistues nuk duhet të ketë me detyrime tek TAP-i, dhe të gjitha kostot e shkaktuara nga TAP-i si pjesë e Projektit të Rritjes së Kapacitetit do të mbeten kosto bazë. Pjesëmarrësit (pjesëmarrësve) të mbetur do t'u kërkohet garancia e rishikuar pas ofertës së bankës, e barabartë në vlerë me vlerën e rishikuar të njoftuar (që i është njoftuar pjesëmarrësit (pjesëmarrësve) nga TAP), për të reflektuar pjesën përpjesëtimore të rishikuar të secilit pjesëmarrës të vlerësimit të kostove të ndërprerjes që aplikohen për shkak të ndërprerjes fillestare.

B3. Nëse EVT-ja nuk jep më një rezultat pozitiv duke bere përlogaritjet e përditësuara të vlerave të kostos së FEED dhe rezervimet e kapacitetit që janë ende në fuqi herë pas here, TAP-i mund të zhvillojë diskutime me pjesëmarrësit e mbetur nëse mund të bëhet ndonjë rregullim në kapacitetin e tyre të alokuar në mënyrë që të mbajë një EVT pozitive për Projektin e Zgjerimit.

Në rast se TAP-i arrin në përfundimin (duke vepruar në konfidencialitet të plotë):

1. Që pavarësisht çdo diskutimi që mund të ketë zhvilluar me pjesëmarrësit e mbetur, EVT-ja e përsëritur mbetet negative dhe TAP-i mbyll Projektin për Rritje Kapaciteti, çdo pjesëmarrës do

të jetë përgjegjës deri te limiti i ndërprerjes, për një pjesë proporcionale të kostove të ndërprerjes së TAP-it, që përlogariten në përpjesëtim me rritjen maksimale vjetore të kapacitetit të alokuar si pjesë e Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtë të kërkojë shuma të tilla sipas garancisë pas ofertës të pjesëmarrësit nëse këto shuma nuk paguhën nga pjesëmarrësi përkatës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i.

2. Që pas diskutimeve të zhvilluara nga pjesëmarrësit e TAP-it, mund të përfitohet një EVT pozitive për reduktimin e nivelit të Projektit të Zgjerimit:

i. çdo pjesëmarrës është i detyruar deri në kufirin përkatës të ndërprerjes, për një pjesë përpjesëtimore të kostove të ndërprerjes që si rezultat i kësaj ndërprerje, TAP-i vendos në (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje t'i përballojë si pjesë e nivelit të reduktuar të Projektit të Zgjerimit. TAP-i ka të drejtën që t'i kërkojë këto shuma deri në një shumë që është në dispozicion sipas garancisë pas ofertës në rastin kur këto shuma nuk paguhën nga pjesëmarrësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga një njoftim me shkrim nga TAP-i;

ii. garancitë pas ofertës të pjesëmarrësve të mbetur do të ridimensionohen për të pasqyruar reduktimin e nivelit të Projektit të Zgjerimit që po ndiqet;

iii. nëse ndonjë nga pjesëmarrësit e mbetur zgjedhin që të mos ofrojnë një garanci pas ofertës të ridimensionuar, GTA-ja mund të ndërpritet ose nga TAP-i ose nga pjesëmarrësi brenda 15 ditë pas njoftimit nga TAP-i të ndërprerjes nga pjesëmarrësi fillestar. Nëse kryhet kjo dhe EVT-ja përsëri mbetet pozitive, për një nivel të reduktuar të Projektit të Zgjerimit, të gjithë pjesëmarrësit ekzistues (përfshirë pjesëmarrësin që ka kryer i pari ndërprerjen) duhet të paguajnë një pjesë proporcionale të kostove të ndërprerjes, që si rezultat i ndërprerjes, TAP-i vendos (në konfidencialitet të plotë) që nuk është në gjendje të mbulojë si pjesë e nivelit të reduktuar të Projektit të Zgjerimit. Nëse si pasojë e kësaj ndërprerjeje tjetër EVT-ja përfundimisht përcaktohet nga TAP-i që të jetë negative, për të gjithë pjesëmarrësit do të aplikohen pasojat e vendosura në pikën 1.

Limitet e kostos së ndërprerjes

Në asnjë rast shuma maksimale që TAP-i mund të kërkojë nga pjesëmarrësi në lidhje me një



Ndërprerje që ndodh sipas paragrafit “B” nuk do të kalojë **“limitin e ndërprerjes”**, që në çdo rast do të jetë i barabartë me përqindjen e vlerës së njoftuar të çdo garancie të ofertës të pjesëmarrësit (në varësi të nivelit të Projektit të Zgjerimit dhe kur një përfundim i tillë ndodh) zbatohet për pjesëmarrësin përkatës, siç përcaktohet më poshtë:

	Mbulohet nga garancia pas ofertës e pjesëmarrësit (përqindja e vlerës së njoftuar për çdo garanci pas ofertës së pjesëmarrësit që TAP-i mund të kërkojë në lidhje me ndërprerjen nga ky pjesëmarrës)			
	Ndërprerja ndodh jo më vonë se data 30 prill 2023	Ndërprerja ndodh në periudhën 1 maj dhe 30 qershor 2023	Ndërprerja ndodh në periudhën 1 korrik dhe 31 gusht 2023	Ndërprerja ndodh në periudhën midis 1 shtator dhe 31 dhjetor 2023
Minimale	65 %	75 %	90 %	100%
E kufizuar				100%
Pjesore	55 %	70 %	85 %	100%
E plotë				100%

Për më tepër, dhe pavarësisht çdo gjëje të kundërt në këtë projektpropozim, TAP-i nuk do të ketë të drejtë të rikuperojë në total nga pjesëmarrësit ndonjë shumë që tejkalon përqindjen përkatëse (të përcaktuar më sipër) të TCE-së në fuqi në varësi të nivelit të projektit të zgjerimit në zbatim.

SRG

Në rastin e një rezultati pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), pjesëmarrësi është i detyruar t'u përgjigjet angazhimeve të shprehura në lidhje me nivelin e suksesshëm të ofertës. SRG-ja do të nënshkruajë Marrëveshjen e Transportit të Gazit (GTA) brenda datës 15 shkurt 2023.

Synohet që rezultati përfundimtar pozitiv i testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) që sjell realizimin e Projektit për Rritje Kapaciteti të jetë kusht i lidhjes së Marrëveshjeve përkatëse të Transportit të Gazit (GTA) nga të gjithë pjesëmarrësit (a) me angazhime të suksesshme detyruese.

Secila GTA do të hyjë në fuqi pas plotësimit të disa kushteve paraprake të vendosura sipas nevojave të SRG-së përkatësisht me hyrjen në fuqi të Marrëveshjeve të Transportit të Gazit (GTA) midis pjesëmarrësit dhe OST-ve të përfshira.

Nëse kushti nuk plotësohet ose hiqet nga SRG-ja dhe pjesëmarrësi sipas një datë të vonë 31 dhjetor 2023, SRG-ja do të shfuqizojë Marrëveshjen (Marrëveshjet) përkatëse të transportit të gazit.

Është e kuptueshme që në rast të ndonjë shtyrje të mundshme të afateve të angazhimit sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit (GTA) në një maksimum prej 20 vjetësh, nëse kërkohet siç përshkruhet më sipër në paragrafin E.7 IV c), Marrëveshja e Transportit të Gazit (GTA) e nënshkruar midis pjesëmarrësit të suksesshëm dhe SRG-së do të ndryshohet në përputhje me rrethanat.

Si kërkesë e Marrëveshjes përkatëse për Transportin e Gazit (GTA), pjesëmarrësi do t'i paraqesë SRG-në, brenda datës 15 shkurt 2023, “Garancitë e kontratës”: dy garanci bankare, që mund të arkëtohen me kërkesën e parë, të lëshuar nga një institut financiar italian ose nga një kompani sigurimi italiane ose degë në Itali e një banke ndërkombëtare, ose kompani sigurimi ndërkombëtare me një vlerësim minimal kredie BBB sipas Standard and Poor ose Fitch Ratings Baa3 sipas Moody's, BBB e ulët sipas DBRS ose depozita sigurimi pa interes, përkatësisht të njëjta në vlerë me shumën që kërkohet te Kodi i Rrjetit i SRG-së (kapitulli 5, paragrafi 1.3.4 dhe 1.3.5). Kuptohet që në rast të ndonjë ndryshimi të Marrëveshjes për Transportin e Gazit (GTA) referuar kushteve të përshkruara më sipër, garancitë e kontratës do të duhet të ndryshohen sipas rrethanave.

Garancitë e kontratës do të mbeten të vlefshme gjatë gjithë periudhës së Marrëveshjes përkatëse për Transportin e Gazit (GTA) dhe do të skadojnë në



fund të muajit të gjashtë pas përfundimit të Marrëveshjes përkatëse për Transportin e Gazit (GTA).

Nëse garancitë e kontratës përshkruar më sipër do t'i paraqiten SRG-së, garancia e parë e barabartë me 20% të detyrimit maksimal vjetor të kapacitetit, treguar në paragrafin E.1, do të kthehet.

Në rast të një EVT pozitive, nëse pjesëmarrësi nuk lëshon garancitë e kontratës të përshkruara më sipër në këtë paragraf (Kodi i Rrjetit SRG, kapitulli 5, paragrafët 1.3.4 dhe 1.3.5), ai do t'i paguajë një tarifë SRG të barabartë me vlerën e garancisë së parë përshkruar në seksionin E.1.SRG dhe kontrata do të shfuqizohet.

Nëse marrëveshjet e transportit të gazit (GTA) nuk bëhen efektive, si parashikohet në paragrafin E.7, SRG do t'i faturojë pjesëmarrësit përkatës faturën e barabartë me shumën e garancisë së parë që është dhënë. Garancia do t'i kthehet pjesëmarrësit pas kryerjes së pagesës. Pas përfundimit të Marrëveshjes së Transportit të Gazit, pjesëmarrësit do t'i kërkohej që t'i paguajë SRG-në të gjitha detyrimet e transmetimit që aplikohen që nga data kur kapaciteti është vendosur në dispozicion dhe përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Transportit të Gazit.

Në rastin kur pjesëmarrësi nuk lëshon garancinë e kontratës ose kur SRG-ja do të shfuqizojë GTA, pas një EVT negative për pjesëmarrësit e mbetur, SRG-ja do të kryejë fillimisht EVT, duke përjashtuar ofertën detyruese të pjesëmarrësit ose kapacitetin e alokuar.

Nëse testi EVT është negativ, SRG-ja mund të zhvillojë diskutime me çdo pjesëmarrës të mbetur në lidhje me rregullimet që mund të bëhen tek ofertat detyruese ose kapaciteti i alokuar që të mbajë një EVT pozitive për Projektin e Zgjerimit.

Nëse SRG-ja arrin në përfundimin se pavarësisht diskutimeve që mund të ketë mbajtur me pjesëmarrësit e mbetur, EVT-ja e përsëritur është negative dhe SRG-ja mbyll Projektin e Rritjes së kapacitetit GTA përfundon.

DESFA

Në rastin e një rezultati pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), çdo pjesëmarrës është i detyruar t'u përgjigjet angazhimeve të shprehura në lidhje me nivelin e suksesshëm të ofertës.

DESFA-ja do t'i dërgojë pjesëmarrësit (pjesëmarrësve) të cilëve iu është alokuar kapaciteti,

GTA, që duhet t'i rikthehet DESFA, e nënshkruar nga pjesëmarrësi jo më vonë se data 15 shkurt 2023.

Me një GTA, kapaciteti vetëm për një drejtim i alokohet pjesëmarrësit. Kur kapaciteti duhet t'i alokohet pjesëmarrësit për më shumë se një drejtim, atëherë duhet të kryhet GTA.

Pritet që rezultati përfundimtar pozitiv i testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) që çon në realizimin e Projektit për Rritje Kapaciteti të jetë objekt i zbatimit të Marrëveshjeve për Transportin e Gazit (GTA) nga të gjithë pjesëmarrësit me angazhime të suksesshme detyruese.

Çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit (GTA) do të bëhen efektive pas plotësimit të një sërë kushtesh paraprake të vendosura për të përmbushur nevojat e DESFA-së, duke përfshirë:

- Pjesa përkatëse e DESFA-së e Projektit (nënkupton atë pjesë të Projektit që është e nevojshme për të ofruar rritje të kapacitetit në drejtimin përkatës të rrjedhës, ose TAP drejt DESFA-së, ose në drejtim të kundërt, si përshkruhet te pjesa A.2 (paragrafi DESFA), është përfshirë pa kushte te miratimi më i fundit i DESFA-së, TYNDP-së dhe pastaj DESFA-ja do të vazhdojë me një FID deri në datën 31 dhjetor 2023 (data më e fundit).

- GTA-ja përkatëse midis pjesëmarrësit dhe të gjitha OST-të e përfshira (TAP dhe DESFA, në rastin e pikës së interkonjeksionit në Nea Mesimvria) kanë qenë gjithmonë efektive përgjatë datës më të fundit (**Long Stop Date**).

- OST-të e tjera të përfshira (TAP-i në rastin e pikës së interkonjeksionit të Nea Mesimvria) kanë vazhduar të procedojnë me Projektin për Rritje Kapaciteti, për shkak të faktit që kushtet e tyre paraprake specifike janë plotësuar ose shfuqizuar dhe DESFA-ja është njoftuar në datën më të fundit.

- Vlerësimet e përditësuara të DESFA-së për kostot e Projektit, të cilat do të bazohen te një projektim i detajuar që do të pasohet nga alokimi i kapacitetit, nuk do të ndryshojnë rezultatin e një EVT pozitive.

Nëse kushtet paraprake nuk plotësohen ose shfuqizohen nga DESFA-ja deri në datën 31 dhjetor 2023, DESFA-ja mund ta mbyllë Projektin për Rritje Kapaciteti dhe do të shpallë Marrëveshjen për Transportin e Gazit (GTA) të pavlefshme, dhe t'i kthejë pjesëmarrësit garancinë bankare të GTA-së.



Është e kuptueshme që në rast të ndonjë shtyrje të afatit për angazhim si përshkruhet më sipër në paragrafin E.7 (pjesa e TAP, rasti d/iii), dhe vetëm në rastin e një EVT fillestare pozitive për DESFA-në, si rrjedhojë do të ndryshohet nëse është e mundur GTA midis pjesëmarrësit dhe DESFA-së.

Pjesëmarrësi do t'i paraqesë DESFA-së 5 ditë para GTA-së kryerjen e garancisë së kërkuar bankare (garancia bankare e GTA-së), të arkëtueshme me kërkesën më të parë, të lëshuara nga një institut financiar grek, nën mbikëqyrjen e ECB-së (banka sistematike përkatësisht Alpha Bank, Eurobank, National Bank e Greqisë dhe Piraeus Bank) përfshirë nëndegët e tyre ose çdo degë në Greqi të një banke me reputacion ndërkombëtar me një shkallë minimale investimi të vlerësimit të kredisë sipas agjencive më poshtë, BBB te Standard and Poor's, BBB at Fitch ose Baa3 at Moody's, ose çdo bankë me reputacion ndërkombëtar me një vlerësim minimal të shkallës së investimit të kredisë (si përshkruhet më sipër), ose çdo nëndegë të një banke me reputacion ndërkombëtar pa vlerësimin minimal të shkallës së investimit të kredisë (ose pa ndonjë vlerësim) që siguron që garancia bankare nuk është garantuar nga ndonjë bankë ndërkombëtare me një vlerësim minimal të shkallës së investimit të kredisë (si përshkruhet më sipër), që është miratuar paraprakisht nga DESFA-ja, në konfidencialitet të plotë. Garancia bankare e GTA-së, do të jetë e barabartë me detyrimin maksimal vjetor maksimal për kapacitetin që i është alokuar pjesëmarrësit. Kur garancia bankare GTA e përshkruar këtu dhe më sipër paraqitet te DESFA, garancia bankare që tregohet në paragrafin E.1 dhe E.5 do të kthehet. Kuptohet që në rast të ndonjë shtyrje të GTA-së sipas kushteve të përshkruara më sipër sipas paragrafit E.7 (pjesa e TAP, rasti d.iii), garancitë bankare do të kërkohej të ndryshohet, nëse është e mundur nga pjesëmarrësit përkatës.

Garancia bankare e GTA-së, do të ketë afat dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundim të muajit të gjashtë që vijon me përfundimin e vitit të parë të shërbimeve të transportit që i ofrohen atij pjesëmarrësi në lidhje me kapacitetin e alokuar për pjesëmarrësin në fjalë sipas kuadrit të procesit të rritjes së kapacitetit. Një (1) muaj para E-COD për DESFA-në në Nea Mesimvria, pjesëmarrësi do t'i paraqesë DESFA-së garancinë që kërkohej sipas dispozitave përkatëse të Marrëveshjes Standarde të

Transportit NNGS (Fletorja Zyrtare **Government Gazette** B 4802/30.10.2020) dhe kapitulli 3A të Kodit të Rrjetit NNGS në Greqi (Fletorja Zyrtare **Government Gazette** B 4269/11.8.2022) për kapacitetin që i është alokuar atij pjesëmarrësi në kontekst të Procesit të Rritjes së Kapacitetit. Për kapacitetin që i është alokuar pjesëmarrësit në kontekstin e Procesit të Rritjes së Kapacitetit, garancia sipas Marrëveshjes së Transportit NNGS llogaritet sipas nenit 21H të Kodit të Rrjetit NNGS në Greqi. Për të shmangur dyshimet, të gjithë detyrimet e pjesëmarrësve të tjerë duhet të përmbushen sipas dispozitave përkatëse të përmendura te Kodi i Rrjetit NNGS dhe Marrëveshja e Transportit NNGS, që aplikohet herë pas here.

Pjesëmarrësi ka të drejtën të kërkojë reduktimin e garancisë bankare të GTA-së deri te në një shumë që i takon pjesës së garancisë për kapacitetin që rezervohet sipas Marrëveshjes së Transmetimit të NNGS-së. Jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit të vitit të parë të shërbimeve të transportit të ofruara për atë pjesëmarrës, dhe nëse ky pjesëmarrës ka paguar siç duhet dhe në kohë detyrimet e faturuara nga DESFA-ja për atë vit, garancia bankare e GTA-së duhet t'i kthehet pjesëmarrësit.

Në rastin e një EVT pozitive, nëse pjesëmarrësi i suksesshëm nuk e nxjerr garancinë bankare të GTA-së ose nuk e zbaton GTA-në duhet t'i paguajë DESFA-së një penalitet të barabartë me vlerën e garancisë bankare të ofertës detyruese të përshkruar në paragrafin E.1 dhe E.5 të DESFA-së.

Nëse GTA-ja nuk hyn në fuqi, si parashikohet në këtë pjesë, DESFA-ja do të alokojë kostot aktuale të shkaktuara nga DESFA-ja për procesin e rritjes së kapacitetit deri në atë pikë që çdo pjesëmarrës me një GTA, do të përpjesëtojë shumën e garancisë bankare GTA përshkruar në paragrafët E.1 dhe E.5. Garancitë bankare të GTA-së do t'i kthehen pasi këto kosto aktuale të vendosen.

Pas ekzekutimit të GTA-së, pjesëmarrësit do t'i kërkohej që t'i paguajë DESFA-së të gjitha detyrimet e transmetimit që aplikohen duke filluar nga data kur kapaciteti është vendosur në dispozicion dhe me kohëzgjatje të plotë kur kapaciteti i është alokuar atij pjesëmarrësi, sipas kushteve të GTA-ë.



E.8 Ecuria e Projektit, mungesa e lejeve, vonesat në vendosjen në dispozicion të kapacitetit të transportit

SRG-ja, TAP-i dhe DESFA-ja do të ndajnë me pjesëmarrësit përkatës ecurinë e Projektit për Rritje të Kapacitetit.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Transportin e Gazit (GTA), pjesëmarrësi do të konsiderohet se ka pranuar që, nëse autorizimet, lejet, komoditetet/lehtësime (*easements*) dhe çdo të drejtë tjetër e rëndësishme në lidhje me pronën/tokën e nevojshme për fazën e ndërtimit të projektit nuk janë marrë ose janë vonuar, atëherë kohëzgjatja për zbatimin e Projektit për Rritje të Kapacitetit do të shtyhet dhe OST nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj asnjë pjesëmarrësi në lidhje me vonesat e tilla, përveç atyre që do të vendosen të GTA-ja.

E.9 Forca madhore

Kushtet e forcës madhore të OST të ndryshme përcaktohen në dispozitat e tyre përkatëse kontraktuale si më poshtë.

TAP

Dispozitat e forcës madhore do të përcaktohen të Marrëveshja e Transportit e Gazit e TAP-it.

SRG

Referuar “Forcës madhore” do të zbatohen kushtet e përcaktuara në kapitullin 19.4 të Kodit të Rrjetit të SRG-së.

DESFA

“Forca madhore” për pjesën e DESFA-së të projektit përcaktohet në nenin 104 të Kodit të Rrjetit Grek (Fletorja Zyrtare B 788/7.3.2018).

E.10 Elementet e IND dhe RP për qasjen e çmimit fiks (neni 28 (1) Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

TAP

Bazuar te struktura e veçantë rregullatore e TAP-it, kjo pjesë nuk aplikohet për TAP-in.

SRG

Për të qenë në përputhje me strukturën rregullatore të tarifave në vend, SRG-ja propozon të aplikojë çmime variabël që dalin nga metodologjia e saj për çmimin referencë edhe për rritjen e kapacitetit. Prandaj, SRG-ja nuk konsideron miratimin e një qasje të çmimit fiks dhe rrjedhimisht elementet IND dhe RP të parashikuara nga rregullorja 2017/460 nuk janë të përshtatshme.

DESFA

Për të qenë në përputhje me strukturën rregullatore të tarifave në vend, DESFA-ja propozon të aplikojë çmime variabël që dalin nga metodologjia e saj për çmimin referencë edhe për rritje të kapacitetit. Prandaj, DESFA-ja nuk konsideron miratimin e një qasje të çmimit fiks dhe rrjedhimisht elementet IND dhe RP të parashikuara nga rregullorja 2017/460 nuk janë të përshtatshme.

G. Parametri i testit ekonomik (neni 28, pika “d” e Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Ky kapitull përshkruan propozimin e OST-ve për nivelin e angazhimeve të përdoruesve (faktori f) që do të merren parasysh gjatë zbatimit të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVI) të parashikuar në nenet 22 dhe 24 të rregullores 2017/459 (të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit).

TAP

Bazuar te struktura e veçantë rregullatore e TAP-it, kjo pjesë nuk aplikohet për TAP-in. Përshkrim i shkurtër i Metodologjisë së Tarifave të TAP-it si dhe tarifave që aplikohen për testin e qëndrueshmërisë ekonomike të TAP-it ndodhet në shtojcën I.

SRG dhe DESFA

Propozimi përfundimtar i OST-së për nivelin e faktorit (faktorëve) – f përfshihet brenda këtij propozimi të Projektit. Faktorët – f të përdorur për të kryer testin ekonomik do të miratohen përfundimisht nga autoritetet italiane dhe greke sipas nenit 28 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit.

G.1 Parametri i testit ekonomik për SRG-në

G.1.1 Çmimi i referencës (neni 22(1) i Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Në përputhje me strukturën aktuale rregullatore të tarifave, SRG-ja konsideron aplikimin e një çmimi referues variabël. Me qëllimin e testit ekonomik kjo është vlerësuar e barabartë me:

- 2.247812 €/në vit /Smc/në ditë ekuivalente me 0.20244374€/në vit/kwh/ditë për nivelin 1 të ofertës gjatë vitit të parë të operimit që pritët;
- 2.203111 €/në vit /Smc/në ditë ekuivalente me 0.19841785 €/në vit/kwh/në ditë për nivelin 2 të ofertës gjatë vitit të parë të operimit që pritët;
- 2.144981 €/në vit/Smc/në ditë ekuivalente



për 0.19318251 €/në vit/kwh/në ditë për nivelin 3 të ofertave gjatë vitit të parë të operimit që pritët;

Vetëm për qëllime të testit ekonomik, çmimet e mësipërme të referencës për çdo nivel oferte do të merren konstante përgjatë viteve të periudhës që kërkesat për rezervimin e kapacitetit të këtij procesi për rritje të kapacitetit janë të lidhura sipas treguesve të inflacionit që merret në konsideratë të WACC që aktualisht aplikohet për SRG-në.

Për të shmangur dyshimet, çmimi i referencës i aplikuar në mënyrë efektive do të përcaktohet përfundimisht në përputhje me dispozitat e strukturës rregullatore të vendosur në kohën e shërbimit të transmetimit do të ofrohen dhe do të merren parasysh kostot aktuale të OST-së.

G.1.2 Çmimi minimal i detyrueshëm (neni 22 (1) (ii) Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Nuk parashikohet asnjë çmim/prim i detyrueshëm.

G.1.3 Vlera aktuale e shtimit/rritjes së vlerësuar për të ardhurat e lejuara (neni 22 (1) b i Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Duke qenë që për të shpërndarë nivelet e ofertave të përfshira në këtë dokument, infrastrukturat ekzistuese aktuale në anën e Snam Rete Gas do të jenë të mjaftueshme dhe nuk do të kërkojnë investime shtesë, kjo pjesë nuk është e nevojshme.

G.1.4 Faktori – F (neni 22 (1) Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit) Niveli 1, 2 dhe 3 i ofertës

Për të njëjtat arsye si paragrafi më sipër, nivelet e angazhimeve të përdoruesve (faktori - f) për EVT individuale në pjesën italiane nuk është e përshtatshme.

G.2 Parametri për testimin ekonomik për DESFA-n

G.2.1 Çmimi i referencës (neni 22(1) i Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Tarifa për kapacitetin e alokuar do të drejtohet nga parimet dhe metodologjia e detajuar e rregullores greke të tarifave që është në fuqi në çdo kohë. Në përputhje me strukturën aktuale rregullatore të tarifave, DESFA-ja konsideron aplikimin e një çmimi referencë variabël.

Për qëllim informimi, tarifa për periudhën aktuale rregullatore për rezervimet afatgjata në Nea

Mesimvria, në drejtimin nga sistemi DESFA drejt TAP-it, sipas rregullores në fuqi të tarifave, që është në fuqi në kohën e publikimit të këtyre udhëzimeve, është e barabartë me 4,1717691 €/kwh/në orë/në vit pa marrë parasysh rregullimet rregullatore të parashikuara në rregulloren në fuqi të tarifave.

Për qëllime informimi, tarifa për periudhën aktuale rregullatore për rezervimet afatgjata në Nea Mesimvria nga TAP-i drejt sistemit DESFA, sipas rregullores në fuqi të tarifave, në fuqi kur janë publikuar këto udhëzime është e barabartë me 4,1717691 €/kwh/për orë/në vit pa marrë parasysh rregullimet rregullatore të parashikuara në rregulloren në fuqi të tarifave. Përfshirja e projektit niveli 1 i ofertës te baza e rregulluar e aseteve e DESFA-së do të çojë në një tarifë në vlerën 6,5026495 €/kwh/për orë/në vit duke qenë çmimi referencë për përllogaritjet e DESFA-së për EVT-në. Përfshirja e projektit të nivelit 2 të ofertave te baza e rregulluar e aseteve e DESFA-së do të çojë në një tarifë në vlerën 6,7453902 €/kwh/në orë/në vit duke qenë çmimi referencë për llogaritjet e DESFA-së për EVT, por po ashtu që përdoren për llogaritjen e garancive që kërkojnë nga DESFA-ja.

Për të shmangur dyshimet, në të gjitha rastet, çmimi referencë i zbatuar në mënyrë efektive do të përcaktohet përfundimisht në përputhje me dispozitat e strukturës rregullatore të vendosur në kohën e shërbimit të transmetimit dhe duke marrë parasysh kostot aktuale të OST-së.

G.2.1 Çmimi minimal detyrues (neni 22 (1) i Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Për nivelin e ofertës në drejtimin nga sistemi DESFA drejt TAP-it nuk parashikohet çmim detyrues.

Për nivelin 1 të ofertës në drejtimin nga TAP-i drejt sistemit DESFA çmimi minimal detyrues është 0.131€/kwh/në ditë/në vit.

Për nivelin 2 të ofertës në drejtimin nga TAP-i drejt sistemit DESFA çmimi minimal detyrues është 0.08 €/kwh/në ditë/në vit.

G.2.2 Vlera aktuale e rritjes së vlerësuar tek të ardhurat e lejuara (neni 22 (1), pika “b” i Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Vlera aktuale e rritjes së vlerësuar të të ardhurave të lejuara që lidhet me investimet për



nivelin 1 të ofertës në drejtimin nga TAP-i drejt sistemit DESFA vlerësohet afërsisht 93,452,093€.

Vlera aktuale e rritjes së vlerësuar të të ardhurave të lejuara që lidhet me investimet për nivelin 2 të ofertës në drejtimin nga TAP-i drejt sistemit DESFA vlerësohet afërsisht 156,097,820€.

G.2.3 Faktori – f (neni 22 (1) pika “c” i Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit)

Niveli për angazhimet e përdoruesit (faktori f) për testin individual të qëndrueshmërisë ekonomike në anën greke të pikës së interkonjeksionit për nivelin e ofertës në drejtimin nga sistemi DESFA drejt TAP-it nuk është i përshtatshëm.

Niveli i angazhimeve të përdoruesit (faktori f)

H.1 Informacioni i kontaktit

Marija Savova
Drejtues tregtar
Trans Adriatic Pipeline AG
Lindenstrasse 2
6340 Baar, Switzerland

www.tap-ag.com
market.test@tap-ag.com

Alessandro Mora
Drejtues i marrëveshjeve
ndërkombëtare
20097 San Donato Milanese, Italy

www.snam.it
ipa@snam.it

Georgios Doumouras
Departamenti i aksesit të sistemit
Dimitrios Skouras
Drejtues i Kontratave dhe
Departamentit të Konsumatorëve
357-359 Messogion Ave.,
Athens, 15231
Greece
www.desfa.gr
market-test@desfa.gr





SHTOJCA I DISPOZITAT SPECIFIKE TË TAP-it

Kjo shtojcë është vetëm për qëllim informacioni. Lexuesit i paraqitet një pasqyrë e mëtejshme mbi strukturën specifike rregullatore të TAP-it. Për më shumë informacion, lexuesit do t'i referohen Opinioni Përfundimtar të Përbashkët (FJO)³⁵ dhe Kodit të Tarifave të TAP-it³⁶.

Struktura rregullatore e TAP-it

Përfundimin nga tarifat e rregulluara dhe ndarja e pronësisë, që i është dhënë TAP nga autoritetet aplikohet për kapacitetin e zgjerimit të TAP-it të ofruar në këtë dokument. Rritja e kapacitetit të TAP-it është e hapur për aksesin e palës së tretë (që do të thotë rregullat e vendosura nga Kodi i Rrjetit i Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të BE-së) në masën që ato nuk bien në kundërshtim me Opinioni Përfundimtar të Përbashkët (sipas paragrafit 4.6 të Opinioni Përfundimtar të Përbashkët) dhe strukturën rregullatore të përshtatur për këtë qëllim.

Shuma prej 10% e kapacitetit të zgjerimit të ndërtuar aktualisht është lënë mënjanë dhe do të ofrohet si kapacitet i sigurt afatshkurtër në drejtimin përpara sipas paragrafit 4.1.10 të Opinioni Përfundimtar të Përbashkët.

Konceptet kryesore të Kodit të Tarifës së TAP

Paragrafi 3.3.1 e Kodit të Tarifave të TAP-it specifikon testin e qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) që TAP-i do të realizojë për të vendosur mbi rritjen e kapacitetit. Metodologjia për testin e qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) është si më poshtë:

I. Vlerësimet e kostos³⁷ do të llogariten për çdo nivel të ofertës të Projekti për Rritjen e Kapaciteti duke marrë në konsideratë kapitalin, shpenzimet operacionale dhe kapitalin e punës.

II. Të ardhurat shtesë do të llogariten si shumë e produktit të tarifës aktuale të zbatueshme të TAP-it (para zgjerimit) dhe kërkesave për kapacitet të paraqitura në çdo fazë detyruese, për të gjitha vitet

gjatë të cilave ofrohen produkte të kapacitetit.³⁸

III. Vlera aktuale neto ("NPV") e vlerësimeve të kostos dhe të ardhurave shtesë (pikat (a) dhe (b) më lart) do të llogaritet duke aplikuar si faktor zbritjeje normën e brendshme të kthimit (IRR) të synuar nga TAP.

Pas kalimit të testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), rilogaritja e të ardhurave të synuara dhe tarifave të TAP-it që do të aplikohet nga fillimi i periudhës për rimëkëmbjen e zgjerimit do të bëhet duke vendosur si kusht detyrues që tarifat e TAP-it të mos rriten nga nivelet e tyre të parazgjerimit.³⁹ Kështu, një test i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) me një vlerë aktuale neto (NPV) që është zero nënkupton që tarifat për njësi nuk ndryshojnë në krahasim me situatën para Procesit të Rritjes së Kapacitetit. Test i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) me një vlerë aktuale neto që është pozitive (NPV) do të çojë në një ulje të tarifave të TAP-it.⁴⁰ Në rastin e një vlere aktuale neto negative, Kodi i Tarifave të TAP kërkon investigimin e zgjidhjeve (teknike) të cilat pajtohen vetëm me një pjesë të kërkesës. Kjo kërkesë e Kodit të Tarifave të TAP-it është specifikuar në paragrafin E.6 ku OST-ja konsiderojnë një nivel më të ulët të ofertës në rastin e një (EVT) negative.

Nëse vlerat negative të vlerës aktuale neto (NPV) do të llogariten akoma edhe në rastet e zgjidhjeve alternative si më sipër, atëherë testi i qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) do të rezultojë pa sukses⁴¹. Kjo kërkesë po ashtu aplikohet edhe për paragrafin E.6.

Ekzistojnë dy dallime kryesore midis testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) të TAP-it dhe testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT) në nenin 22 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së.

1. Te Kodi i Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit të BE-së të ardhurat shtesë llogariten duke marrë parasysh një çmim/prim të mundshëm të ankandit dhe një çmim/prim minimal të mundshëm. Angazhimet e detyrueshme zakonisht përfshijnë një gatishmëri të palëve të interesuara

³⁵ [2019 Market test > Trans Adriatic Pipeline \(TAP\) \(tap-ag.com\)](https://www.trans-adriatic-pipeline.com/).

³⁶ [2019 Market test > Trans Adriatic Pipeline \(TAP\) \(tap-ag.com\)](https://www.trans-adriatic-pipeline.com/), miratuar në muajin nëntor 2013 nga autoritetet italiane, greke dhe Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri. Është miratuar më vonë një ndryshim në muajin korrik 2018.

³⁷ Paragrafi 3.3.1(c) i Kodit të Tarifave të TAP-it.

³⁸ Paragrafi 3.3.1(b) i Kodit të Tarifave të TAP-it.

³⁹ Paragrafi 3.3.3(b) i Kodit të Tarifave të TAP-it.

⁴⁰ Reduktimi /zbritja i referohet niveleve aktuale të tarifës pa marrë parasysh përshkallëzimin e të ardhurave të synuara të TAP-it për shkak të inflacionit sipas paragrafit 2.1 të Kodit të Tarifave të TAP-it.

⁴¹ Paragrafi 3.3.1(d) i Kodit të Tarifave të TAP-it.



për të paguar (“WTP”) për rritjen e kapacitetit. WTP shprehet përmes ankandëve për rritjen e kapacitetit (përfshirë ankandet standarde ***ascending clock auctions*** të nenit 17). Kjo nuk ndodh tek TAP-i. Sipas procesit të rritjes së TAP, Pjesëmarrësit paraqesin angazhime të detyrueshme që shprehin gatishmërinë për të rezervuar një sasi të caktuar kapaciteti për një periudhë të caktuar kohe. Tarifat rezultuese të njëjësive do të jenë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit e alokuar (dhe gjithashtu transportuesit aktualë të TAP-it). Alokimi në rast të mbingarkesës bëhet përmes renditjes së ofertave sipas raportit të vlerës aktuale neto (NPV) të kërkesës për kapacitet mbi kapacitetin vjetor të kërkuar.⁴² Kjo është thelbësore për modelin e biznesit të TAP-it. Një ankand për TAP parashikohet vetëm në një rast shumë specifik të mbingarkesës (oferta të barabarta, paragrafi E.5).

2. Kodi i Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së lejon socializimin e një pjese të kostos së zgjerimit për përdoruesit e mbetur në një sistem transmetimi (kjo bëhet përmes faktorit f të nenit 22 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së). Rreziku i zgjerimit mbetet vetëm i TAP-it.

Metodologjia e tarifave të TAP-it

Ky Paragraf thekson vetëm elementet kryesore të rregullores së tarifave. Lexuesit i referohen Kodit të Tarifave të TAP-it për një përshkrim më të plotë. Tarifa e TAP është një shumë në EUR/kwh/ditë gazit/viti i gazit. Ndarja midis të ardhurave të synuara të alokuara në pikën hyrëse të Kipoi dhe të ardhurave të synuara të alokuara për të gjitha pikat e daljes është 50/50. Niveli i tarifës së daljes varet nga distanca e çdo pike të interkonjeksionit nga pika hyrëse e TAP-it në Kipoi.

Të ardhurat e synuara të TAP-it janë përditësuar çdo vit që nga viti 2016, sipas formulës në pikën 2.1 të Kodit të Tarifave të TAP, për të siguruar një përshkallëzim të tarifave në fillim të çdo viti kalendarik. Përshkallëzimi është një funksion i indekseve të harmonizuara të çmimeve të konsumit (HICP⁴³ të zonës euro dhe i indekseve përkatëse të inflacionit të Greqisë, Italisë dhe Shqipërisë. Tarifat për rritje kapaciteti përcaktohen në përputhje me një model (“Modeli i llogaritjes së tarifave”) të

përpunuar nga TAP-i, i cili bazohet në një metodologji për rrjedhën zbritëse të parasë që llogarit të ardhurat e synuara të TAP-it. Metodologjia për rillogaritjen e të ardhurave të synuara dhe tarifave pas zgjerimit specifikohet në pikën 3.3.3 të Kodit të Tarifave të TAP-it.

Shkurtimisht, një dispozitë kryesore është që tarifat për njësi nuk do të rriten kurrë si rezultat i një zgjerimi. Në rast të rezervimeve të cilat mbështesin një zgjerim që ka një datë përfundimi para përfundimit të afatit të përjashtimit, kjo nënkupton që të ardhurat e synuara do të ribotohen për të siguruar që tarifat për njësi të mos rriten kur të mbyllen rezervimet e kapacitetit të sigurt me drejtim përpara (FFLT). Për më tepër, kjo do të thotë që TAP-i mbart rrezikun e rritjes së kostove aktuale përtej asaj që do të kishte dhënë një rezultat pozitiv i testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT), pasi një rritje e tillë e kostos nuk mund të pasqyrohet në tarifë.

Tarifat që aplikohen për testin e qëndrueshmërisë ekonomike të TAP-it

Tarifat që do të përdoren për qëllimet e testit të qëndrueshmërisë ekonomike janë tarifat e publikuara në faqen e TAP-it për vitin kalendarik 2022 dhe të ripunuara në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe pikat e daljes së Korçës dhe Fierit. Tarifat do të përshkallëzohen në përputhje me metodologjinë tarifore të TAP-it si përshkruhet më sipër, duke supozuar inflacionin e parashikuar prej 2% në vit për periudhat e ardhshme, që aplikohen për kostot edhe si input në formulën e përshkallëzimit të tarifave, siç tregohet në pikën 2.1 të Kodit Tarifor të TAP-it.

⁴² Paragrafi 3.3.1(c) dhe (e) i Kodit të Tarifave të TAP-it.

⁴³ “Treguesit e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve” përcaktuar në rregulloren e BE-së nr. 2016/792, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 maj 2016.



Pika e interkonjeksionit	Tarifat e TAP për produktet e sigurta afatgjata dhe produktet vjetore
	EURO /kwh /ditë /vit
Pika e daljes në Kipoi	1.075158
Pika e hyrjes në Nea Mesimvria	1.075158
Pika e hyrjes në Fier	1.075158
Pika e daljes në Komotini	0.124741
Pika e daljes në Nea Mesimvria	0.514061
Pika e daljes në Kuçovë	1.010767
Pika e daljes Relievi Roskovec	1.034614
Pika e daljes Fier	1.069045
Pika e daljes Melendugno	1.237953

SHTOJCA II PËRKUFIZIMET DHE SHKURTIMET

Kjo shtojcë përmban përkufizime dhe shkurtime të përdorura në këtë dokument

Kjo pjesë përmend përkufizimet kryesore të përdorura në këtë dokument.

Lista e përkufizimeve kryesore të përdorura në këtë dokument

a) **Mekanizmi alternativ i alokimit ose AAM** si [shpjegohet në [nenin 30 Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapaciteteve të BE-së].

b) Kërkesat vjetore nënkupton ofertat për kapacitet për periudha më të shkurtra se 3 vjet rresht dhe që mund të përdoren për vite individuale të gazit ose për kohëzgjatje të tjera.

c) Aplikues nënkupton palën e interesuar që regjistrohet te faza detyruese sipas paragrafit E.1.

d) Autoritetet, autoritetet rregullatore ose NRA-së nënkuptojnë autoritetet rregullatore të Energjisë në Itali ("ARERA"), Greqi ("RAE") dhe Shqipëri ("ERE").

e) Garanci bankare nënkupton garancitë e kërkuara në një formë të pranueshme nga çdo OST të cilat kërkohej të paraqiten nga çdo OST për të marrë pjesë në fazën detyruese (përfshirë pjesëmarrjen te procesi i ofertave të barabarta marxhinale sipas paragrafit E.5) dhe për të nënshkruar Marrëveshjen e Transportit të Gazit (GTA), e cila:

- në lidhje me garancinë bankare duhet të paraqitet te TAP-i, sipas kërkesave të përcaktuara në paragrafin E.1 (TAP) dhe mund të jetë ose një garanci oferte ose një garanci pasofertës; dhe

- në lidhje me garancinë bankare që duhet të paraqitet te SRG-ja, sipas kërkesave të përcaktuara në paragrafin E.1 (SRG) dhe paragrafin E.7 (SRG).

- në lidhje me garancinë bankare që duhet të paraqitet te DESFA, sipas kërkesave të paragrafit E.1 (DESFA) dhe atyre të paragrafit E.7 (DESFA).

f) Garancia e ofertës ka kuptimin e dhënë në paragrafin E.1.

g) Limit i garancisë së ofertës në lidhje me secilin pjesëmarrës, nënkupton sasinë e barabarte me vlerën e garancisë së ofertës së pjesëmarrësit.

h) Dritarja e dorëzimit të ofertës nënkupton periudhën gjatë së cilës pjesëmarrësit mund të paraqesin oferta detyruese.

i) Oferta detyruese nënkupton një ofertë të paraqitur nga një pjesëmarrës gjatë fazës detyruese të ofertimit.

j) Formulari detyrues i ofertës – formulari që duhet të plotësohet nga pjesëmarrësi për të marrë pjesë te në fazën e detyruese të ofertës për testimin e tregut të vitit 2021.

k) Faza detyruese e ofertës nënkupton çdo fazë përfundimtare të procesit për rritje kapaciteti ku palët e interesuara mund të paraqesin ofertat detyruese tek TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja në përputhje me paragrafin E dhe gjatë së cilës TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja do të kryejnë testin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe do të vazhdojnë me alokimin e kapacitetit.

l) Faza (fazat) detyruese nënkupton secilën fazë të përgjithshme të procesit të rritjes së kapacitetit, e cila përbëhet nga faza informuese dhe faza detyruese e ofertës dhe mund të përfshijë fazën e parë detyruese dhe (nëse aplikohet) fazën e dytë detyruese.

m) Formulari i regjistrimit të fazës detyruese nënkupton formularët bashkëngjitur njoftimit të përbashkët, te çdo paragraf i OST-së, që do të përdoret nga aplikantët për regjistrimin e tyre në fazën detyruese me të cilën pjesëmarrësit do të



deklarojnë pranimin e kushteve të vendosura nga OST-ja.

n) Ditë pune nënkupton çdo ditë kalendarike, por jo të shtunën, të dielën ose një festë zyrtare në Itali ose Zvicër.

o) Alokimi i kapacitetit nënkupton kapacitetin e alokuar për pjesëmarrësit e suksesshëm pas rezultatit pozitiv të fazës detyruese të ofertimit dhe testit të qëndrueshmërisë ekonomike (EVT).

p) Limitet e kapacitetit nënkupton masat konkurruese për tregun italian, grek dhe shqiptar si përcaktohet në paragrafët 4.7.3, 4.7.6 dhe 4.7.9 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët.

q) Kushti (kushtet) paraprake nënkupton ngjarjet ose veprimet që duhet të plotësohen (ose të hiqen) para se Marrëveshja (marrëveshjet) e Transportit të Gazit (GTA) të hyjnë në fuqi në përputhje me kushtet e Marrëveshjes përkatëse për Transportin e Gazit (GTA), siç kërkohet nga çdo OST në nënparagrafët respektivë të paragrafit E.7.

r) Kërkesa e lidhjes nënkupton një kërkesë detyruese dhe /ose jodetyruese për TAP-in nga një palë e interesuar për të ndërtuar një pike të re hyrëse dhe /ose dalje në Shqipëri ose Greqi dhe /ose për të rritur kapacitetin teknik të një pike ekzistuese hyrëse dhe /ose dalje në Shqipëri, në përputhje me nenet 4.7.5, 4.7.7 dhe 4.7.8 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët.

s) Faza e koordinuar e projektimit nënkupton fazën e projektit *[të përcaktuar në nenin 27 të Kodit të Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së]*.

t) CRF nënkupton rrjedhën komerciale në drejtim të kundërt.

u) Raporti për vlerësimin e kërkesës ose DAR nënkupton raportin e publikuar së bashku nga TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja në datën 25 tetor 2021 *[i përcaktuar në nenin 26 të NC CAM të BE-së]*.

v) Testi i qëndrueshmërisë ekonomike ose EVT nënkupton testin që aplikohet për të vlerësuar qëndrueshmërinë ekonomike të Projektit për Rritje të Kapacitetit.

w) Traktat i Komunitetit të Energjisë nënkupton traktatin që ka vendosur Komuniteti i Energjisë, nënshkruar në tetor 2005.

x) Data e vlerësuar për vendosjen në funksion (*Estimated Operation Date*) ka kuptimin që i është dhënë të konfirmimi i transportit.

y) Kapaciteti i zgjerimit nënkupton kapacitetin te sistemi i transportit i TAP-it që vendoset në

dispozicion përveç kapacitetit fillestar deri në 10 miliardë metra kub në vit.

z) Projekti i Zgjerimit nënkupton një projekt për të zgjeruar kapacitetin e TAP-it në pikat ekzistuese hyrëse dhe/ose dalje të TAP-it ose për të vendosur pika të reja hyrëse dhe/ose dalje në sistemin e transportit të TAP, në përputhje me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, Kodin e Rrjetit për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit (CAM NC) dhe Kodin e Tarifave të TAP-it dhe përfshin: Projektin Minimal të Zgjerimit, Projektin e Kufizuar të Zgjerimit, Projektin Pjesor të Zgjerimit dhe/ose Projektin e Plotë të Zgjerimit.

aa) Periudha për rimëkëmbjen e zgjerimit nënkupton, në lidhje me çdo zgjerim, periudhën që fillon në ditën në të cilën fillon funksionimi komercial i zgjerimit përkatës dhe përfundon në ditën më të hershme: a) kur marrëveshja e transportit të gazit në lidhje me kapacitetin përkatës të zgjerimit përfundojnë dhe nëse këto marrëveshje të transportit të gazit përfundojnë në ditë të ndryshme, në ditën e përfundimit të afatit të fundit; dhe b) 25 vjet pas ditës së parë të kësaj periudhe *[e përcaktuar në Kodin e Tarifave të TAP-it]*.

bb) Ofertat marxhinale të barabarta nënkupton ofertat që kanë të njëjtin raport të vlerës aktuale neto të të ardhurave shtesë nga secila kërkesë detyruese për njësi të kapacitetit vjetor të kërkuar dhe kapaciteti i disponueshëm në nivelin e ofertës nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kapacitetin e kërkuar.

cc) Procesi i ofertave të barabarta marxhinale nënkupton procesin për alokimin e kapacitetit marxhinal siç përshkruhet në paragrafin E. 5 të propozimit të Projektit.

dd) Formulari për ofertat detyruese marxhinale të barabarta ose formulari për ofertat detyruese EMB nënkupton formularin që kërkohet të paraqitet sipas paragrafit E.5 të propozimit të Projektit.

ee) Data e operimit komercial të zgjerimit (E-COD) nënkupton datën komerciale të operimit për rritjen e kapacitetit realizuar pas një rezultati pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike.

ff) Opinionin Përfundimtar i Përbashkët ose FJO nënkupton Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të rregullatorëve të energjisë në Itali, Shqipëri dhe Greqi mbi kërkesën e përjashtimit të TAP-it AG, të nxjerrë në datën 6 qershor 2013.

gg) Kapaciteti i sigurt afatgjatë në drejtim



përpara, FF, i sigurt afatgjatë ose kapacitet FFLT nënkupton produktet e kapacitetit për kapacitetin e transportit të rezervuar duke iu referuar një ose më shumë pikave të interkonjeksionit për transportin e gazit natyror dhe për të cilat transportuesi nuk lejohet t'i ndërpresë përveç mirëmbajtjes së planifikuar, kufizimeve të kapacitetit ose një forcë madhore.

hh) FEED nënkupton punimet paraprake inxhinierike dhe të projektimit

ii) Projekti i plotë i zgjerimit nënkupton projektin e zgjerimit përshkruar në paragrafin (d) sipas pjesës A.2 më sipër.

jj) GTA ose Marrëveshja për Transportin e Gazit ka kuptimin e shpjeguar te konfirmimi i transportit.

kk) Garancia bankare GTA ka kuptimin e shpjeguar në paragrafin E.7.

ll) Udhëzimet nënkupton udhëzimet për testin e tregut për vitin 2021 të Gazsjellësit Trans Adriatik, të miratuar nga autoritetet në vitin 2021. Udhëzimet përcaktojnë se si TAP do të zhvillojë testimin e tregut të nisur në vitin 2021, me qëllim që t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitetin e zgjerimit deri në kapacitetin total të gazsjellësit sipas paragrafit 4.1.7 të Opinioneve Përfundimtar të Përbashkët dhe për të përshtatur kërkesat e lidhjes.⁴⁴

mm) Procesi i Rritjes së Kapacitetit nënkupton procesin aktual për të vlerësuar kërkesën e tregut për rritje kapaciteti shtesë përgjatë gjurmës së TAP-it, duke përfshirë pikat e interkonjeksionit të Nea Mesimvria dhe Melendugno me DESFA-në dhe SRG-ja [të vendosura sipas Kodit të Rritjes për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së].

nn) Projekti për Rritjen e Kapacitetit nënkupton projektin e përshkruar në këtë dokument që synon të rrisë sasinë e kapacitetit teknik në 5 pika interkonjeksioni përgjatë gjurmës së TAP-it [përcaktuar në nenin 3(9) NC CAM të BE-së]. Kjo ka të bëjë me projektin për të rritur sasinë e kapacitetit teknik sipas vlerësimit të kërkesës të kryer nga TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja.

oo) Faza informuese ka kuptimin e shpjeguar në paragrafin D.1.

pp) Kapacitet fillestar nënkupton 10 miliardë metër kub në vit të kapacitetit fillestar të Gazsjellësit TAP.

qq) Pikat e interkonjeksionit (IPs) nënkupton pikat e hyrjes dhe të daljes përgjatë gjurmës së TAP (referuar në nenin 2 NC CAM BE).

rr) Njoftim i përbashkët nënkupton njoftimin e publikuar nga OST-të e përfshira sipas nenit 28.3 të Kodit të Rritjes për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit (CAM NC) në fillim të fazës së informimit.

ss) Ofertë e lidhur nënkupton një ofertë ku pjesëmarrësi ka treguar se kërkesa e tij detyruese në pikën hyrëse të TAP-it i nënshtrohet alokimit të një sasive të barabartë kapaciteti dhe kohëzgjatje me një pikë të dytë interkonjeksionit (pika dalje) [referuar në nenin 30 (3a) Kodit të Rritjes për Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit të BE-së].

tt) Projekt i kufizuar zgjerimi nënkupton projektin e zgjerimit të përshkruar në paragrafin (b) sipas pjesës A.2 më sipër.

uu) Oferta marxhinale nënkupton një ofertë ku kapaciteti nuk mund të plotësohet nga OST-ja e përfshira në një nivel të ofertës. Kjo është oferta e menjëhershme më e ulët e vlerës aktuale neto /oferta e raportit të kapacitetit pas të gjitha ofertave të tjera ku kapaciteti i kërkuar është alokuar plotësisht.

vv) Çmimi/primi minimal i detyrueshëm nënkupton një shtesë e shtuar te çmimi referencë që zbatohet për SRG-në dhe DESFA-në për të siguruar një rezultat pozitiv të testit të qëndrueshmërisë ekonomike [sipas nenit 33 të NC TAR të BE-së].

ww) Shtet anëtar nënkupton një shtet anëtar të Bashkimit Evropian.

xx) Projekti Minimal i Zgjerimit nënkupton projektin e zgjerimit përshkruar në paragrafin “a” pjesa A.2 më sipër.

yy) Niveli i ofertës nënkupton nivelin përkatës të rritjes së kapacitetit të ofruar për secilin prej produkteve vjetore të kapacitetit standard në një pikë interkonjeksioni për çdo rritje të zgjidhjeve teknike.

zz) Projekt Pjesor Zgjerimi nënkupton zgjerimin e projektit të përshkruar në paragrafin “c” pjesa A.2 më sipër.

aaa) Pjesëmarrës nënkupton aplikuesin që konsiderohet që përputhet me kërkesat e OST-ve të përfshira (sipas paragrafit E.1) për procesin e

⁴⁴ Për të shmangur dyshimet, këto udhëzime për testimin e tregut të vitit 2021 të Gazsjellësit Trans Adriatik janë të ndryshme nga udhëzimet e testimit të parë të tregut të TAP-it, i cili është miratuar nga autoritetet në muajin prill 2012, duke iu referuar Opinioneve Përfundimtar të Përbashkët.



regjistrimit dhe do të marrë pjesë te fazat e tjera të fazës detyruese (dritarja për paraqitjen e ofertës, alokimin e kapacitetit, nënshkrimin e Marrëveshjes së Transportit të Gazit).

bbb) Vonesa e lejuar ka kuptimin që shpjegohet te konfirmimi i transportit.

ccc) Garancia pas ofertës ka kuptimin që shpjegohet në paragrafin E.7.

ddd) Çmim rezervë do të jetë e barabartë me shumën e çmimeve referencë të përcaktuara nga TAP-i (tarifa e TAP-it), SRG-ja dhe DESFA-ja [referuar te NC TAR e BE-së].

eee) Çmim referencë nënkupton çmimin për një produkt të kapacitetit për kapacitetin e sigurt me kohëzgjatje prej një viti në një pikë interkonjeksioni.

fff) Palët e regjistruara ka kuptimin e shpjeguar në paragrafin E.1 më sipër.

ggg) Data e rishikuar, e përlogaritur për vendosjen në funksion ose REOD ka kuptimin e shpjeguar te konfirmimi i transportit.

hhh) Kriteret për mbështetjen e kredisë së TAP-it nënkupton kërkesat e vendosura nga TAP-i siç janë përcaktuar te GTA të vendosura në dispozicion me njoftimin e përbashkët (paragrafi i TAP).

iii) Të ardhurat e synuara të TAP-it nënkupton rrjedhën vjetore të të ardhurave, e nevojshme për të arritur normën e brendshme të kthimit që synohet nga TAP-i deri në fund të periudhës së rimëkëmbjes siç mund të rilogaritët pas një zgjerimi në përputhje me pikën 3.3.3 të Kodit të Tarifave të TAP-it dhe si përcaktohet më tej te Kodi i Tarifave të TAP-it.

jjj) Tarifat e TAP-it kanë kuptimin që shpjegohet te Kodi i Tarifave i TAP-it.

kkk) Kodi i Tarifave i TAP-it ose Kodi i Tarifave nënkupton kodin e tarifave që është në dispozicion në faqen e internetit <https://www.tap-ag.com/shippers/tariff-information>.

lll) Kostot e ndërprerjes nënkupton kostot aktuale, shpenzimet dhe humbjet (përfshirë tarifat e çmontimit, tarifat e prishjes me nënkontraktorët dhe tarifat e kancelimit) që kanë ndodhur ose janë kryer nga TAP-i në lidhje me Projektin e Zgjerimit.

mmm) Vlerësim i kostove të ndërprerjes ose TCE ka kuptimin që është shpjeguar në paragrafin E.7.

nnn) Sistemi i transportit nënkupton çdo sistem të tubacionit të gazit natyror, përfshirë tubat nën

dhe në tokë dhe të gjitha pajisjet e tjera që janë në zotërim ose që përdoren dhe operohen nga OST-ja për të ofruar shërbimet e transportit të gazit natyror.

ooo) Konfirmim i transportit nënkupton konfirmimin e transportit në formën që ofrohet te njoftimi i përbashkët që është nxjerrë nga çdo OST.

ppp) OST-të e përfshira nënkupton TAP-in dhe SRG-në për pikën e interkonjeksionit në Melendugno, TAP-in dhe DESFA-së për pikën e interkonjeksionit të Nea Mesimvria, dhe TAP vetëm për pikat e tjera të interkonjeksionit dhe pikat e daljes.

qqq) OST-ja nënkupton operatorin e sistemit të transmetimit, që mund të jetë TAP-i, SRG-ja dhe DESFA-ja (sipas rastit).

Shtojca III – Procedura konkurruese në sistemin SRG

Procesi i Rritjes së Kapacitetit në lidhje me zgjerimin e TAP-it parashikon aplikimin e një mekanizmi alternative alokimi për zëvendësimin e ankandeve të rregullta të parashikuara nga CAM NC në nenin 29. Në mënyrë të veçantë, mekanizmi përcakton që faza detyruese fillon në datën 16 janar me një dritare për paraqitjen e ofertave detyruese që zgjat 7 ditë (16 janar–22 janar 2023).

Duke pasur parasysh që pika e interkonjeksionit (IP) në Melendugno, sipas procesit të zgjerimit, konkurren me pikat e interkonjeksionit të Mazara dhe Gela, është e nevojshme të menaxhohen ofertat e kapaciteti shumëvjeçar që fillojnë nga viti 2025/26 për nivelin 1 të ofertave, viti 2026/27 për nivelin 2 të ofertave dhe periudha 2027/28 për nivelin 3 jashtë procedurës së rregullt të ankandit që parashikohet në paragrafin 3.2.3, kapitulli 5, të Kodit të Rrjetit të SRG-së, si përshkruhet këtu dhe më poshtë.

Kërkesat për të marrë pjesë – Pika e interkonjeksionit në Melendugno

Pjesëmarrësit e interesuar për të blerë kapacitet shumëvjeçar në pikën e interkonjeksionit në Melendugno duhet të plotësojnë kërkesat që tregohen në pjesën e SRG-së më sipër paragrafët E.1 dhe E.7.

Kërkesat e pjesëmarrjes – Pikat e interkonjeksionit të Mazara dhe Gela

Pjesëmarrësit që kanë interes për të blerë kapacitet shumëvjeçar te pikat e interkonjeksionit të Gela dhe Mazara duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:



- të kenë një kontratë të nënshkruar transporti me SRG-në;

- të paraqesin “Garancinë e parë” të duhur: një garanci që mund të arkëtohet me kërkesën më të parë, e lëshuar nga një institut financiar italian ose kompani italiane e sigurimeve ose degë italiane e një banke të huaj ose kompanie të huaja sigurimesh me një vlerësim minimal të kreditit BBB – në Standard and Poor’s ose Fitch Ratings, Baa3 në Moody’s ose BBB i ulët në DBRS ose një depozitë sigurie pa interes, përkatësisht e barabartë në vlerë me 20% të tarifës maksimale vjetore të kapacitetit (duke përfshirë një prim/çmim të mundshme ankandit siç përshkruhet më poshtë) të kapacitetit që ata synojnë të kërkojnë dhe me një datë skadence jo më herët se 15/08/23 brenda datës 15 janar 2023;

- të plotësojnë kërkesat e pikave “c”, “d” dhe “e”, paragrafi 1.1.1, kapitulli 5, i Kodit të Rrjetit të SRG-së;

- të pajtohet me kërkesat referuar në paragrafët 1.4 dhe 9.1, kapitulli 5, të Kodit të Rrjetit të SRG-së.

Në rast të alokimit të suksesshëm të kapacitetit, si kërkesë e GTA përkatëse, pjesëmarrësi do t’i paraqesë SRG-së, deri më 15 shkurt 2023, “Garancitë e kontratës”: dy garanci bankare), të arkëtueshme me kërkesën më të parë, të lëshuara nga një financiar italian. institut ose kompani sigurimesh italiane ose degë italiane e një banke të huaj ose një kompanie të huaj sigurimesh me një vlerësim minimal të kredisë BBB – në Standard dhe Poor’s ose Fitch Ratings, Baa3 në Moody’s ose BBB të ulët në DBRS ose depozite sigurie pa interes, e barabartë në vlerë me shumën e kërkuar në Kodin e Rrjetit SRG (kapitulli 5, paragrafi 1.3.4 dhe 1.3.5). Garancitë e kontratës do të mbeten të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e GTA përkatëse, me një datë skadimi në fund të muajit të gjashtë pas përfundimit të GTA përkatëse. Pasi garancitë e kontratës të përshkruara këtu më sipër t’i paraqiten SRG-së, garancia e parë do të kthehet.

Nëse pjesëmarrësi nuk lëshon kontratë garancish të përshkruar më sipër (Kodi i Rrjetit i SRG-së, kapitulli 5, paragrafi 1.3.4 dhe 1.3.5) brenda datës 15 shkurt 2023, ai duhet t’i paguajë një tarifë SRG në vlerën e garancisë së parë dhe kontrata do të shfuqizohet.

Mekanizmi konkurrues

Ofertat duhet të dorëzohen gjatë dritares së dorëzimit të ofertave (16–22 janar 2023) sipas

modeleve të publikuara në faqen e internetit të SRG-së.⁴⁵ Si rregull bazë, në një ofertë të vetme, pjesëmarrësit duhet të specifikojnë të njëjtën vlerë të kapacitetit për të gjitha vitet e kërkuara të gazit. Megjithatë, një ofertë mund të tregojë një rritje gjatë dy vjetëve të parë të periudhës me të cilën lidhet oferta, me një vlerë minimale të kapacitetit prej 40% për vitin e parë të gazit dhe 70% për vitin e dytë të gazit. Nëse pjesëmarrësit dëshirojnë të profilizojnë më tej kërkesën e tyre për kapacitet, atëherë ata duhet të paraqesin oferta të veçanta.

Në përputhje me kuadrin aktual rregullator të tarifave, SRG-ja konsideron aplikimin e një çmimi referencë të ndryshueshme. Për qëllim të testimit ekonomik dhe paraqitjes së garancive bankare, kjo është vlerësuar e barabartë me:

- Mazara 3.426030 €/në vit /Smc/në ditë ekuivalente me 0.30926390 €/në vit/kwh/ditë;

- Gela 3.142308 €/në vit /Smc/në ditë ekuivalente me 0.28702165 €/në vit/kwh/ditë;

- Melendugno;

- 2.247812 €/në vit/Smc/në ditë ekuivalente me 0.20244374 €/vit /kwh/ditë për nivelin 1 të ofertës gjatë vitit të parë të operimit që pritet;

- 2.203111 €/në vit/Smc/në ditë ekuivalente me 0.19841785 €/në vit/kwh /në ditë për Nivelin 2 të Ofertës gjatë vitit të parë të operimit që pritet;

- 2.144981 €/në vit/Smc/në ditë ekuivalente me 0.19318251 €/në vit/kwh/në ditë për nivelin 3 të ofertës gjatë vitit të parë të operimit që pritet;

Çmimet rezervë synohen të jenë të i barabartë me tarifat e rregulluara të miratuara nga Rregullatori Italian për Energjinë, Rrjetet dhe Mjedisin në Itali dhe të përditësuara në baza vjetore. Pjesëmarrësit mund të tregojnë, gjithashtu, një çmim të ankandit që do të dëshironin që SRG-ja ta konsideronte përveç çmimit të rezervës për të forcuar renditjen e tyre të ofertës.

Renditja e ofertës

Në rastin kur kërkesat e përgjithshme të kapacitetit për tre IP-të e përfshira të Mazara, Gela dhe Melendugno janë më të ulëta se kufizimi i publikuar në faqen e internetit të SRG-së⁴⁶, kapaciteti i kërkuar do t’u alokohet plotësisht pjesëmarrësve.

Në rastin kur kërkesat e përgjithshme të kapacitetit për tre IP-të e përfshira të Mazara, Gela

⁴⁵ Faqja e internetit te FAZA E INFORMIMIT.

⁴⁶ Faqja e internetit PUBBLICAZIONI.



dhe Melendugno janë më të larta se kufizimet e publikuara në faqen e internetit të SRG-së, primi/çmimi i ankandit i treguar në ofertë do të përdoret nga SRG-ja për të renditur ofertat. Në mënyrë të veçantë, kjo renditje do të kryhet duke filluar nga raporti i NPV⁴⁷ për të ardhurat hipotetike në sistemin SRG gjeneruar nga primi i secilës ofertë pjesëtuar me kapacitetin maksimal vjetor të ofertës. Kërkesat më të vogla se 3 vjet radhazi do të ndahen në masën që ka kapacitet të mbetur në dispozicion në vitin përkatës. Në bazë të treguesit të pranuar nga pjesëmarrësi në kërkesë, SRG-ja do të vazhdojë me alokimin pjesor sipas renditjes së ofertave.

Kuptohet që pjesëmarrësit janë të detyruar të paguajnë një tarifë kapaciteti të barabartë me tarifat e rregulluara të miratuara nga Autoriteti Rregullator Italian për Energjinë, Rrjetet dhe Mjedisin dhe të përditësuar në baza vjetore plus primin e treguar në secilën kërkesë të tyre.

EVT-ja në Melendugno

Pas aplikimit të mekanizmit të përshkruar më sipër, ofertat e suksesshme për pikën e interkonjeksionit të Melendugno do të alokohen me TAP-in për të përsëritur EVT. Në rast të një EVT pozitive, kapaciteti do t'u alokohet pjesëmarrësve, ndërsa në rast të një EVT-je negative, kërkesat do të kufizohen në nivelin më të ulët të ofertës me një EVT-je pozitive. Në këtë rast, nëse kapaciteti i përgjithshëm i caktuar pas kufizimit të IP Melendugno, është më i ulët se kufizimi i kapacitetit, duke gjeneruar kapacitet të ri të disponueshëm në IP-të Mazara dhe Gela, SRG-ja do të vazhdojë me alokimin për të përmbushur detyrën e pjesshme, nëse ka, sipas renditjes së ofertave.

KËRKESË

Nr. 122/12, datë 23.11.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i Sheshit të Flamurit”, Bashkia Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “tokë truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasurinë e llojit “ndërtesë jobanimit”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 15 004 074 (pesëmbëdhjetë milionë e katër mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim**

⁴⁷ Norma e skontimit supozohet të jetë e barabartë me WACC rregullatore në fuqi, e shprehur në terma nominalë para taksimit.



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË FLAMURIT”, BASHKIA VLORE

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe pronës truall	Sipërfaqe e pronës ndërtesë	Sip. truallit që preket nga projekti	Çmimi i truallit lek/m²	Vlera e truallit, lek	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lek/m²	Vlera e ndërtimit, lek	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
1	8603	3/33 -T	Vlorë	Pavlo Cika, Falie Cika	Truall	180		180	10903	1962540				1962540	
2	8603	3/15-T	Vlorë	Tefta Rrapi, Anita Rrapi, Alfred Rrapi	Truall	210		210	10903	2289630				2289630	
3	8603	3/24	Vlorë	“Pespa&Albania Alumin” sh.p.k.	Truall	360	217	360	10903	3925080	217		3300378	3300378	Hipotekohet në favor të Bankës Credins
4	8603	15/3	Vlorë	Faik Bataj	Truall	222		222	10903	2420466				2420466	
5	8603	15/12-T	Vlorë	Miti Sholla	Truall	4		4	10903	43612				43612	
6	8601	14/166	Vlorë	Hilmi Nepravishta	Truall	354		44	10903	479732				479732	Kufizim – Urdhër i regjistruarit
7	8601	14/166-Nd	Vlorë	Ndricim Çobani	Ndërtesë		102				15		582636	582636	Mungon marrëdhënia me truallin. Vija e shpronësimit prek 15 m² të objektit të certifikuar. Deklaratë noteriale për dakordësinë për prerjen e objektit hartuar nga dy bashkëpronarë. Akt ekspertize për qëndrueshmërinë nga realizimi i prerjes së objektit. Plotësim dokumentacioni.
														11 078 994	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 384 lekë